

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje të sigurisë - 5

ÇËSHTJE TË SIGURISË

Security Issues

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Nr. 5, Tiranë 2007

Bordi botues:

Kryetar

Gj. Lt. (rez.) Pëllumb Qazimi

Anëtarë

Prof. dr. Dhori Karaj – Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale

Franko Egro – Publicist, Kryeredaktor i TV Koha

Agri Verrija – Këshilltar i Kryeministrit

Sotiraq Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Konsulentë

Geron Kamberi – M.A. në Studime Evropiane

Artan Karini – M.A. në Administrim Publik

*Ky numër i revistët botohet me mbështetjen financiare
të Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s në Bruksel dhe të
Birra Korça*

PËRMBAJTJA

NATO dhe Bashkimi Europian: Bashkëpunim dhe Siguri	7
Dmitri Trenin NATO dhe Rusia: Mendime realiste dhe sugjerime praktike	16
Gary D. Robbins Një NATO Globale drejt Samitit të Bukureshtit	34
Kol. Edison Zarka Përshtatja ndaj sfidave dhe kërcënimeve të sigurisë kombëtare dhe hapat e integritit të vendit drejt strukturave Euro- Atlantike.	41
Dr. Amadeo Watkins dhe Srdjan Gligorijevic NATO dhe Ballkani: shembulli për një integrim më të gjerë.	51
Geron Kamberi BE dhe përpjekjet e saj për një politikë të jashtme	59
Manjana Milkoreit Duke e vlerësuar seriozisht dimensionin civil të sigurisë: .	95
Igli Tashi Solange Ghernaouti – Hélié Vendi i sigurisë së informacionit në strategjinë e sigurisë kombëtare	102

Gaqo Tanku, Doktor i Shkencave Ekonomike

Menaxhimi i Dijes 111

Brief English summary of the articles in this issue 126

NATO DHE BASHKIMI EUROPIAN: BASHKËPUNIM DHE SIGURI

Profesori Adrian Pop studion marrëdhëniet në vazhdimësi midis Bashkimit Europian dhe Aleancës Atlantike. Sfidat e sotme të sigurisë përfshijnë një mori rreziqesh komplekse dhe evoluese, duke përfshirë terrorizmin ndërkombëtar, prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë (WMDs), shtete jo të suksesshme, konflikte të vazhdueshme, krimin e organizuar, kërcënimet kompjuterike, mungesën e energjisë, degradimin e mjedisit dhe risqet e sigurisë të lidhura me këtë, shkatërrimet natyrale dhe të shkaktuara nga njerëzit, që prekin popullatën si dhe shumë të tjera. Përballja në mënyrë efektive me këto kërcënime do të kërkojë një bashkëpunim në shkallë më të gjerë dhe të fortë ndërmjet NATO-s dhe Bashkimit Europian (EU).

Të dy organizatat duhet të ndërmarrin një afrim holistik në çështjet e sigurisë dhe të punojnë së bashku në fushën e mbrojtjes. Megjithëse as ndarja gjeografike e punës dhe as ajo funksionale nuk duket si një variant i mundshëm, tani pranohet në shumë qarqe se disa nga mënyrat e shtrirjes, si për shembull paqeruajtja në Afrikë dhe në Ballkan duhet të vihen nën simbolin e BE-së, ndërsa të tjerat, si operacionet aktuale në Afganistan kundër Talibanëve, duhet t'i përkasin NATO-s.

Përvoja të Ballkanit

Një shembull i bashkëpunimit të suksesshëm lidhur me çështjet e sigurisë ndërmjet NATO-s dhe Bashkimit Europian ishte Marrëveshja e Ohrit për të parandaluar luftën në ish-republikën jugosllave të Maqedonisë. Në shkurt të 2001, në

kulmin e konfliktit ndër-etnik midis forcave të sigurisë së vendit dhe kryengritësve shqiptar të armatosur, NATO dhe Bashkimi European koordinuan negociatat që çuan drejt Marrëveshjes së Ohrit në gusht të po atij viti...

Po në këtë muaj, NATO filloi *operacion 30-ditor "Essential Harvest"* për të çarmatosur grupet etnike shqiptare dhe për të shkatërruar armët e mbledhura prej tyre. Kjo u pasua nga Operacioni 3-mujor "Amber Fox", i cili mbronte vëzhguesit ndërkombëtarë që mbikëqyrnin zbatimin e marrëveshjes së paqes në ish-republikën jugosllave të Maqedonisë. Më pas, për të zvogëluar mundësinë e kthimit prapa, NATO ra dakord të ofronte mbështetjen e saj me operacionin "Allied Harmony", nga dhjetori 2002 deri në mars të vitit pasardhës, moment në të cilin operacioni i kaloi Bashkimit European.

Në fund të marsit 2003, Bashkimi European organizoi misionin e parë paqeruajtës, "Operacioni Konkordia", i cili ishte gjithashtu zbatimi për herë të parë i marrëveshjes së "Berlin Plus". Disa zyra qendrore të NATO mbetën në Shkup për të asistuar autoritetet e vendit në zhvillimin e reformave në sektorin e mbrojtjes dhe përshtatjen me standardet e NATO-s.

Bashkimi European e mbajti "Operacionin Konkordia" deri në dhjetor të 2003, që më pas u ndoq nga një mision civil policor, "Operacioni Proxima", i cili vazhdoi deri gjatë fundit të 2005. Gjatë kësaj kohe, autoritetet policore të BE-së bashkëpunuan me homologët e tyre në ish-republikën jugosllave të Maqedonisë. Ata gjithashtu ndihmuan në reformimin e Ministrisë së Brendshme të vendit, si dhe në ofrimin e ndihmës me qëllim për të realizuar menaxhimin e integruar të kufijve.

Një shembull tjetër pozitiv është Bosnja dhe Hercegovina. Në dhjetor të 2004, NATO përfundoi operacionin e saj 9-vjeçar "Forca Zbatuese (IFOR) "Forca Stabilizuese (SFOR)", dhe ia dorëzoi Bashkimit European, i cili menjëherë filloi operacionin "Althea" me 6 mijë trupa.

Në operacionet në ish-republikën jugosllave të Maqedonisë Zv/komandanti Suprem i Forcave Aleate të NATO-s për Europën (DSACEUR) u emërua Komandant

Operacional, duke vepruar nën drejtimin dhe udhëheqjen politike të Komitetit Politik dhe të Sigurisë së Bashkimit Europian (PSC).

NATO dhe Bashkimi Europian duhet të fokusohen në forcimin e kapaciteteve të tyre më kryesore, në forcimin e aftësive ndërvepruese dhe doktrinës koordinuese, në planifikimin, teknologjinë, pajisjet dhe trajnimin.

NATO mban zyra qendrore modeste në Sarajevë për të ndihmuar autoritetet e Bosnjës dhe Hercegovinës në reformën për mbrojtje dhe merret me disa detyra operacionale që përfshijnë luftën kundër terrorizmit dhe ndalimin e personave të akuzuar për krime lufte, si dhe një koordinim inteligjence me Forcat e BE (EUFOR). Megjithëse operon në të njëjtin mandat si SFOR, EUFOR është ndryshe sepse ka një organizim me fleksibël, sepse lufton krimin e organizuar, si dhe sepse ka lidhje me policinë kombëtare.

Forcimi i aftësive

Në mënyrë që të forcohet bashkëpunimi, të dyja, NATO dhe Bashkimi Europian duhet të fokusohen në forcimin e kapaciteteve të tyre kyçe, në forcimin e aftësive ndërvepruese dhe doktrinës koordinuese, në planifikimin, teknologjinë, pajisjet dhe trajnimin. Deklarimi i Aleancës në Samitin e Rigës 2006 shënoi një kthesë të madhe për sa i përket aftësisë së plotë operacionale nga Forcat Kundërvepruese të NATO-s (NRF). Forcat e reagimit të shpejtë të NATO-s tani janë të afta për të kryer misione kudo në botë, si dhe nëpërmjet të gjithë spektrit të operacioneve.

Që prej emergjencës në 2004, plani i Bashkimit Europian për të zhvilluar “Grup Luftë” kombëtare dhe ndërkombëtare përbën një fokusim të madh të Politikave Europiane të Mbrojtjes dhe Sigurisë (ESDP). Secili “Grup Luftë” përfshin 1500 trupa, dhe dy prej këtyre paketave të forcës me arme të kombinuara janë në detyrë në çdo kohë, duke i siguruar BE-së një aftësi ushtarake “në gatishmëri” për t’iu përgjigjur

krizave nëpër botë. Gjithsesi, kërkohet më shumë përpjekje në fusha të tilla si koordinimi civilo-ushtarak për të siguruar që “Grupet e Luftës” të jenë të afta të përmbushin potencialet e tyre.

Të ndërgjegjshëm për një ngjashmëri potenciale midis NRF dhe “Grupeve të Luftës” së BE, NATO dhe Bashkimi Europian kanë filluar të punojnë për të siguruar që të dy forcat të jene komplemetare me njëra-tjetrën. Megjithatë, programet aktuale të përvetësimit dhe të investimit nuk ndeshen me nevojën e forcave ndërkombëtare të sotshme. NATO dhe roli i BE-së në këtë fushë duhet të bëhet plotësues, dhe bashkëpunimi midis dy organizatave duhet të përmirësohet për të garantuar sigurimin e aseteve me kosto sa më të ulët.

Drejt një partneriteti global

Bazuar në “përvojat e mësuara” në Ballkan, dhe duke ditur që arena e re e operacioneve është globale, bashkëpunimi ndërmjet dy organizatave duhet të synojë drejt një niveli të ri.

Duke pranuar dimensionin global gjithmonë e në rritje të sigurisë ndërkombëtare pas sulmeve terroriste të 9/11 shtatorit, NATO u angazhua në mënyrë të pakthyeshme në operacione “out-of-area” jashtë qendrës së gravitetit origjinal Euro-Atlantik. Duke marrë drejtimin e Forcave Mbështetëse të Sigurisë Ndërkombëtare (ISAF) në Afganistan, aleanca hapi dyert për një dialog politik, konsultim dhe partneritet me shtetet kryesore përtej hapësirës Euro-Atlantike, duke përfshirë Australinë, Zelandën e Re dhe Pakistanin.

Bashkimi Europian gjithmonë e më tepër është bërë aktor ndërkombëtar, që merret me menaxhimin e krizave ushtarake dhe civile, reformat në sektorin e sigurisë, forcimin e shtetit të së drejtës dhe misionet për ndihmë kufitare, brenda dhe jashtë territorit të fqinjëve të tyre drejtpërdrejt. Gjeografia përfshin Ballkanin, Kaukazin, Europën Lindore, Mesdheun dhe Lindjen e Mesme - por gjithashtu dhe vende të largëta si

Republika Demokratike e Kongos (RDK) dhe Indonezia. Vendosja e trupave të Bashkimit European në mesin e 2006 në RDK bëri edhe Saharaja e poshtme në Afrikë do të jetë një çështje kryesore e sigurisë dhe e shtrirjes së Bashkimit European.

Partneritetet në nivele globale pritet të ndërtojnë një kulturë bashkëpunimi në fushën e sigurisë ndërmjet Aleancës dhe aktorëve të tjerë, të reduktojnë keqkuptimet dhe konceptimet e gabuara, dhe të rrisin njohuritë dhe ndërgjegjësimin për kushtet rajonale, vendimtare këto për planifikimin e veprimeve efikase të sigurisë ndaj kërcënimeve aktuale dhe emergjente. Kundër kushteve për avancimin e bashkëpunimit operacional me partner ndërkombëtar gjeografikisht të largët, bashkëpunimi NATO-BE duhet të bëhet shtylla e një komuniteti të fortë Euro-Atlantik.

Por, në të shkuarën e largët, ka pasur dikur një garë mes më të mirësh' midis dy organizatave - për shembull gjatë bashkëpunimit NATO-BE në Darfur, i cili ndodhi pa u mbështetur te marrëveshja e Berlin Plus. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s Jaap de Hoop Scheffer nënvizoi me të drejtë që një rivalitet i tillë duhet të përfundojë, dhe të ndalohet çdo përsëritje e përpjekjeve për një rivalitet të tillë. Për më tepër, duhet të ketë një dialog të qëndrueshëm për të harmonizuar transformimin ushtarak dhe për të garantuar një bashkëpunim të qetë në planifikimin dhe kapacitetet e avancuara, të kombinuara këto me struktura fleksibël komunikimi.

NATO dhe Bashkimi European po përballen me sfida të ngjashme në një mori fushash. Një shembull i tillë është Kosova, ku ka një qëllim të qartë për një politikëbërje komplementare, si dhe për të krijuar lidhje të reja bashkëpunimi. Në përputhje me planin e Antisarit, Bashkimi European do të zëvendësojë prezencën e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, KFOR i udhëhequr nga NATO që aktualisht po kujdeset me paqen dhe stabilitetin mund t'i dorëzohet Bashkimit European, dhe një Përfaqësues Ndërkombëtar Civil i Bashkimit European do të jetë në ngarkim të zbatimit të statusit final të marrëveshjes.

Nëpërmjet një misioni civil nën mbrojtjen e Komitetit të Politikave të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (ESDP), Bashkimi Europian do të punojë gjithashtu për të konsoliduar shtetin e së drejtës. Menaxhimi i Kosovës, një shtet de facto, do të përfaqësojë një sfidë të rëndësishme për mundësinë e menaxhimit të krizave civile të Bashkimit Europian. Rezultati do të varet gjerësisht nga qëllimi i mandatit që do të propozohet nga një Rezolutë e Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, dhe nga angazhimet e anëtarëve të shteteve të Bashkimit Europian.

Një tjetër fushë produktive për zgjerimin e bashkëpunimit potencial të NATO-BE në Ballkan mund të shfaqet, nëse nisma e Ministerialit të Mbrojtjes e Evropës Juglindore (SEDM) do të zgjerohej për të përfshirë planifikimin e emergjencave civile, dhe ministrat e Brendshëm në këtë rast të formonin një Ministerial të Evropës Juglindore të Mbrojtjeve Kombëtare (SEHDM).

Duke lidhur trupin e ri me Iniciativën Kooperuese të Evropës Juglindore (SECI), Qendra Rajonale për Luftimin e Krimit Ndërkufitar në Bukuresht, lidhja SEHDM-SECI mund të bëjë pika kyçe organizative për të krijuar një strategji të koordinuar NATO-BE në Ballkanin Perëndimor. Kjo mund të përdorej pastaj për të luftuar trafikimin e drogës, armëve dhe armatimeve të lehta (SALW), si dhe të qenieve njerëzore.

Për më tepër, duke ngritur një qendër rajonale koordinuese për mbrojtjen civile nën vëzhgimin SEHDM, forumi i ri mund të lidhet gjithashtu me Grupin e Evropës Juglindore (SEEBRIG) në Constanta, Rumani, për t'u marrë me çështjet e mbrojtjes civile.

Rajoni i Detit të Zi është një zonë tjetër ku NATO dhe Bashkimi Europian duhet të plotësojnë njëra-tjetrën. Organizatat kanë synime të përbashkëta në këtë zonë - të ruajnë stabilitetin, të përmirësojnë perspektivën ekonomike të rajonit, të promovojnë reformat në sektorin e sigurisë, të pakësojnë trafikimin e armëve, drogave dhe të qenieve njerëzore, të përmirësojnë menaxhimin kufitar dhe demokratizimin.

Aktualisht, NATO dhe Bashkimi Europian nuk kanë një vizion strategjik të përbashkët për rajonin e Detit të Zi, përderisa

ndryshimet konceptuale janë pengesa për një avancim të uniformuar. Njëpërmjet Politikave të Fqinjësisë Europiane (ENP), Bashkimi Europian synon të ndërtojë një “rreth kontaktesh” përreth periferisë së tij, duke përfshirë Detin e Zi, dhe nga ana tjetër duke marrë parasysh faktin që rajoni është njëkohësisht një urë drejt rajonit të pasur me energji të Detit Kaspik dhe një pengesë kundër kërcënimeve ndërkombëtare, BE është duke promovuar një koncept ‘urë/pengesë’ për zonën.

Afganistani gjithashtu ofron mundësi për përforcimin e bashkëpunimit NATO-BE. Vendi në mënyrë urgjente ka nevojë për policë, gjyqtarë, inxhinierë, punonjës, këshilltarë dhe administratorë. Të gjitha këto burime janë të disponueshme nga Bashkimi Europian, por jo për paqeruajtësit e NATO-s. Në nëntor të 2006, Komisioni i Bashkimit Europian aprovoi •10.6 milionë për të mbështetur ofrimin e shërbimeve dhe përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet Ekipeve për Rindërtimin e Provincave të drejtuara nga NATO (PRTs). Për më tepër, misioni i NATO-s në Afganistan mund të mbështetet dobishmërisht nga misioni civil (të ESDP-së) për asistencë për vendosjen e një shteti të së drejtës dhe trajnimit policor.

Sfera të reja bashkëpunimi

Sot, grupet terroriste dhe rrjetet kriminale operojnë në të gjithë botën, duke përfituar nga komunikimet në kohë, nga ndarja e informacioneve dhe liria relative e udhëtimit. Shkalla në të cilën kombet dhe organizatat si NATO dhe Bashkimi Europian ndajnë informacionet, bashkëpunojnë në ndalimin e grupeve të tilla dhe angazhohen në anti-terrorizmin dhe luftimin e krimit të organizuar, është thelbësore.

Të dyja NATO dhe Bashkimi Europian janë aktualisht të preokupuara për të bërë të ditur ndërmjet anëtarëve të shteteve respektive për nevojën dhe rezultatet e të punuarit së bashku në përballjen me kërcënimin e sulmeve bio-terroriste dhe pandemike.

Bashkimi European është duke kërkuar mënyra të reja për t'i bërë shtetet anëtare të punojnë së bashku, megjithëse është duke u përballur me kufizime të burimeve të disponueshme dhe refuzimin e sugjerimit të BE-së për një inventarizim qendror të vaksinave. NATO, ndërkohë, është duke punuar për të zhvilluar aftësitë e kërkuara për situata të tilla dhe për të integruar qendrat e ndryshme mjekësore të ekspertizës në ushtrime për menaxhimin e krizave. Përkundrejt këtyre zhvillimeve, duket se ekziston një ndjenjë e përhapur gjerësisht se midis dy organizatave ka vend për më shumë dialog, bashkëpunim dhe koordinim.

Në mënyrë që t'i përballojë me sukses sfidat e sulmeve bio-terroriste dhe pandemike, EU dhe NATO kanë nevojë të përdorin bashkë informacionin dhe ekspertizën, të fokusohen më shumë në menaxhimin e riskut, të qenit të informuar kundrejt reagimeve të kulturave të tjera, të ndajnë praktikrat më të mira kombëtare në një shkallë ndërkombëtare dhe të arrijnë një nivel më të lartë të vigjilencës. Nga një këndvështrim institucional, Qendra Europiane për Parandalimin e Sëmundjeve dhe Qendra e NATO-s për armët e shkatërrimit në masë duhet të tregojnë mënyrën për avancimin e një bashkëpunimi të nevojshëm.

Një fushë tjetër premtuese për bashkëpunimin e ardhshëm EU- NATO është sigurimi i energjisë. Për shumë vende të BE-së, mbështetja në burime të huaja të energjisë ka qenë e mundshme për shumë kohë, ndërsa për të tjerat është diçka e re, por një e ardhme e afërt. Ndërsa tabloja e ofertës së energjisë ndryshon, gjithashtu kërkesa botërore është në rritje. Emergjencia e Kinës dhe Indisë si fuqi ekonomike kryesore do të shtojë kërkesën për energji botërore në pothuajse 60% më shumë në 20 vitet e ardhshme duke përkeqësuar konkurrencën midis vendeve importuese të energjisë.

Ndihet nevoja për zhvillimin e një reagimi të koordinuar në kohë kundrejt këtyre sfidave, të cilat përfshijnë aftësitë dhe filozofinë e forcave të armatosura dhe industritë e mbrojtjes, një fushë në të cilën Aleanca është pozicionuar mirë për të dalë me përgjigje të reja. Aktualisht, Aleanca është duke eksploruar mënyra me anë të të cilave mund të kontribuojë

në sigurimin e rrjeteve transportuese të energjisë. Si përfundim, NATO dhe EU ndajnë sfidat kryesore të mbrojtjes. Është më se i logjikshëm një bashkëpunim më i madh në këto fusha midis tyre që do të çojë në më shumë arritje të favorshme për të dyja.

Mundësitë ekzistojnë për të identifikuar fushat të reja bashkëpunimi, duke u mbështetur te përvojat nga bashkëpunimi i deritanishëm. Në mënyrë që të ndërtohet një partneritet më solid dhe gjithëpërfshirës, NATO dhe EU duhet të punojnë për të arritur një bashkëpunimin praktik dhe më tej të bien dakord për axhendën transatlantike.

Dr. Adrian Pop është profesor në Universitetin Kombëtar për Studime Politike dhe Administrim Publik ne Bukuresht të Rumanisë.

DMITRI TRENIN *

**NATO DHE RUSIA:
MENDIME REALISTE DHE SUGJERIME
PRAKTIKE**

Dmitri Trenin hedh një vështrim kritik mbi marrëdhëniet NATO-Rusi me rastin e përvojtorit të 5-të të Këshillit NATO-Rusi dhe 10-vjetorit të Aktit Themelues të Parisit për Marrëdhëniet Dypalëshe.

Për afro një dhjetëvjeçar pas krijimit të Federatës Ruse, çështjet e marrëdhënieve me NATO-n ishin një element kyç në politikën e jashtme të Moskës. Për të, Aleanca ishte qoftë një simbol i Luftës së Ftohtë ashtu edhe një Klub i drejtuesve të vendeve perëndimore. Rusia u lëkund ndërmjet përpjekjeve me gjysmë zemre për t'iu bashkuar Aleancës me forma të veçanta ashtu edhe përpjekjeve pa dobi për të ndaluar vendet e saj fqinje që të kërkonin anëtarësi në këtë organizatë si një garanci sigurie kundrejt vetë Rosisë.

Tre zhvillime kryesore kanë përcaktuar marrëdhëniet gjatë viteve '90:

- Bosnja dhe Hercegovina, ku përdorimi i forcës së NATO/SHBA çoi në nënshkrimin e Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit dhe operacionet paqeruajtëse që pasuan, në të cilën trupat ruse morën pjesë nën komandën e NATO-s.

* Dmitri Trenin është bashkëpunëtor i lartë shkencor Senior Associate i Carnegie Endowment for International Peace dhe Drejtor i Studimeve në qendrën e kësaj organizate në Moskë.

- Ftesa për zgjerim e NATO-s në 1997 ndaj Çekisë, Hungarisë dhe Polonisë e anëtarësimi i tyre në 1999, ishin një lajm i hidhur për Moskën, të cilën u përpoqën ta ëmbëlsonin nëpërmjet krijimit të Këshillit të Përbashkët të Përhershëm (PJC-Permanent Joint Council), një mekanizëm konsultativ mes Ruisë dhe Aleancës;

- Kriza e Kosovës në 1999 e cila kulmoi me fushatën ajrore 78-ditëshe të NATO-s kundër Republikës Federale të Jugosllavisë, pavarësisht protestave të ashpra të Ruisë.

Pavarësisht këtyre çështjeve serioze, Rusia vazhdoi të merrte pjesë në operacionet e Forcës Stabilizuese (SFOR/Stabilization Force) në Bosnje Hercegovinë dhe gjithashtu kërkoi t'i bashkohej Forcës së Kosovës (KFOR/Kosovo Force) në qershor 1999, përsëri nën komandën e NATO-s. Megjithatë pas përfundimit të presidencës së Boris Jelcinit në Kremlin, marrëdhëniet NATO-Rusi përjetuan një ngrirje të thellë.

Një fillim i ri?

Në ditët e para të mandatit të Presidentit të porsazgjedhur rus Vladimir Putin, kishte një shpresë për një fillim të ri. Disa besonin se nëse Rusia do të anëtarësohej në NATO, kjo do të shërbente si një plumb i argjendtë, duke e larguar përgjithmonë armiqtë e dyshim të drejt një miqësie të sinqertë. Por nuk ndodhi kështu. Marrëdhëniet u rivendosën dhe anëtarësimi u provua sërish, por përsëri pa sukses.

Megjithatë pati edhe përfitime të paparashikuara. Pak javë pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 në SHBA, fushata ushtarake e drejtuar nga SHBA, largoi kërcënimin më serioz të jashtëm të pas-Luftës së Ftohtë për sigurinë e Ruisë, regjimin Taleban në Afganistan. Menjëherë pas kësaj, NATO ndërmori një mision për të ndihmuar në stabilizimin e Afganistanit - fushata e parë ushtarake e Aleancës në një zonë jashtë saj. Nga pikëpamja e Moskës, një aleancë e cila për dekada kishte përballuar BS në Europën Qendrore, ishte kthyer në një koalicion që po ndihmonte në sigurinë e Azisë Qendrore, i cili përbënte krahu më të rrezikuar të Ruisë.

Pas një ecje plot zigzage në vitet 1990, e përparimeve të dukshme të bashkëpunimit në vitet e para të këtij dhjetëvjeçari, së fundi marrëdhëniet mes tyre janë vështirësuar sërish, duke dëshmuar në mënyrë të qartë se për përmirësimin e tyre duhen të bëhen përpjekje të përbashkëta nga të dyja palët.

Në 2002, marrëdhëniet e Aleancës me Rusinë u ripërcaktuan dhe u krijua Këshilli NATO-RUSI (NRC-NATO-Russia Council). Përkundër Këshillit të Përbashkët të Përhershëm (PJC), i cili ishte kryesisht një strukturë dypalëshe, NRC takohet me 27 vendet anëtare kështu që secili vend merr pjesë me të gjithë kapacitetin e tij dhe ndihet i barabartë me të tjerët. Në këtë mënyrë marrëdhëniet NATO-Rusi kanë mundur të mbijetojnë e të zhvillohen, megjithëse politika e jashtme e Moskës pas 2003 e këtij është duke u bërë më e pavarur e agresive, e marrëdhëniet NATO-RUSI filluan të acarohen.

Këshilli NATO-Rusi takohet rregullisht, takimi më i fundit ishte në qershor 2007 në Shën Petërburg dhe Rusi për të përkujtuar 5-vjetorin e tij të krijimit. Rusia ka një mision në selinë e NATO-s dhe një zyrë ushtarake pranë Komandës së Operacioneve Aleate (SHAPE-Allied Command Operations), ndërkohë që NATO ka në Moskë një zyrë lidhëse për çështjet ushtarake dhe informacion. Këtë bashkëpunim e mundësojnë një sërë interesash të përbashkëta duke filluar që nga lufta kundër terrorizmit e deri te sigurimi i mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Nën kujdesin e NRC, punojnë 17 nëngrupe mbi çështjet kyçe të bashkëpunimit. Sipas rastit realizohen stërvitje të përbashkëta në zonat të ndryshme, të tilla si përgjigjja ndaj emergjencave. Anijet luftarake ruse kanë filluar të marrin pjesë në operacionet detare anti-terroriste të NATOS në Mesdhe, të quajtura *Përpjekje Aktive/Active Endeavour*. Moska nënshkroi me NATO një Marrëveshje Partneriteti për Statusin Paqësor të Forcave (SOFA-Partnership for Peace Status of Forces Agreement) si dhe lejon Gjermaninë e Francën që të përdorin korridoret përgjatë territorit të saj në rrugën drejt Afganistanit. Ndërkohë ekziston një bashkëpunim i gjerë në fushën e reformës së mbrojtjes,

bashkëpunimin ushtarak (me rëndësi është programi për ndërveprueshmërinë ushtarake Rusi-NATO) të kërkimeve e shpëtimit në det si dhe një projekt i përbashkët pilot për kualifikimin e personelit afgan dhe atij në Azinë Qendrore që merret me luftën kundër narkotikëve.

Sigurisht që Rusia, në ditët e sotme e kupton NATO-n më mirë sesa në vitet'90. E gjithë kjo situatë përcjell një nivel stabiliteti dhe parashikueshmërie për sa i përket marrëdhënieve mes tyre, megjithëse pritshmëritë nga të dyja palët janë ndeshur edhe me rënien në nivele të ulëta të kësaj shkalle bashkëpunimi.

Ambivalenca/Vlerësimi i dyfishtë

Në Moskë ekziston një vlerësim i dyfishtë tepër i dukshëm ndaj situatës aktuale. Rusia e trajton NATO-n si “faktor” gjeopolitik më shumë sesa një partner. Vendi ka tani një dritare mbi Aleancën - por akoma nuk e ka hapur atë. Rusia është duke shprehur me zë të lartë kundërshtime të forta ndaj atyre që ajo i shikon si zhvillime negative:

- Mundësia e Aleancës për pranimin e Gjeorgjisë dhe Ukrainës si anëtare.

- Përdorimi i përkohshëm nga SHBA, në bazë rotacioni, i lehtësive ekzistuese për qëllime ushtarake në Bullgari e Rumani dhe në mënyrë të veçantë:

- Vendosja e planifikuar e elementëve të një sistemi të mbrojtjes me raketa balistike amerikane në Poloni dhe Republikën Çeke.

Rusia ka gjithashtu një sërë vërejtjesh e shqetësimesh të tjera: vendet e NATO-s kanë vonuar ratifikimin e Traktatit të Miratuar mbi Forcat Konvencionale në Europë (CFE- Adaptet Treaty on Conventional Forces in Europe)* dhe mungesën e dëshirës së Aleancës për të vendosur marrëdhënie formale me Organizatën e Traktatit të Sigurisë Kolektive të drejtuar nga Rusia (CSTO-Collective Security Treaty Organisation).**

Disa nga anëtarët më të rinj të NATO-s risjellin në mendje kujtimet e sundimit Sovjetik. Në këtë mënyrë Moska është

duke vënë theksin mbi marrëdhëniet dypalëshe me vende të veçanta evropiane, duke përqendruar mbi Europën Qendrore e duke shpresuar të shkojë më tej drejt perëndimit.

Është mëse e qartë se pesë vjet pas Deklaratës së Romës mbi Marrëdhëniet NATO-Rusi dhe 10 vjet pas Aktit Themelues të Parisit mbi Marrëdhëniet Dypalëshe të Bashkëpunimit, Sigurisë, marrëdhëniet NATO-Rusi aktualisht nuk po shkojnë drejt një përputhje shumë të madhe. Megjithatë vazhdimi i këtyre marrëdhënieve mbetet i rëndësishëm. Ajo çfarë nevojitet më së shumti, është administrimi i tyre në mënyrë të kujdesshme, për të garantuar zvogëlimin e rivaliteteve të brendshme e për të zgjeruar bashkëpunimin aty ku është e mundshme.

Zgjerimi

Në lidhje me çështjen e zgjerimit, Moska do të dëshmonte zgjuarsin nëse do t'ia linte këto vendime vendeve përkatëse. Nëse vendet kandidatë i bashkohen Aleancës dhe nëse po, kur - kjo u duhet lënë në dorë vetë këtyre shteteve. Për sa i përket qëllimeve të deklaruar të Moskës, ndërhyrja ruse mund të sillte vetëm pasoja të kundërta. Pozicioni zyrtar i Kremlinit duke trajtuar anëtarësimin në Aleancë si e drejtë sovraane e secilit shtet dhe përqendrimi në aspektet e administrimit të sigurisë së vetë Rusisë, do të ishin hapi i duhur në këtë rast.

Ndoshta Gjeorgjia mund të përfitojë Planin e Veprimit për Anëtarësim/Membership Action Plan në pranverë të vitit 2008, duke e vendosur këtë vend në rrugën për t'iu bashkuar Aleancës pak vite më vonë. Megjithatë, në Ukrainë, NATO duhet të pranojë se çështja e anëtarësimin vazhdon të mbetet një çështje për të cilën ka ndarje politike dhe mundësi për destabilitet. Përballimi me qetësi i këtyre situatave në të dy anët do të ndihmonte në ruajtjen e stabilitetit e sigurisë në lindje të Europës.

Mbrojtja Raketore

Megjithëse kjo çështje nuk i përket NATO-s, plani i SHBA për mbrojtjen raketore balistike përfaqëson një rrezik dhe mundësi për marrëdhëniet NATO-Rusi. Rreziku qëndron në faktin se nëse SHBA e lënë jashtë Rusinë nga ky plan, atëherë në politikat e sigurisë e të mbrojtjes së Ruisë mund të mbizotërojë fryma anti-perëndimore, çka pa diskutim nuk përbën një objektiv të Uashingtonit.

Mundësia është se nëse kjo çështje do të përdoret për të ringjallur bashkëpunimin për armët e shkatërrimit në masë, mirëbesimi dypalësh do të forcohet. Kjo mund të çojë në një ndërveprim më të ngushtë mbi burimet e rrezikut të perceptuar: që është programi bërthamor dhe i raketave të Iranit. Bashkëpunimi për mbrojtjen e raketave balistike nuk do të jetë i lehtë, por është e sigurt se ia vlen të përpiqesh për ta arritur atë. Ndërkohë, si alternativë ndaj planeve aktuale të SHBA, nga Presidenti rus është propozuar një sistem i përbashkët - i cili do të përdorte radarët dhe lehtësitë e tjera për zbulim të Ruisë, ashtu si edhe burime të përbashkëta për të shkëmbyer informacion.

Marrëdhëniet Rusi-NATO kanë qenë në gjendje të zhvillohen e të mbijetojnë, megjithëse politika e jashtme e Moskës nga 2003 e këtej është bërë më e pavarur e agresive. Përpjekjet e përbashkëta të NATO-s e Ruisë në fushën e teatrit të mbrojtjes raketore mund të shërbejnë si një model për bashkëpunimin e mundshëm ushtarak SHBA-Rusi e mund të ofrojnë një bazë, për një qasje më të integruar e gjithëpërfshirëse, në lidhje me një arkitekturë të mbrojtjes raketore në Europë.

Njëkohësisht çështja e Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme Veprimi (Intermediate-Range Nuclear Forces-INF) të ndaluara nga Traktati i 1987, e tashmë e ringritur sërish nga zyrtarët rusë, është një thirrje për konsultime të ngushta mes NATO-s e Ruisë, për sa i përket forcimit të mirëbesimit dypalësh dhe parandalimit të një gare destabilizuese armatimesh.

Traktati i CFE

Që prej nënshkrimit të tij më 1990, Traktati për Forcat Konvencionale në Europë (CFE)*** ka qenë dokumenti kryesor mbi të cilën është mbështetur themeli i rendit të sigurisë europiane. Ai duhet të vazhdojë ta luajë këtë rol. Shqetësimet e Moskës rreth anëtarësimit të vendeve baltike në 1999 në Adapted CFE Treaty dhe ratifikimi i saj nga SHBA dhe vendet e tjera perëndimore janë të sigjerta dhe duhet të merren seriozisht, tërheqja e Ruisë nga Traktati për Forcat Konvencionale në Europë/CFE Treaty nuk është në interesin e askujt.

Në të njëjtën kohë, shqetësimet e anëtarëve të NATO-s rreth zbatimit nga ana e Moskës të angazhimeve të saj të Stambollit, për sa i përket trupave të mbetura ushtarake në Gjeorgji e Moldavi, bënë thirrje për veprim të përbashkët megjithëse sipas pikëpamjes ruse nuk ka një lidhje formale ndërmjet këtyre angazhimeve dhe ratifikimit të Adapted CFE Treaty. ****

Deklarata e Presidentit Putin në fillim të këtij viti për një “moratorium” mbi këtë traktat, u pasua nga një thirrje e Ruisë për një konferencë të jashtëzakonshme, e cila u zhvillua në mes të qershorit. Rusia pothuajse kishte filluar t’i shtynte inspektimet e CFE-së, por pas takimit të Presidentit Putin me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s gjatë festimeve të përvjetorit të krijimit të Këshillit NATO-Rusi (NRC), regjimi i inspektimeve rifilloi. Presidenti ndërmori një hap tjetër pozitiv teksa rekomandoi se çështjet e CEF duhet të diskutohen në këtë këshill dhe ky rekomandim u mor parasysh.

Paqeruajtja

Konflikti i ngrirë i Moldavisë mbi Dniester - paraqet një mundësi reale për të filluar operacionin e parë paqeruajtës, në të cilën Rusia e NATO mund të veprojnë si partnerë të barabartë. Në këtë rast ndikon edhe fakti se kjo mbetet një ndër pikat më pak të vështira për t’u zgjidhur në ish-republikat e BS.

Moldavia ka ritheksuar qëllimin e saj për të qenë e përbajtur në raport me kërkesën e saj për anëtarësim në NATO. Në këtë rast operacioni duhet të përfshijë vetëm një forcë të kufizuar ushtarake e policore, pra disa qindra njerëz. Rusia është e gatshme për çdo zgjidhje në Moldavi e për këtë duhet të presim që të veprojnë si e barabartë me NATO-n.

Nëse kjo do të rezultonte e suksesshme, atëherë një operacion i tillë i përbashkët mund të hapte rrugën për vendet perëndimore që të ratifikonin Adapted CFE Treaty. Një iniciativë e tillë mund të shërbente gjithashtu edhe për misionet të tjera të përbashkëta paqeruajtëse, veçanërisht në Kaukazin Jugor në situata të cilat përkojnë me atë që mund të quhet “kriteri moldav”, pra kur Rusia ka interes për të gjetur një zgjidhje, është pjesë e pandashme e saj si dhe e ka të pamundur ta zgjidhë këtë konflikt e vetme.

Disa nga anëtarët më të rinj të NATO-s risjellin kujtimet e sundimit sovjetik. Në këtë mënyrë Moska është duke vënë theksin mbi marrëdhëniet dypalëshe me vende të veçanta europiane duke përqendruar mbi Europën. Për vite me radhë Rusia dhe NATO kanë punuar për të rritur ndërveprueshmërinë, me qëllim që të përfshihen në operacione të përbashkëta paqeruajtëse. Por as Afrika dhe as Lindja e Mesme nuk duket se mund të jenë zonat ku mund të zbatohet kjo ide. Nga ana tjetër, zona të caktuara të ish - sipas pikëpamjes time - duket se përfaqësojnë një mjedis tepër të përshtatshëm për të provuar ndërveprueshmërinë.

Afganistani

Rusia nuk ka arsye të ndiejë ndonjë kënaqësi të fshehur si rezultat i vështirësive që po përballojnë NATO dhe SHBA në Afganistan. Nëse dështojnë përpjekjet ndërkombëtare për të stabilizuar këtë vend, atëherë Moska do të përballlet me ringjalljen e kërcënimit taleban në pjesën më të dobët të Azisë Qendrore. Megjithatë është e nevojshme një konsultim më i ngushtë mes Ruisë dhe Perëndimit se si ta kthejnë kahen kundër radikalëve islamikë.

Ndihma ndaj të moderuarve që të mbajnë në zotërim Kabulën dhe provincat e Afganistanit është një alternativë më e mirë sesa të fillosh sërish rikrijimin e Aleancës e Veriut në Taloqan.

NATO-CSTO

Ndërkohë, është edhe çështja e lidhjeve mes NATO-s dhe CSTO (Organizatën e Traktatit të Sigurisë Kolektive të drejtuar nga Rusia (CSTO-Collective Security Treaty Organisation). Deri tani NATO ka qenë shumë ngurruese që të formalizojë ndonjë marrëdhënie me këtë organizatë duke pasur frikë së një hapi tillë do të vuloste mbizotërimin rus në Detin e Zi.

Në realitet nuk ka shumë fakte që flasin për një zotërim të tillë. Kazakistani ka ndjekur hapur një politikë me shumë drejtime, duke manovruar me sukses ndërmjet Moskës, Pekinit dhe Uashingtonit. Besnikëria e Uzbekistanit ndaj Rusisë nuk është e sigurt e në rastin më të mirë është e përkohshme për sa kohë Tashkent refuzon të jetë gur shahu i Moskës. Dy vjet pasi Organizata për Bashkëpunim e Shangait (SCO)***** bëri thirrje për tërheqjen e SHBA, Kirgizistan akoma vazhdon të lejojë praninë e një bazë ushtarake amerikane shumë afër një baze më të vogël ruse. Taxhikistani ka përshtatur një politikë të jashtme të kundër me atë ruse, madje presidenti i kësaj republike ka hequr simbolikisht edhe prapashtesën ruse të mbiemrit të tij.

Duke u marrë me CSTO, NATO mund të kontribuojë që evolucionin e kësaj organizate të shkojë drejt një angazhimi bashkëkohor, për sa i përket sigurisë rajonale. Ajo duhet të garantojë Moskën se nuk kërkon ta zhvendosë Rusinë si një aktor kryesor në Azinë Qendrore, gjë e cila nuk do të ishte në interesin e vetë Perëndimit.

Marrëveshja mbi një lidhje NATO-CSTO mund të vijë si pjesë e një pakete duke e hapur SCO/Organizata për Bashkëpunim e Shangait edhe ndaj SHBA e duke i dhënë asaj statusin e vëzhguesit. Është e pakuptimtë për anëtarët e

NATO-s që Rusia dhe Kina të vazhdojë të luajnë një lojë të vogël për rivalitet rajonal me çmimin që i lejon kundërshtarët e tyre të përbashkët t'i marrin ato një nga një.

Partneriteti NATO-Rusi mund të jetë në një pikë kthese . Pas një ecje plot ndalesa gjatë viteve 1990, përmirësimeve të qëndrueshme në vitet e para të kësaj dekade, si dhe vështirësive të marrëdhënieve në vitet e fundit, është mëse e qartë se përmirësimi i qenësishëm i tyre në vitet në vazhdim kërkon përpjekje domethënëse nga të dy krahët.

Rusia duhet t'i lerë fqinjët e saj t'i bashkohen NATO-s nëse ata dëshirojnë. Në të njëjtën kohë NATO duhet të mendojë në mënyrë strategjike rreth atyre vendeve që u ofron anëtarësim. Bashkëpunimi mbi mbrojtjen raketore - duke përjashtuar për këtë periudhë kohe planin kundërshtues të SHBA për platformat europiane të raketave balistike - duhet të jetë paktën pjesë e këtyre synimeve, me qëllim që të nxitet bashkëpunimi në fushën e mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe krijimit të mirëbesimit për konsultime të mëtejshme mbi Traktatin e INF. Përtej kësaj, të dyja palët, kanë nevojë të ndërmarrin hapa për të garantuar ratifikimin e Adapted CEF Treaty. Ndërveprueshmëria NATO-Rusi mund dhe duhet të provohet në operacione të përbashkëta paqeruajtëse në zonat e ish-Bs si Moldavia. Rusia dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të këshillohen mirë për të bashkëpunuar në stabilizimin e Afganistanit - dhe në parandalimin e trafikut të drogës nga ky vend. Së fundi NATO duhet të angazhohet edhe ndaj CSTO.

Sipas pikëpamjes time këto veprime do ta përmirësojnë patjetër partneritetin mes NATO-s e Ruisë.

*Adapted CFE Treaty (shih më poshtë edhe CFE Treaty***)

Marrëveshja mbi Përshtatjen e Traktatit mbi Forcat e Armatosura Konvencionale në Europë (CFE-II)/Agreement on Adaptation of the Treaty on Conventional Armed Forces in Europe (CFE-II)

Kjo marrëveshje e njohur si Adapted CFE Treaty/ Traktati i Përshtatur i CFE-së është një rishikim i traktatit të parë, pra i Traktatit të CFE dhe u nënshkrua gjatë Samitit të OSBE-së në Stamboll në 18-19 nëntor 1999. Iniciativa për rishikimin e tij lindi për shkak të situatës së ndryshme gjeopolitike të pas Luftës së Ftohtë dhe i vendoste kufizime për forcat e armatosura konvencionale tashmë në bazë shtetesh, në vend të blloqeve ushtarake siç ishte parashikuar në marrëveshjen fillestare të nënshkruar më 1990. Vendet anëtare të NATO-s refuzuan ta ratifikojnë traktatin për sa kohë Rusia nuk përmbushte të ashtuquajturat “*Angazhimet e Stambollit*”, të miratuara në Konferencën e OSBE-së në Stamboll, të cilat parashikonin tërheqjen e trupave ruse nga Moldavia e Gjeorgjia. Për shkak se Rusia nuk ishte dakord me këtë kushtëzim e më pas edhe me planin e mbrojtjes raketore të SHBA-së në Europë, presidenti rus Putin kërcënoi për një “moratorium” mbi Traktatin e Rishikuar të CFE/Adapted CFE Treaty gjatë një fjalimi të tij në 26 prill 2007. Për këtë qëllim me iniciativën e Ruisë u organizua edhe Konferenca e Jashtëzakonshme mes Palëve Shtetërore për Traktatin mbi Forcat Konvencionale në Europë, e cila u mbajt në Vjenë nga 11-15 qershori 2007. Për shkak se vendet anëtare nuk morën parasysh kërkesat e Ruisë më 14 korrik 2007 presidenti rus Vladimir Putin nxori një dekret që kishte për qëllim të pezullonte mbikëqyrjen e detyrimeve të traktatit, i cili do të hynte në fuqi pas 5 muajsh, pra 14 dhjetor 2007 dhe për këtë vendim njoftoi NATO-n dhe anëtarët e tij. Pezullimi përfshinte Traktatin mbi Forcat e Armatosura Konvencionale në Europë (CFE Treaty) dhe marrëveshjet pasuese të tij *CFE (I-A) Akti Përmbyllës i Negocimit mbi Fuqinë e Personelit të Forcave të Armatosura Konvencionale në Europë (CFE-I A) / Concluding Act of Negotiation on Personnel Strength of Conventional Armed Forces in Europe CFE II (Marrëveshja mbi Përshatjen e Traktatit mbi Forcat e Armatosura Konvencionale në Europë (CFE-II) / Agreement on Adaptation of the Treaty on Conventional Armed Forces in Europe (CFE-II)*. Në një dokument shpjegues, administrata presidenciale ruse përmend arsyet e qëllimeve të saj për pezullimin e përmbushjes së detyrimeve të traktatit. *Së pari*, Rusia e konsideron lidhjen mes Traktatit e Përshtatur të CFE (Adapted CFE Treaty) dhe tërheqjes së trupave të Ruisë nga Moldavia e Gjeorgjia si “jolegjitime” dhe “të sajuar”. Ajo e konsideron atë një çështje dypalëshe Rusi-Gjeorgji dhe Rusi-Moldavi e jo një çështje NATO-Rusi. *Së dyti* Tre shtetet baltike (Letoni, Lituani Estoni), të cilët kanë një kufi me Rusinë ndryshe nga pjesa tjetër e vendeve anëtare të NATO-s, nuk mbulohen nga Traktati i CFE (CFE Treaty) i Parisit 1990, pasi kur u nënshkrua ky traktat ata ishin pjesë e BS-së. Gjithashtu shtetet baltike si të gjitha shtetet anëtare të NATO-s nuk e kanë ratifikuar Traktatin e Rishikuar të CFE-së për arsyet e sipërpërmendura. Dëshira e Ruisë për një ratifikim të shpejtë dhe anëtarësim të shteteve baltike në traktatin e ratifikuar synon të zvogëlojë mundësinë e nevojën e zbarkimit të trupave të NATO-s në këto vende. *Së treti* Rusia thekson se zgjerimi i NATO-s në 1999 dhe 2004 i rriti pajisjet konvencionale të aleancës mbi limitet e përcaktuara në Traktatin e CFE-së. Si pasojë Rusia kërkon një “ulje kompensuese” të kufirit numerik të

NATO-s mbi pajisje të tilla. *Së katërti* Rusia përmend se vendosja e planifikuar e bazave amerikane në Rumani e Bullgari “i prek negativisht” këto vende, në raport me detyrimet për të ruajtur në raport të caktuar numerik forcash në kuadër të CFE treaty. *Së pesti* dokumenti kërkon një rritje të kufirit të numrit të forcave ruse në Kaukazin e Veriut (p. sh. Çeçeni) përmes një “vendimi politik” NATO-Rusi, për të kompensuar Rusinë për zgjerimin e NATO-s. *Së gjashti* Rusia dëshiron të rinegociojë dhe “modernizojë” Traktatin e Rishikuar të CFE/Adapted CFE treaty sapo ai të hyjë në fuqi. Rusia do të vazhdojë ta pezullojë vlefshmërinë e Traktatit në mënyrë të njëanshme, duke përfshirë edhe inspektimet, derisa vendet e NATO-s ta fusin në fuqi nga 1 korriku 2008 ose të paktën të përmbushin përkohësisht disa nga dispozitat e tij, për t’iu rikthyer rinegocimit të traktatit.

Më 19 nëntor 1999 këtë Traktat e nënshkruan 30 shtete: Armenia, Azerbajxhan, Bjellorusi, Belgjikë, Bullgari, Kanada, Çeki, Danimarkë, Francë, Gjeorgji, Gjermani, Greqi, Hungari, Islandë, Itali, Kazakistan, Luksemburg, Moldavi, Holandë, Norvegji Poloni, Rumani, Rusi, Sllovakia, Turqi, Spanjë, Ukrainë, UK dhe SHBA.

Ndërkohë 4 shtete nuk e nënshkruan traktatin kur iu bashkuan NATO-s pavarësisht një marrëveshje paraprake për të bërë këtë, Sllovenia dhe 3 shtetet baltike. Këto shtete nuk do të kenë mundësi ta bëjnë këtë pasi nuk mund t’i bashkohen traktatit derisa të gjithë nënshkruesit e saj ta kenë ratifikuar. Nga 30 vendet nënshkruese këtë traktat e ka ratifikuar deri tani Bjellorusia, Kazakistani, Rusia dhe Ukraina. Moldavia dhe Gjeorgjia kanë deklaruar se ato nuk do ta ratifikojnë atë përderisa Rusia të ketë tërhequr trupat e saj nga territori i tyre, veçanërisht trupat ruse të vendosura në republikat e ndara të Abkhazisë (Gjeorgji) dhe Transdnestrin (Moldavi). Kjo ka çuar që edhe vendet e NATO-s të heqin dorë nga ratifikimi. Për këtë Rusia pezulloi ratifikimin e saj më 14 korrik 2007, duke ftohur marrëdhëniet mes SHBA-së e Rosisë.

****ORGANIZATA E TRAKTATIT TË SIGURISË KOLEKTIVE/ Collective Security Treaty Organization (CSTO)**

Në kuadër të Komunitetit të Shteteve të Pavarura, ish-Republikat e BS (CIS- Commonwealth of Independent States) u nënshkrua më 15 maj 1992 në Tashkent të Uzbekistanit, *Traktati i Sigurisë Kolektive (Collective Security Treaty të CIS-it - CST)* nga vende të tilla si Armenia, Kazakistani, Kirgizistani Tazhikistani dhe Uzbekistani e Rusia. Ndërkohë Azerbajxhani e nënshkroi më 24 shtator 1993, Gjeorgjia më 9 dhjetor 1993 ndërsa Bjellorusia më 31 dhjetor 1993. Traktati hyri në fuqi më 20 prill 1994. Traktati riafirmoi dëshirën e të gjithë vendeve pjesëmarrëse për të hequr dorë nga përdorimi apo kërcënimi i forcës. Nënshkruesit nuk do t’i bashkoheshin ndonjë aleance tjetër ushtarake apo grupi tjetër shtetesh, ndërkohë që sulmi i armatosur ndaj një vendi anëtar do të konsiderohej si sulm ndaj të gjitha vendeve pjesëmarrëse CST u përcaktua të zgjaste për 5 vjet e më pas të zgjerohej. Më 2 prill 1999 presidentët e Rosisë, Bjellorusisë, Kazakistanit e Kirgizistanit dhe Tazhikistanit nënshkruan një protokoll duke rinovuar

traktatin për një periudhë tjetër 5-vjeçare. Por Azerbajxhani, Gjeorgjia dhe Uzbekistani refuzuan të nënshkruajnë atë dhe u tërhoqën nga ky traktat. Në vend të saj ata krijuan në 1997 *Organizatën për Demokraci dhe Zhvillim Ekonomik* (GUAM Organization for Democracy and Economic Development) ku u përfshinë edhe Moldavia e Ukraina. Në këtë mënyrë kjo organizatë u pa si kundërpeshë e Ruisë në rajon). Më 7 tetor 2002, 6 anëtarët e CSTO-së nënshkruan një Kartë në Kishinau të Moldavisë, duke e zgjeruar atë e duke e riemërtuar *Organizata e Traktatit të Sigurisë Kolektive (CSTO-Collective Security Treaty*. Vendet anëtare të kësaj organizate kanë kryer disa stërvitje ushtarake të përbashkëta dhe më 23 qershor 2006, kësaj organizate iu shtua edhe Uzbekistani pasi u tërhoq nga GUAM-i. Në qershor 2007, CSTO nënshkroi një marrëveshje me *Organizatën e Bashkëpunimit të Shangait (SCO-Shanghai Cooperation Organisation)* në kryeqytetin e Tashikistanit Dushanbe, e cila synonte zgjerimin e bashkëpunimit për çështjet e sigurisë, luftës kundër krimit e trafikut të drogës. Më 6 tetor 2007 anëtarët e CSTO ranë dakord për një shtrirje më të madhe të aktivitetit të organizatës që do të krijonte një forcë paqeruajtëse të CSTO-së, e cila mund të vendosej nën ose pa mandatin e OKB-së në shtetet anëtare. Ndërkohë edhe Irani ka shprehur dëshirën për t'iu bashkëngjitur kësaj organizate. CSTO është një organizatë me statusin e vëzhguesit pranë Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

Që nga 20 prill 1994 shtetet anëtare të kësaj organizate janë Armenia, Bjellorusia, Kazakistani, Kirgizistani, Tashikistani, Rusia, Uzbekistani (anëtarë në 1994, tërhequr në 1999, rianëtarësuar më 2006). Azerbajxhani dhe Gjeorgjia ishin anëtarë gjatë periudhës (1994-1999).

*** INTERMEDIATE RANGE NUCLEAR FORCES TREATY/
Traktati i Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme Veprimi-INF

Traktati i Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme Veprimi (INF-Intermediate Range Nuclear Forces Treaty) ishte një marrëveshje mes SHBA e BS. Ajo u nënshkrua në Uashington më 8 dhjetor 1987 nga Presidenti i SHBA-së Ronald Regan dhe lideri sovjetik Mikhail Gorbacov. Më pas u ratifikua nga Senati i SHBA më 27 maj 1987 dhe hyri në fuqi më 1 qershor 1988. Traktati formalisht u quajt *Traktati mes SHBA dhe Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike mbi Eliminimin e Raketave të Tyre me Rreze të Mesme të Shkurtër Veprimi/Treaty Between the United States of America and the Union of Soviet Socialist Republics on the Elimination of Their Intermediate-Range and Shorter-Range Missiles*. Traktati eliminonte raketat balistike bërthamore e konvencionale të lëshuara nga toka dhe raketat Kruiz me rreze të mesme veprimi, diçka ndërmjet 500-5500 km. Deri në 1 qershor 1991, u shkatërruan një total prej 2692 armësh, 846 nga SHBA dhe 1846 nga BS. Sipas traktatit, të dyja vendet lejoheshin të inspektonin instalimet ushtarake të njëri-tjetrit për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve të tij. Marrëveshja u nxit nga debatet që pasuan vendosjen e raketa SS-20 nga ana e BS në Europën Lindore në gjysmën e dytë të viteve '70 dhe kundërpërgjigjen e SHBA-së për të vendosura raketat Kruiz dhe

Pershing II në Europën Perëndimore. Bisedimet paraprake filluan në Gjenevë në 1980 ndërsa ato zyrtare në shtator 1981. Për shkak të mosmarrëveshjeve, bisedimet u ndërpre në nëntor 1993 nga delegacioni sovjetik dhe pavarësisht protestave publike në 1984, SHBA filluan vendosjen e Armëve Bërthamore me Rreze të Mesme Veprimi në Gjermaninë Perëndimore, Itali dhe Angli. Në mars 1985, negociatat ndërmjet BS dhe SHBA rifilluan, duke mbuluar jo vetëm çështjen e INF, por u bënë edhe diskutime të veçanta mbi armët strategjike (START 1) dhe çështjet hapësinore (NST). Në fund të vitit 1985 të dyja palët lëvizën drejt marrëveshjes për të reduktuar sistemet e Armëve Bërthamore me Rreze të Mesme Veprimi - INF në Europë dhe Azi. Më 15 janar 1986, Gorbaçovi shpalli një propozim të palës sovjetike për të ndaluar të gjithë armët bërthamore deri në vitin 2000, ku mes tyre të përfshiheshin edhe raketat bërthamore me rreze të mesme veprimi në Europë. Ndërkohë arsenalit bërthamor i Francës dhe Britanisë nuk përfshihej në këtë marrëveshje. Një seri takimesh në gusht dhe shtator 1986 mes dy liderëve rusë e amerikanë kulmuan me Samitin e Rekjavikut mes Gorbaçovit e Reganit në 11 tetor 1986. Të dyja palët ranë dakord në parim për të hequr sistemet e forcave bërthamore me rreze të mesme veprimi nga Europa dhe për një kufizim në nivel global deri në 100 kapsulave të raketave bërthamore me rreze të mesme veprimi. Negociata u shtrinë edhe përgjatë vitit 1987, të ndihmuara edhe nga vendimi i kancelarit gjerman Helmut Kohl në gusht 1987 për të hequr sistemet e përbashkëta të raketave Pershing IA mes SHBA-RFGJ. Teksti përfundimtar i traktatit u arrit në shtator 1987 dhe u nënshkrua në Shtëpinë e Bardhë në Uashington më 8 dhjetor 1987. Programet e shkatërrimit të raketave bërthamore me rreze të mesme veprimin përfshin për SHBA: a) Pershing IB dhe Pershing II b) BGM-109 Tomahawk (vetëm varianti me bazë lëshimi nga toka). Ndërsa për BS përmbanin a) SS-4 "Sandal" b) SS-5-"Skean" c) SS-12 "Scaleboard" d) SS-23"Spider e) SS-20 "Saber. Ndërkohë veprimet e SHBA për sa i përket vendosjes së sistemit të mbrojtjes raketore në Poloni e Çeki (*Ground-Based Midcourse Missile*), kanë nxitur reagimin e Ruisë, e më 10 shkurt 2007, presidenti rus Vladimir Putin deklaroi se Traktati i INF nuk i shërbente më interesave të Ruisë. Më 14 shkurt 2007, agjencitë e lajmeve ITAR-Tass dhe Interfax citonin gjeneralin Yuri Baluyevsky, shef i shtabit të përgjithshëm të Ruisë që deklaroi se Rusia mund të tërhiqet nga INF dhe se vendimi do të varet nga qëndrimi amerikan për çështjen e sistemit të mbrojtjes anti-raketë në Europë.

**** TRAKTATI MBI FORCAT E ARMATOSURA KONVENCIONALE NË EUROPË CFE TREATY/Conventional Armed Force in Europe Treaty)

Traktati i CFE-së u nënshkrua më 19 nëntor 1990 në Paris. Ai u negociua dhe u arrit të nënshkruhej gjatë viteve të fundit të Luftës së Ftohtë, duke bërë të mundur vendosjen e kufizimeve të qenësishme mbi kategoritë bazë të pajisjeve ushtarake konvencionale në Europë (nga Atlantiku në

Urale) si dhe mandatoi shkatërrimin e armëve të tepërta. Traktati propozoi kufizime të barabarta për të dy palët në këtë marrëveshje, që ishin dy blloqet ushtarake të asaj periudhe si NATO-n dhe Traktati i Varshavës. Bisedimet rreth këtij traktati filluan që në 1972, kur presidenti i SHBA, Richard Nikson dhe lideri sovjetik Leonid Brezhnjev arritën një marrëveshje, kompromisi për të zhvilluar negociatat të ndara politike e ushtarake në lidhje me këtë Traktat. Konferenca mbi Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (KSBE) do të merrej me *çështjet politike* dhe Reduktimi i Dyanshëm i Balancuar i Forcave (MBFR-Mutual Balanced Force Reductions) do të merrej me *çështjet ushtarake*. KSBE arriti në 1975 në nënshkrimin nga 35 vende të Aktit Final të Helsinkit. Ndërkohë negociatat për MBFR u bllokuan nga BS për shkak të vendimit të NATO-s, për të vendosur armët e reja bërthamore me rreze të mesme veprimi në Europë (IRNW - New Intermediate - Range Nuclear Weapons). Ndërkohë siç ishte rënë dakord në Konferencën e KSBE në Madrid, u hap në Stokholm më 17 janar 1984 Konferenca mbi Masat e Ndërtimit të Mirëbesimit e Sigurisë dhe Çarmatimit në Europë (CSMB-Confidence and Security Building Measures and Disarmament). Negociatat e ndërlikuara zgjatën për të paktën 3 vjet, deri më 19 shtator 1986. Dokumenti final i konferencës vërente se *“qëllimi kishte qenë që të ndërmerreshin, në faza të ndryshme kohore, veprime të reja efektive e konkrete, të cilat kishin për qëllim të arrinin progres në forcimin e mirëbesimit dhe sigurisë e arritjen e çarmatimit”*. Në kontekstin e negociatave të MBFR, në vitin 1986, Gorbaçovi propozoi që të reduktoheshin forcat ajrore e tokësore e në të, të përfshiheshin armët konvencionale e bërthamore nga Atlantiku në Urale. Ky propozim më vonë u formalizua gjatë Takimit të Traktatit të Varshavës. Këshilli Atlantik i Veriut në NATO-s përmes ministrave të punëve të jashtme lëshoi Deklaratën e Brukselit mbi Kontrollin e Armëve Konvencionale/Brussels Declaration on Conventional Arms Control, e cila bënte thirrje për dy nivele të ndara negociatash: njëra që do të ndërtohej mbi rezultatet e CSBM-së në Konferencën e Stokholmit dhe tjetra për të *krijuar stabilitetin konvencional në Europë përmes negociatave mbi kontrollin e armëve konvencionale nga Atlantiku në Urale (ATTU)*. Në 1987, Dokumenti i Stokholmit hyri në fuqi dhe ofroi për herë të parë një të drejtë të negociuar, e cila bënte të mundur realizimin e inspektimeve të forcave ushtarake në terren. Më 17 shkurt 1987 filluan në Vjenë bisedimet informale mes 16 vendeve të NATO-s dhe 7 vendeve të Traktatit të Varshavës, mbi një mandat për negociatat konvencionale në Europë, të cilët do të përcaktonin udhëzimet negociuese të traktatit. Më 27 qershor 1987, NATO paraqiti një draft-mandat gjatë konferencës së 23 vendeve në Vjenë. Mandati bënte thirrje për eliminimin e forcave të shpërndara, aftësinë për sulme të befasishme, veprimet sulmuese në shkallë të gjerë dhe krijimin e një sistemi efektiv verifikimi. Ndërkohë në 8 dhjetor 1987 u nënshkrua në Uashington Traktati mes SHBA-BS për Armët Bërthamore me Rreze të Mesme Veprimi, (INF-Inter-Range Nuclear Force Treaty) duke lejuar inspektime të dyanshme. Gjatë Samitit të Moskës në maj-qershor 1998, Presidentët Regan e Gorbaçov theksuan rëndësinë e stabilitetit dhe sigurisë

në Europë, veçanërisht duke bërë thirrje për shkëmbim të dhënash, verifikim të këtyre të dhënave dhe më pas reduktime të armëve. Në dhjetor 1988, Gorbaçovi, deklaroi në OKB një tërheqje të njëanshme të 500 000 trupave nga Europa Lindore dhe çmobilizimin e 500 000 trupave sovjetike. Në janar 1989, NATO dhe Traktati i Varshavës hartuan Mandatin për Negocim mbi Forcat e Armatosura Konvencionale në Europë. Mandati përcaktonte objektivat për Traktatin e CFE-së dhe hartonte parimet negociuese. Në këtë mënyrë negociata zyrtare filluan më 9 mars 1989 në Vjenë. Kur Presidenti Bush dhe ai francez Miteran u takuan në maj 1989, Bush shpalli pranimin e reduktimit të helikopterëve dhe avionëve luftarakë. Ai propozoi një tavan prej 275 000 personel ushtarak të vendosur në Europë nga SHBA dhe BS. Propozimi i Bushit u miratua më 1989 gjatë Samitit të NATO-s në Bruksel dhe u paraqit në Vjenë. Me rënien e Murit të Berlinit në nëntor 1989 dhe përmbyshjen e regjimeve komuniste në Europën Lindore, Bushi dhe Gorbaçovi ranë dakord që të shpejtojnë kontrollin e armëve dhe negociatat ekonomike. Bush propozoi kufizime edhe më të mëdha të armëve konvencionale, ndërsa dhe BS negocioi dhe përmbylli marrëveshjen e tërheqjes së trupave të saj me shtetet e Traktatit të Varshavës. Në këtë mënyrë në 19 nëntor 1990 u nënshkrua në Paris Traktati i CEF-së nga 22 shtete të ndara në dy grupe mes të cilëve 16 vendet anëtare të NATO-s (Belgjika, Danimarka, Kanadaja, Franca, Gjermania, Greqia, Islanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Spanja, Turqia, UK dhe SHBA) dhe 6 vendet e Traktatit të Varshavës (Bullgari, Çeki, Hungari, Poloni, Rumani dhe BS). Traktati hyri në fuqi më 17 korrik 1992. Më 14 korrik 2007, Rusia njoftoi nënshkruesit e tij për qëllimin e saj të pezullimit të CFE.

***** ORGANIZATA E BASHKËPUNIMIT TË SHANGHAIT/
Shanghai Cooperation Organization - SCO

SCO është një organizatë ndërqeveritare e sigurisë së dyanshme, e cila u krijua më 15 qershor 2001 nga liderët e Kinës, Rusisë, Kazakistanit, Kirgizistanit, Tazhistanit dhe Uzbekistanit. Përveç Uzbekistanit, të gjithë vendet e tjera kanë qenë anëtarë të iniciativës Shanghai Pesë e themeluar më 26 prill 1996; pas përfshirjes së Uzbekistanit në 2001, anëtarët e riemërtuan organizatën. Grupimi Shanghai Pesë u krijua më 26 prill 1996 me nënshkrimin e *Traktatit për Thëllimin e Besimit Ushtarak në Rajonet Kufitare* në Shangai nga kryetarët e shteteve të Kinës Rusisë, Kazakistanit, Kirgizistanit, Tazhistanit. Më 24 prill 1997 të njëjtat vende nënshkruan *Traktatin mbi Reduktimin e Forcave Ushtarake në Rajonet Kufitare* gjatë një takimi që u zhvillua në Moskë. Një sërë samitesh vjetore të grupit Shanghai Pesë u zhvilluan në Alamata (Kazakistan) në 1998, në Bishek (Kirgizistan) në 1999 dhe në Dushanbe (Tazhikistan) në 2000. Në 15 qershor 2001, Samiti Vjetor u zhvillua në Shanghai në Kinë. Të 5 shtetet anëtare së pari pranuan Uzbekistanin në mekanizmin Shanghai Pesë (duke e shndërruar në Shanghai Gjashtë). Të gjithë kryetarët e shteteve të 6 vendeve nënshkruan më 15 qershor 2001 Deklaratën e Organizatës së Bashkëpunimit të Shanghait,

duke vlerësuar rolin që kishte luajtur deri në atë kohë mekanizmi Shanghai Pesë dhe me synimin për ta shndërruar atë në një nivel më të lartë bashkëpunimi. Në korrik 2001 Rusia dhe Kina, dy vendet drejtuese të organizatës nënshkruan Traktatin e Fqinjësisë së Mirë dhe Bashkëpunimit Miqësor (Treaty of Good-Neighborliness and Friendly Cooperation). Në qershor 2002, krerët e shteteve të SCO u takuan në Shën Petërburg të Rusisë. Ata nënshkruan Kartën e SCO-së, e cila zgjeronte qëllimet, parimet, e organizatës si dhe strukturën e formën e veprimit, duke e themeluar atë zyrtarisht edhe nga pikëpamja e së drejtës e ligjit ndërkombëtar. Vendet anëtare të kësaj organizate janë të përfshira në një sërë aktivitetesh me karakter ekonomik, ushtarak e kulturor. SCO është e përqendruar kryesisht rreth çështjeve të sigurisë së anëtarëve të saj në Azinë Qendrore, e përshkruar shpesh si kërcimi kryesor që ajo përball me terrorizmin, separatizmin dhe ekstremizmin. Në Samitin e SCO më 16-17 korrik 2004 që u mbajt në Tashkent të Uzbekistanit, u krijua *Struktura Rajonale Anti-Terrorizëm/Regional Antiterrorism Structure (RATS)*. Ndërkohë më 21 prill 2006, SCO ka deklaruar planet për të luftuar krimet ndërkufitare të drogës, që lidhen me kuadrin e anti-terrorizmit. Për të nxitur bashkëpunim ushtarak janë zhvilluar një sërë stërvitjesh të përbashkëta mes anëtarëve të kësaj organizate. E para është organizuar në 2003 me dy faza ku njëra është zhvilluar në Kazakistan dhe e dyta në Kinë. Në një shkallë më të gjerë, por jashtë kuadrit të SCO-së, stërvitja e përbashkët ushtarake ndërmjet Rusisë e Kinës u quajt Misioni Paqësor (Peace Mission) u zhvillua më 19 gusht 2005. Duke ndjekur realizimin e saj të suksesshëm, zyrtarët rusë kanë filluar të flasin për një stërvitje të tillë të përbashkët me Indinë dhe SCO po merr kështu një rol ushtarak. Stërvitja e përbashkët ushtarake në 2007 do të zhvillohet në Chelyabinsk të Rusisë, afër Maleve Urale, pranë Azisë Qendrore, për të cilën ishte rënë dakord në Takimin e Ministrave të Mbrojtjes së SCO-së në prill 2006. Në të marrin pjesë më shumë se 4000 ushtarë nga Kina. Për sa i përket fushës së sigurisë në tetor 2007, SCO nënshkroi një marrëveshje me CSTO në kryeqytetin e Taxhikistanit, Dushanbe, në mënyrë që të zgjeronin bashkëpunimin për çështje të tilla sigurie, krimi dhe trafiku i drogës.

Edhe fusha e bashkëpunimit ekonomik është me mjaft interes për këto vende. Më 23 shtator 2003, vendet anëtare të SCO-së nënshkruan një Marrëveshje Kuadër (Framework Agreements) për të nxitur bashkëpunimin ekonomik mes tyre duke synuar krijimin e Zonës së Tregtisë së Lirë. Më 23 shtator 2004 u nënshkrua një Plan Veprimi që parashikonte 100 masa të veçanta që duheshin ndërmarrë për të arritur këtë objektiv. Në 26 tetor 2005, në Samitin e Moskës së SCO-së, Sekretari i Përgjithshëm i kësaj organizate Nikolay Bourzholay deklaroi se SCO do të kishte si prioritet projektet e përbashkëta të energjisë: ato do të përfshinin sektorin e naftës e të gazit, shfrytëzimin e burimeve të reja të rezervave të hidrokarbureve dhe përdorimin e përbashkët të rezervave ujore. Më 21-22 shkurt 2006 u mbajt në Pekin takimi i parë SCO Interbank Association. Më 30 nëntor 2006 në Konferencën Ndërkombëtare që u mbajt në Almata të

Kazakistanit me titull: *SCO: Rezultate dhe Perspektiva*, përfaqësuesi rus i Ministrisë së Punëve të Jashtme deklaroi se Rusia po zhvillon planet për një “Klub Energjie” të SCO-së.

Për sa i përket anëtarësimit të shteteve të tjera në këtë organizatë, Mongolia ishte shteti i parë që mori statusin e vëzhguesit në Samitin e SCO-së, që u zhvillua në Tashkent të Uzbekistanit në 16-17 korrik 2004. Ndërkohë Pakistani, India dhe Irani e morën këtë status në Samitin e SCO që u zhvillua në Astana të Kazakistanit në 2005. Mongolia, Pakistani dhe Irani kanë aplikuar për anëtarësi të plotë në këtë organizatë, ndërsa India nuk e ka bërë ende këtë kërkesë.

Ndërkohë me gjithë deklaratimet se SCO nuk është një aleancë e drejtuar kundër shteteve apo rajoneve të tjera, shumë vëzhgues besojnë se një nga qëllimet e saj bazë është të shërbejë si kundërpeshë ndaj NATO-s e SHBA e në veçanti të shmangë konfliktet që do të lejonin SHBA-në të ndërhynte në zonat afër Ruisë e Kinës. Disa vëzhgues besojnë se organizata u formua si përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj kërcënimit të sistemeve të mbrojtjes raketore nga SHBA, pasi SHBA ndryshuan kursin e politikës së tyre bërthamore e filluan të nxisin *Mbrojtjen Kombëtare Raketore* (National Missile Defence). SHBA megjithëse kanë aplikuar për statusin e vëzhguesit në këtë organizatë ajo u është refuzuar në 2005. Luftërat në Irak e Afganistan kanë shtuar praninë pa kufizim të forcave amerikane në Kazakistan e Uzbekistan e në Samitin e SCO në Astana të Kazakistanit më 5 korrik 2005, SCO i kërkoi SHBA të përcaktonte një afat kohor që të tërhiqte trupat nga shtetet anëtare të SCO-së. Menjëherë pas kësaj Uzbekistani i kërkoi SHBA të largonte bazën ajrore K-2.

GARY D. ROBBINS *

NJË NATO GLOBALE DREJT
SAMITIT TË BUKURESHTIT
(*Mbajtur më 5 tetor 2007,*
në Forumin Atlantik të Palermos, Itali).

Fokusi ynë sot: “perspektiva të reja të sigurisë dhe bashkëpunimit në Mesdhe, Lindjen e Mesme dhe Azi” është i kohës e me vend dhe është diçka e gjetur, që ky diskutim zhvillohet në këtë qytet të bukur të Italisë së Jugut. Italia në përgjithësi dhe ishulli i Sicilisë në mënyrë të veçantë, kanë një histori të gjatë të angazhimit me të gjitha palët e Mesdheut, e deri te Lindja e Mesme.

Sot, ngjarjet kanë filluar të ndryshojnë fokusin nga konfliktet e Lindje-Perëndimit të periudhës së Luftës së Ftohtë në sfidat dhe mundësitë e reja të shekullit të 21-të, sfida dhe mundësi që janë në një masë të konsiderueshme, të lidhura me Mesdheun dhe më gjerë se Lindja e Mesme. Disa nga këto sfida përfshijnë ekstremizmin e dhunshëm, terrorizmin, përhapjen e armëve bërthamore dhe raketave, shtete të dështuar, sulmet kibernetike dhe mungesë sigurie për burimet e energjisë. Por edhe mundësitë nga ana tjetër janë të shumta: mundësitë e partneriteteve, e formave të tjera të angazhimit, mundësitë e punës me njerëzit në këto rajone për t’i ndihmuar në përpjekjet e tyre në kërkim të të mirave të njëjta nga një fshat gjithmonë e më global: stabilitet, vetëvendosje, shtet ligjor dhe prosperitet.

* Drejtor për Sigurinë Europiane dhe Çështjet Politike
Zyra për Çështjet Europiane dhe Euro-Aziate
Departamenti i Shtetit të SHBA-së

NATO është unike sepse ka nga një këmbë në të dy botët. Nga njëra anë, ka një punë të pambaruar së të kaluarës. Europa është tani përgjithësisht e unifikuar dhe e lirë në një masë të konsiderueshme falë edhe NATO-s. Por ende ka punë të prapambetura nga periudha e Luftës së Ftohtë, punë për të cilën NATO ka një përgjegjësi, por që ka edhe një histori. Le të përmend disa shembuj:

- Marrëdhëniet e NATO-s me Rusinë përmes Këshillit NATO-Rusi nuk ka përmbushur premtimet e saj. Në të njëjtën kohë, Rusia është duke kërcënuar të suspendojë pjesëmarrjen e saj në CFE, traktatin e kontrollit të armëve që është thembra e sigurisë së Europës.
- Mentaliteti i vjetër rus për sa i përket ish-aleatëve të Traktatit të Varshavës ende mbetet një nga pengesat kryesore për përparimin e mbrojtjes me raketa.
- Në një përpjekje për të sjellë stabilitet në Ballkan, ne duhet në javët e ardhshme të zgjidhim çështjen e statusit final të Kosovës.
- Është ende pa zgjidhur çështja se si duhet të veprojmë me ish-vendet e Bashkimit Sovjetik, si për shembull Gjeorgjinë, e cila përpiqet të integrohet në sigurinë perëndimore dhe në struktura të tjera.

Nga ana tjetër, NATO është aktive në vendosjen e marrëdhënieve në Mesdhe, Lindjen e Mesme dhe më tej. Me fjalë të tjera, NATO vazhdon të shohë drejt së ardhmes, si për shembull:

- Qysh prej 1994 është vendosur zhvillimi i dialogut të NATO-s me Mesdheun (Med-D) e konkretisht me Algjerinë, Egjiptin, Izraelin, Jordanin, Marokun, Mauritaninë.
- Në 2004, Iniciativa e Bashkëpunimit të Stambollit (ICI) shtoi marrëdhëniet me Kuvajtin, Bahrain, Emiratet e Bashkuara Arabe, dhe Katarin.
- Në 2006 Iniciativa për Bashkëpunim e Trajnim të NATO-s (NTCI) zgjeron partneritetin dhe mundësitë për arsimimin njëkohësisht me vendet e Med-D dhe të ICI.
- Në një plan më të përgjithshëm, NATO i ka zgjeruar marrëdhëniet dhe bashkëveprimin me vendet e

demokratike jashtë Europës si Australi, Japoni, Koreja e Jugut, vende të cilat kane kontribuar në një mënyrë apo një tjetër në misionin ISAF në Afganistan.

NATO ka pasur sukses në këto përpjekje para së gjithash për arsye se ka qenë e aftë për t'u adaptuar në një mjedis të ri të ndryshueshëm të sigurisë, pikësëpari në Europë, por gjithmonë e më shumë edhe jashtë saj. Në aspektin ushtarak kjo ka nënkuptuar shndërrimin e Nato-s nga një forcë mbrojtëse tradicionale, që kishte si qëllim ndalimin e sulmeve masive nga Lindja, në një forcë më fleksibël, e destinuar që t'i bëjë ballë kërcënimeve asimetrike me emergjencë të tilla si mospërhapja e armëve dhe terrorizmi. Gjatë gjithë këtij ndryshimi, një gjë nuk ka ndryshuar: gatishmëria e NATO-s për të mbajtur lidhje me miqtë dhe ish-armiqtë, me partnerë të mundshëm dhe aleatë të mundshëm:

- Partneriteti për Paqe ishte një mekanizëm i rëndësishëm për përgatitjen e ish-vendeve të Traktatit të Varshavës për anëtarësimin përfundimtar në NATO, dhe ia vlen të përmendet që, historikisht, zgjerimi i NATO-s përgjithësisht ka paraprirë dhe atë të BE-së.
- NATO krijoi Këshillin Nato-Rusi (NRC) në mënyrë që të angazhonte më mirë Rusinë në çështje të një shqetësimi të përbashkët dhe të krijonte një marrëdhënie të suksesshme NATO-Rusi në përbashkëtimin e çështjeve të sigurisë europiane.
- Krijimi i mekanizmave të tillë si: Med-D, ICI, dhe NTCI përmbledhen në të njëjtën skemë të plotë: forcimin e bashkëpunimit me partnerë afër Europës me qëllim që ata të përfitojnë nga shkëmbimi, edukimi, trajnimi dhe nga shpirti i bashkëpunimit. Me një fjalë, krijimi i aksesit për të përdorur mekanizmat që kanë rezultuar shumë të rëndësishëm në avancimin e sigurisë sonë të përbashkët.
- Gjithashtu të mos harrojmë që marrëdhëniet e NATO-s me BE-në (pavarësisht episodeve të fërkimeve në lidhje me rolin përkatës të secilit institucion) kanë provuar të jenë jashtëzakonisht të lidhura në avancimin e sigurisë europiane.

Natyrisht, ajo që i ka dhënë një rëndësi të veçantë, por edhe emergjente të partneriteteve me vende në Lindjen e Mesme dhe më tej, është ndryshimi i mjedisit të sigurisë, demonstruar për amerikanet me sulmet e 11 shtatorit, apo lufta në Afganistan dhe Irak, dhe shtimi i influencës së Iranit, duke përfshirë mundësinë që ai mund të përparojë në përpjekjet e tij për të siguruar armë nukleare.

Të marra së bashku, këto zhvillime i bënë të qartë vendimmarrësve të Aleancës, që NATO duhet të shkojë më tej se një evolucion normal dhe duhej të ndërmernte transformime të thella për sa i përket pozicionit të saj dhe të kapaciteteve të nevojshme, që të përballojë këto sfida të reja të sigurisë.

Kjo nuk do të thotë se nuk do të vazhdojë funksionimi i saj thelbësor në Europë, së cilës iu referuam më parë. NATO duhet dhe do të vazhdojë të kryejë detyrat e saj në Europë. Por, kjo me të vërtetë që nënkupton që NATO duhet gjithnjë e më shumë të fokusohet në kërcënimet që e kanë prejardhjen nga jashtë Europës, sesa në ato nga brenda saj. Në një kohë që ne duhet ta mbarojmë punën tonë në Kosovë dhe tjetërkund, Afganistani paraqet sfidën e ardhshme. Është më se e logjikshme që ne kërkojmë partnerë të të njëjtave vlera për të përballuar sfidat që rrjedhin nga jashtë Europës dhe të cilat sjellin pasoja të sigurisë edhe për të tjerët, përveç hapësirës së Europës dhe Amerikës së Veriut. Meqë problematikat e sotshme janë gjithmonë e me globale, NATO mund dhe duhet të përfitojë nga partnerët globalë.

Më poshtë janë arsyet pse ne duhet të kemi sukses në Afganistan, dhe se sukcesi në mbështetje të popullit afgan është gjithashtu i rëndësishëm jo vetëm për NATO-n, por për secilin vend anëtar veçmasi, të cilët së bashku formojnë Aleancën Veri-Atlantike.

- Siguria dhe mirëqenia e shoqërive tona, e të gjithëve ne në komunitetin transatlantik, është e varur nga ky sukses në Afganistan. Ne nuk mund të lejojmë talebanët dhe Al Kaeden të rivendosë regjimin e tyre brutal në Afganistan, dhe nëpërmjet këtij regjimi të vazhdojë të ofrojë një kërcënim për njerëzit atje, në rajonin përreth, më gjerë në

Lindjen e Mesme, dhe le të jemi të sinqertë, edhe për shoqëritë tona.

- Se dyti, duhet të pranojmë se shpresat e popullit afgan për një të ardhme më të begatë, të qëndrueshme, të sigurt, varet pikërisht nga ndihma që ne i japim atyre. Ne jemi duke bërë gjënë e duhur dhe të drejtë atje, duke vepruar në interes të popullit afgan, por edhe në interesat tona, dhe nuk mund t'i kthejmë shpinën ngjarjeve aty.
- Nëse ne do ta lemë Afganistanin përsëri të mbetet një vend i dështuar, dhe një strehë për terroristët, kjo do të çojë përsëri në eksportimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe të rrisë vuajtjet dhe pasiguritë në të gjithë rajonin.
- Se fundmi, dëshiroj të theksoj se SHBA mendojnë se jemi duke arritur rezultate të konsiderueshme në Afganistan, dhe në fund do të arrijmë sukses të plotë aty. Kjo mund të kërkojë durim, këmbëngulje dhe angazhim, por jo më shumë se na është dashur të hedhim tej kërcënimin sovjetik.
- Reflektoni për një moment për natyrën e angazhimit tonë në Afganistan. ISAF, i drejtuar nga NATO dhe i autorizuar nga OKB-ja, përbëhet prej 26 shteteve anëtare të Aleancës dhe 11 vendeve partnere, që përshijnë 40,000 trupa.
- Veçmas vepron Operacioni i Lirisë së Qëndrueshme (OEF), një trup operacional vetëmbrojtës i udhëhequr nga SHBA dhe i njohur nga Rezoluta e KS të OKB-së 1368, e cila përfshin 12,000 trupa nga të cilët 1000 jo të SHBA-ve.
- Dhe të gjitha këto veprojnë në mbështetje të një qeverie të zgjedhur nga populli, të udhëhequr nga Presidenti Khrazai.

NATO jo vetëm që është e interesuar të punojë me shtete të tjera, por ajo është e interesuar për të punuar edhe me organizata të tjera. Eksperienca e Afganistanit e bën të qartë se rindërtimi dhe stabilizimi nuk mund të arrihet vetëm me mjete ushtarake. Ka nevojë për një qasje edhe më të plotë për të afruar së bashku përpyekjet e shumë aktorëve. Për ta thënë më thjesht, me qëllim që të ndihmojmë për të ofruar siguri për afganët, ne duhet të ndihmojmë për fuqizimin e ekonomisë, shoqërisë civile, shtetit ligjor dhe mbi të gjitha për të aftësuar afganët për t'i marrë vetë këto përgjegjësi. Në këtë kuadër

NATO (dhe OEF), janë tërësisht të angazhuar në trajnimin e Ushtrisë Kombëtare afgane për të marrë përgjegjësi për sigurinë kombëtare. Por ka ende shumë nevojë për të trajnuar policinë dhe NATO mirëpret misionin e planifikuar të Bashkimit Europian drejt këtij qëllimi.

Terroristët talebane vazhdojnë të financojnë aktivitetet e tyre përmes prodhimit të drogës, kështu që ne duhet të shohim për mënyrën për të ndaluar trafikun ilegal, të eliminojmë mbjelljen dhe të drejtojmë fermerët afganë drejt prodhimeve alternative të drithërave. Por, kompleksiteti i sfidave të sigurisë atje, që vetë këto organizata të zgjerojnë qasjet e tyre ndaj problemeve, duke gjetur mënyrë për të punuar me organizata të tjera, përfshirë ato joqeveritare kur është e nevojshme.

Duke folur për bashkëpunim dhe partneritetet globale, Aleanca jonë vlerëson se nuk është e vetme në përballimin e sfidave të shekullit të 21-të, dhe as nuk do të jetë faktori dominues në të gjitha këto sfida dhe probleme. Siç thashë edhe më lart, Europa po bëhet gjithmonë më e plotë e lirë, e qëndrueshme dhe e begatë edhe për shkak të përpjekjeve të përbashkëta të NATO-s dhe të BE-së. NATO dhe Shtetet e Bashkuara mbështesin një Bashkim Europian të fortë, por ne e kuptojmë që në disa çështje Bashkimi Europian do të ndjekë misionin e tij, ndonjëherë me mbështetjen e NATO-s, ndonjëherë vetëm. Shtetet e Bashkuara e mirëpresin bashkëpunimin midis NATO-s dhe BE-së. Ne mendojmë se angazhimi i përbashkët nuk është pa rezultate dhe shpresojmë që kjo të inkurajojë të tjerët të ndajnë të njëjtin opinion. Shtetet e Bashkuara mirëpresin interesin e Presidentit francez Sarkozy për marrëdhënie më të ngushta me NATO-n dhe në mënyrë të veçantë vlerësimin e tij se NATO dhe EU duhet të jenë organizata komplemetare. Kjo është e vërtetë për angazhimin në Afganistan, ku NATO ka drejtimin nëpërmjet ISAF-it, ndërkohë që BE propozon një rol mbështetës. Kjo është po kaq e vërtetë për Kosovën, ku BE është duke u përgatitur të marrë drejtimin menjëherë sa çështjet e statusit final të marrin rrugën e zgjidhjes. Kjo është po ashtu e vërtetë për vendet partnere të Mesdheut, ku të dyja organizatat kanë një rol për të luajtur në promovimin e besimit dhe të stabilitetit. Me të

vërtetë dhe qartazi ka shumë punë për të bërë nga të dyja organizatat. E gjithë kjo punë dhe sfidat imperative që na preson, dëshmojnë se nuk ka kohë për të humbur. Vendosmëria e administratës aktuale të SHBA-së për të bërë të sigurt se NATO do të jetë në gjendje për të përballuar sfidat e sotme dhe të nesërme është po aq sa ka qenë dy-katër apo gjashtë vjet më parë. Ne presim që Samiti i Bukureshtit të na çojë përpara në shumë fronte:

- Të fuqizojë efektivitetin operacional të NATO-s në Afganistan dhe në misione të tjera për të adresuar sfidat aktuale të sigurisë.
- Të rrisë aftësitë e NATO-s, të mbrojtë të gjitha Aleatët nga sfidat e sigurisë, të tilla si përhapja e armëve nukleare dhe raketave.
- Të ngrejë kapacitete të reja të NATO-s ku Aleanca të shtojë vlerat e përbashkëta për kërcënimet e reja si terrorizmi kibernetik, dhe pasigurisë energjetike.
- Të forcojë konsolidimin e demokracisë në Ballkan dhe Kaukaz.
- Dhe të rrisë angazhimet e NATO-s me një rrjet partneresh të së njëjtës bindje kudo në botë.

Kjo është një axhendë ambicioze, por që ia vlen të ndërmerret. Dhe Aleanca, partnerët dhe gjithë bota do të fitojnë nga suksesi jonë.

Kol. EDISON ZARKA

PËRSHTATJA NDAJ SFIDAVE DHE KËRCËNIMEVE TË SIGURISË KOMBËTARE DHE HAPAT E INTEGRIMIT TË VENDIT DREJT STRUKTURAVE EURO-ATLANTIKE.

Shqipëria iu përshtat sfidave të reja të sigurisë që rrodhën pas përfundimit të Luftës së Ftohtë në Evropë. Ajo u bë një nga promotorët kryesorë në rajon për stabilitetin e rajonit, duke forcuar bashkëpunimin bilateral e rajonal, duke pasur gjithmonë parasysh objektivin kryesor, integrimin në strukturat Euro-Atlantike.

Është pa dyshim shumë i rëndësishëm fakti, mënyra se si një vend i trajton kërcënimet dhe rreziqet, si i ndërton strukturat e saj për t'i minimizuar efektet e pashmangshme të këtyre kërcënimeve të sigurisë që shfaqen në forma të brendshme dhe në forma të jashtme. Shqipëria i është përshtatur sfidave dhe kërcënimeve të reja të pas Luftës së Ftohtë, duke i shprehur qartë në konceptet e sigurisë kombëtare. Këto koncepte kanë evoluar dhe janë përshtatur në përputhje me zhvillimet e brendshme dhe të jashtme. Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, koncepti mbi sigurinë RSH ka evoluar tri here deri tani dhe si rrjedhim janë prodhuar tri dokumente kryesore. Dokumenti i parë është ai i vitit 1995 me titull *“Politika e Sigurimit dhe Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë”*, i dyti është ai i vitit 2000 *“Strategjia e Sigurimit të Republikës së Shqipërisë”*, ndërsa i treti është ai i vitit 2004, i cili është ende në fuqi dhe që njihet me emrin *“Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë”*. Në këto dokumente janë trajtuar gjerësisht dhe në mënyrë profesionale interesat vitale, jetësore të Shqipërisë, për të cilat punojnë të gjitha strukturat e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit. Këto interesa paraqiten si më poshtë:

- Sovraniteti i RSH-së
- Mbrojtja e Pavarësisë dhe integritetit territorial të shtetit shqiptar
- Mbrojtja e jetës dhe pasurisë
- Zhvillimi demokratik dhe prosperiteti ekonomik i vendit
- Mbrojtja e vlerave dhe dinjitetit kombëtar
- Anëtarësimi në strukturat ndërkombëtare të sigurisë etj.

Edhe pse Shqipëria nuk është ende anëtare e NATO-s apo BE, gjatë përpilimit të këtyre dokumenteve ajo ka mbajtur parasysh konceptet e sigurisë, të përgatitura nga këto dy organizata të fuqishme në arenën ndërkombëtare. Konkretisht, NATO sot vepron sipas Konceptit Strategjik të vitit 1999, ndërsa BE sipas Politikës së Sigurisë Europiane të vitit 2003, e cila konsiderohet ende në fazat e para të implementimit. Natyrisht, duke bërë hapa të mëtejshme drejt integritimit në këto struktura, gjithnjë e më shumë merren parasysh edhe kërkesat e këtyre dokumenteve për t'u përfshirë në dokumentin kryesor të sigurisë së vendit. Në procesin e rishikimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, i cili do të jetë pa dyshim më i plotë dhe më gjithëpërfshirës sesa botimet e para, duhet të merren në konsideratë më tepër edhe dy konceptet e përshkruara me sipër.

Për të kuptuar të tashmen shpeshherë njerëzit i referohen të shkuarës, nga kemi ardhur. Mjedisi i sigurisë në Evropë ndryshoi thellësisht sidomos pas viteve '90, por për të kuptuar zhvillimet në Ballkanin Perëndimor ne duhet të shkojmë më larg, të paktën në periudhën e Luftës së Ftohtë. Si ishte kompozimi dhe lëvizjet më kryesore në lidhje me sigurinë në rajon, apo si ishin lidhjet e vendeve të rajonit me dy blloqet e mëdha NATO-n dhe Traktatin e Varshavës. Këto konsiderohen si elemente të domosdoshme për të bërë një analizë më gjithëpërfshirëse. Një nga momentet kryesore të kësaj analize janë pa dyshim marrëdhëniet e veçanta të këtyre vendeve, shkëputjet dhe lidhjet e tyre, me dy blloqet e mëdha ushtarake. Nuk mund të kalohet pa u përmendur shkëputja e ish-Republikës Federale të Jugosllavisë nga influenca ruse në vitin 1948, retorikisht një vit para se të formohej Aleanca e Traktatit

të Atlantikut të Veriut. Ndërsa Shqipëria pati një tërheqje të mëvonshme, konkretisht në vitin 1961 kur ajo doli de-fakto nga Traktati i Varshavës. Nga ana tjetër lëvizje shumë të çuditshme ndodhën në rajon, sidomos me futjen njëkohësisht të Greqisë dhe Turqisë në NATO në vitin 1951, duke e bërë më interesant kompozimin e shteteve në rajonin tonë. Pjesa tjetër e vendeve të Ballkanit mbeti nën tutelën e Bashkimit Sovjetik, derisa erdhi rënia e murit të Berlinit në vitin 1989 dhe shthurja e atij sistemi.

Duke u kthyer përsëri në periudhën e pas Luftës së Ftohtë, atë të dekadës së parë nga 1990-2000, Rajoni i Ballkanit u përfshi nga një destabilitet të madh si rrjedhim i dezintegritimit të Republikës Federale të Jugosllavisë. Rajoni u përfshi nga konfliktet, tensionet, ndarjet etnike, ndarjet kulturore, fetare dhe krahinore. Si rezultat zhvillimi i ekonomisë u ndërpre duke ndaluar dhe stacionuar jo vetëm rritjen e mirëqenies ekonomike, por edhe zhvillimin e demokracisë së vendeve, si dhe një frenim të reformave të brendshme për zhvillim.

Vihet re se pas vitit 2000 e në vazhdim i gjithë rajoni u fut në një periudhë stabiliteti me më pak probleme dhe çështje të pazgjidhura. Ky stabilitet e ka bazën e vet edhe te rritja e bashkëpunimit rajonal midis vendeve me praninë e organizatave ndërkombëtare, të cilat u përfshinë me ndihma reale dhe me iniciativa konkrete për zhvillimin dhe përparimin në të gjitha fushat ekonomike dhe shoqërore.

Bazuar në SSK, rreziqet dhe kërcënimet kryesore ndaj Republikës së Shqipërisë, ndahen në të brendshme dhe të jashtme. Në kërcënimet dhe rreziqet e brendshme përfshihen: krimi i organizuar, korrupsioni, zhvillimi i pamjaftueshëm ekonomik, katastrofat natyrore, si dhe problemet demografike etj. Ndërsa në ato që janë me karakter transkombëtar radhiten: destabilizimi rajonal, terrorizmi ndërkombëtar, krimi i organizuar, trafikimi i paligjshëm, përhapja e Armëve të Dëmtimit në Masë, si dhe përdorimi i forcës ushtarake, e cila për kohën që jetojmë radhitet e fundit si mundësi reale për të vepruar. Këto sfida dhe rreziqe nuk janë vetëm për Shqipërinë, ato janë edhe për vendet e rajonit tonë dhe kjo e bën më të

rëndësishme bashkëpunimin me këto vende për të përdorur mjete dhe burime të përbashkëta për të minimizuar rreziqet.

Integrimi në strukturat Euro-Atlantike të sigurisë ka qenë dhe mbetet një nga objektivat kryesore të të gjitha qeverive të vendit tonë të pas Luftës së Ftohtë. Në objektivat e Politikës së Jashtme të vendit tonë theksohet qartë ky synim, duke specifikuar edhe mënyrat se si mund të arrihet realizimi i saj, nëpërmjet integrimit rajonal, zhvillimit të diplomacisë ekonomike dhe kulturore, promovimit të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe etj.

Për sa i përket integrimit në NATO, theksojmë se Shqipëria radhitet ndër vendet e para që filloi lëvizjet dhe kontaktet me NATO-n, me synim një anëtarësim të mundshëm në këtë organizatë të fuqishme politiko-ushtarake. Në vitin 1994, ajo iu përgjigj pozitivisht ftesës së Partneritetit për Paqe, si dhe u përfshi në programet kryesore të saj, të tilla si Programi Individual i Partneritetit (IPP) dhe Procesi i Planifikimit dhe Rishikimit të Partneritetit (PARP). Më vonë, si rezultat i hedhjes së hapave pozitive, si dhe dëshirës për të përshpejtuar ritmet e integrimit, vendi ynë u përfshi në Planin e Veprimit për Anëtarësim (MAP) në NATO në vitin 1999, iniciativë e filluar në Samitin e NATO-s në Uashington, për ato vende të cilat do të ishin aspirante për në NATO.

Rruga e përshkruar më sipër mund të ishte edhe më e shkurtër duke pasur parasysh hapat prapa që u hodhën në periudhën e krizës së vendit në vitin 1997 dhe destabiliteti i brendshëm në vitin 1998. Duket se momentet historike që na janë paraqitur nuk i kemi shfrytëzuar sa dhe si duhet dhe kjo ka çuar në vonesa dhe shtyrje të procesit të integrimit, me pasoja në radhë të parë për ekonominë e vendit dhe të individit.

Me futjen në MAP, duke punuar me hapa konkretë në pesë fushat kryesore të integrimit (dhe jo vetëm në atë ushtarake), shikojmë se si shteti bëri hapa pozitivë me reforma të gjithanshme në të gjitha fushat, veçanërisht në fushën politike-ekonomike, të mbrojtjes, financave, mbrojtjen e informacionit të klasifikuar e deri te përshtatja e legjislacionit kombëtar me atë të Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Një hap i rëndësishëm, që tregoi jo vetëm progresin, por gjithashtu iu dha një nxitje vendeve të rajonit, të cilat ishin përfshirë në procesin e anëtarësimit si vende aspirante, ishte pa dyshim iniciativa e *Adriatic Charter* (US-A3) ku Shqipëria, Maqedonia dhe Kroacia me asistencën e drejtpërdrejtë të SHBA-së vendosën të rrisin bashkëpunimin drejt realizimit të objektivit të përbashkët madhor, atë të integritetit në NATO.

Rruga tjetër po aq e rëndësishme sa e para është rruga që ka bërë Shqipëria drejt Bashkimit Evropian. Arritja me madhe në këtë drejtim ka qenë futja në Procesin e Stabilizim-Asociimit me BE-në, si dhe realizimi i përfundimeve të Samitit të Selanikut në vitin 2003 që njihet me emrin Axhenda e Selanikut për Ballkanin Perëndimor. Kulmin e marrëdhënieve me BE-në, Shqipëria e arriti në vitin 2006 me firmosjen e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, e cila tashmë është në proces ratifikimi me të gjitha vendet anëtare, e cila, sipas raporteve zyrtare, po ecën me ritme të kënaqshme.

Bashkëpunimi dhe integrimi rajonal thuhet se është pararendës i integritetit në NATO dhe BE. Në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (2005) theksohet se *“Republika e Shqipërisë aspiron të jetë një faktor stabiliteti dhe paqe në rajon dhe tregon jo armiqësi apo pretendime territoriale dhe ndryshime të kufijve me anën e forcës. Shqipëria është deklaruar kundër krijimit të krizave dhe konflikteve dhe kundër zgjidhjes së tyre me anën të mjeteve të dhunës.”*

Disa nga iniciativat më të rëndësishme që përfshiu Ballkanin Perëndimor dhe vendin tonë, si pjesë e tij ishin Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), Pakti i Stabilitetit (SP) për Evropën Juglindore, Shoqata e Tregtisë së Lirë për Evropën Qendrore (CEFTA), SEEI, Iniciativa e Evropës Qendrore (CEI), Iniciativa e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SECI), Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi (BSEC), Iniciativa Adriatik-Jon (AII) etj. Nga këto rrodhën disa nëninitiativa, të cilat ishin të lidhura më direkt me aspektet e sigurisë, mbrojtjes dhe bashkëpunimit ushtarak. Më të rëndësishme ishin SEDM-i, Tavolina III e Punës së Paktit të Stabilitetit, RACVIAC, Adrion, SEEC etj.

Shkëmbimi i pikëpamjeve, përvojave, eksperiencave, bashkëpunimi dhe “hapja” ndaj njëri-tjetrit, rriti frymën e mirëbesimit reciprok dhe prosperitetin për të ardhmen. Pa dyshim e një rëndësie të veçantë konsiderohet kooperimi në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, disa prej aktiviteteve më të rëndësishme mund të konsiderohen si më poshtë:

- Lufta kundër korrupsionit, trafikut të paligjshëm dhe krimit të organizuar
- Roli dhe trajtimi i forcave paraushtarake dhe ushtarake
- Mospërhapja dhe kontrolli i armëve si dhe procesi i çarmatimit
- Menaxhimi dhe mbikëqyrja
- Ruajtja dhe sigurimi i kufirit
- Reforma në polici, shërbimin doganor, shërbimet inteligjente, sistemin gjyqësor, sistemin penal
- Paralajmërimi i hershëm dhe menaxhimi i konflikteve
- Përgatitja dhe parandalimi i katastrofave etj.

Sa dhe si janë shfrytëzuar këto mekanizma dhe aktivitete bashkëpunimi, mbetet për t’u analizuar nga organe më të specializuara, duke bërë në të njëjtën kohë edhe krahasimin e përfitimeve të secilit vend të veçantë të rajonit dhe në përfundim të rajonit në tërësi. Megjithatë kjo duket pak a shumë edhe me hapat që ka secili vend lidhur me integrimin në NATO, BE etj., të cilat shkurtimisht shtjellohen më poshtë.

Për sa i përket iniciativave më të rëndësishme në fushën e mbrojtjes për vendet e Evropës Juglindore ishin dhe mbeten pa dyshim SEDM-i dhe Karta e Adriatikut. E veçantë për ne është se të dyja këto iniciativa u nënshkruan në Tiranë; përkatësisht SEDM-i më 24 mars 1996, ndërsa Karta e Adriatikut më 2 maj 2003.

SEDM-i lindi pak a shumë si një organizatë për sigurinë rajonale. Dihet tashmë që para se të bëhet integrimi në strukturat ndërkombëtare të sigurisë, vendet punojnë dhe nxiten të kenë bashkëpunim dhe siguri në nivel rajonal. Është e natyrshme që fillimi i bashkëpunimit në të tilla iniciativa

fillon në nivele të larta me takime të personaliteteve, nënshkrim të marrëveshjeve në fushën e sigurisë, mbrojtjes duke zbritur deri në nivelin e bashkëpunimit ushtarak me aktivitete dhe fusha bashkëpunimi më specifike.

Që nga krijimi i tij, SEDM ka zhvilluar disa projekte dhe nënprojekte. Nga më të rëndësishmet kanë qenë zhvillimi i Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Evropës Juglindore (MPFSEE), nga e cila, në vitin 1998, lindi Brigada e Evropës Juglindore (SEEBRIG). Në të bëjnë pjesë njësi nga vendet pjesëmarrëse, të cilat përgatiten për të rritur ndërveprimin dhe për të marrë përsipër përgjegjësi të përbashkëta për menaxhimin e krizave dhe detyra të tjera me karakter paqeruajtës. Kulmin e zhvillimit SEEBRIG-u e pati me marrjen pjesë në operacionin ISAF në vitin 2006, ku shtabi i saj, i përforcuar me elemente të tjerë, mori pjesë direkt në mision për 6-muj në Afganistan, duke marrë pjesë me sukses në një operacion real të NATO-s.

Të tjera iniciativa dhe projekte nën SEDM përmendim SEDRO, SEDM-CC, CBSC, SEEDIRET, SIMIHO, SEESIM, CMEPSEE etj. Pa dyshim slogani “*open door policy*” për vendet e tjera të rajonit, të cilat donin dhe duan të marrin pjesë në SEDM ka qenë dhe mbetet i hapur, i ngjashëm ky slogan me sloganin e NATO-s për “dyer të hapura” për ata që duan dhe plotësojnë standardet e integritimit.

Ndryshe ka ndodhur me iniciativën e A-3 ku si qëllim kryesor ka pasur përshpejtimin e integritimit të 3-vendeve aspirante, përkatësisht Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kroacisë për anëtarësim në NATO. Ndër aktivitetet më kryesore të saj përmenden takimet në nivel të lartë, presidencial, parlamentar, ministerior, shefash shtabi të ushtrive respektive, takime të tjera deri në nivel ekspertësh, duke vazhduar me përgatitjen dhe implementimin e programeve vjetore për të rritur kapacitetet dhe ndërveprimin midis vendeve. Një nga rezultatet e para kontribuese të tri vendeve ka qenë krijimi i një Ekipi të Përbashkët Mjekësor, i cili, edhe ky, mori pjesë me sukses në Afganistan. Edhe pse ekipi ishte i vogël në numër ai u tregua shumë efikas në kushtet e nevojave të mëdha që ka situata në Afganistan.

Një tjetër iniciativë shumë e suksesshme në rajonin e Ballkanit ka qenë Pakti i Stabilitetit, i cili shpeshherë quhet edhe si “*Plani Marshall*” për Ballkanin, duke e krahasuar atë me planin me të njëjtin emër që u aplikua në Evropën Perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore për të bërë të mundur rimëkëmbjen e saj nga gërmadhat e pasluftës.

Tavolina III me Paktin e Stabilitetit mbulon çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes. Disa nga nëngrupet e punës mbulojnë aspekte të tilla si konvertimin e bazave ushtarake, Armët e Vogla dhe Armatimin e Lehtë (SALW); Qendrën Rajonale të Asistencës për Implementimin dhe Verifikimin e Armë-Kontrollit (RACVIAC) dhe Iniciativën për Përgatitjen dhe Parandalimin e Katastrofave (DPPI). Nëngrupi i dytë i Tavolinës III merret me Çështjet e Brendshme dhe të Drejtësisë. Disa nga aspektet më kryesore që trajtohen në grupe të veçanta janë: Krimi i Organizuar, Ani-Korrupsioni, Iniciativa Rajonale për Migrimin, Azilin dhe Refugjatëve (MARRI).

Nga të gjitha këtë iniciativa rajonale vendi ynë ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në mënyrë aktive duke ndikuar drejtpërsëdrejti në uljen e klimës së tensionit dhe mosmarrëveshjeve midis shteteve dhe duke rritur frymën e bashkëpunimit me interes të përbashkët.

Krijimi dhe zhvillimi i singertë i marrëdhënieve reciproke me vendet e rajonit dhe gjithashtu të drejtat dhe liritë e qytetarëve shqiptarë kudo që ata janë, janë një prioritet për sigurinë e RSH-së. Kjo përbën një kusht për vendosjen e marrëdhënieve me vendet fqinjë ku elementi shqiptar tashmë ndodhet në çdo shtet fqinj në proporcione të ndryshme. Politika shqiptare ka qenë nën moton që pakicat duhet të shërbejnë si “*ura lidhje*” midis këtyre vendeve si “*katalizatorë*” për promovim të marrëdhënieve ekzistuese dhe për nxitjen e tyre më tej.

Rajoni i Ballkanit duket se gjithnjë e më tepër po i bashkëngjitet familjes evropiane, Bashkimit Evropian, si dhe Aleancës së Atlantikut të Veriut. Vende të ndryshme të rajonit kanë status të ndryshëm për sa i përket marrëdhënieve me NATO-n dhe BE-në, të cilat kanë një zhvillim historik progresiv. Për sa i përket integritit në NATO kemi këto

zhvillime në kohë: Greqia dhe Turqia janë anëtarë qysh në vitin 1952, ndërsa Bullgaria, Rumania dhe Sllovenia u futen rreth 42 vjet më vonë, konkretisht në vitin 2004. Nga ana tjetër tri vendet e Kartës së Adriatikut, Shqipëria, Maqedonia dhe Kroacia janë kandidate aspiruese dhe shpresojnë të marrin ftesën për anëtarësim në vitin 2008. Po ashtu zhvillim pozitiv në vitin 2006 patën edhe Bosnje Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, të cilat u bënë anëtare të Partneritetit për Paqe (PfP), duke e ndryshuar disi “ngjyrën” e vendeve në hartën e Ballkanit drejt simbolit “*blu*” si simbol i Aleancës më të fuqishme të botës, NATO-s.

Për sa i përket hapave drejt integritimit në BE, kompozicioni i shteteve shfaqet si vijon: Greqia është bërë anëtare që në vitin 1981, pas saj Sllovenia dhe Qipro në vitin 2004, ndërsa Bullgaria dhe Rumania në vitin 2006. Në të njëjtën kohë kandidatë për në BE janë vendet e Kroacisë, Turqisë dhe Maqedonisë, të cilat janë pranuar me një status në vitin 2005. Vendi ynë ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit që në vitin 2006 dhe po punon për plotësimin e standardeve, duke bërë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim.

Kosova mbetet i vetmi rajon si një çështje e pazgjidhur në Ballkan. Qeveria shqiptare është shprehur për pavarësinë si statusi i vetëm i saj. Shqipëria zyrtare mbështet Planin Ahtisari, i cili mbështetet nga vendet e BE, NATO-s dhe SHBA, pasi ai konsiderohet si një plan i gjykuar dhe i balancuar për krijimin e një shoqërie shumë etnike dhe demokratike, duke përfshirë të drejta maksimale për komunitetin serb në Kosovë. Është e natyrshme që të ketë probleme ekonomike dhe sociale në Kosovë menjëherë pas marrjes së statusit, por le të fillohet me sigurinë së pari, pasi të tjerat vijnë vetë më vonë. Mandanti i BE-së është i mirëpritur në Kosovë pas marrjes së statusit, i ngjashëm me mandatin që kishte BE në Bosnje Hercegovinë, e cila konsiderohet si i suksesshëm.

Aspekti i fundit që trajtojmë në këtë shkrim është ai i kontributit që jep Shqipëria për sigurinë në vend, rajon dhe në botë. Fillimisht siguria në vend është një element shumë i rëndësishëm para se ta “*eksportosh*” atë diku gjetkë. Në vend po punohet për të përmbushur me sukses reformat në

elementet e veçantë të strukturave të sigurisë siç janë ato të forcave të armatosura, policisë së shtetit, policisë kufitare, dhe shërbimeve të sigurisë dhe inteligjencës. Hap tjetër i rëndësishëm është harmonizimi dhe integrimi i përpjekjeve, duke e konsoliduar sistemin e sigurisë në vend.

Gjithë transformimi i bërë në forcat e sistemit të sigurisë në përgjithësi dhe atyre të armatosura në veçanti, kanë bërë të mundur që edhe Shqipëria të renditet midis vendeve që kontribuojnë realisht me trupa për paqen dhe forcimin e sigurisë globale në rajon dhe në botë. Duke parë kërkesat e sotme për sigurinë globale, Shqipëria ka filluar që në vitin 1996 të dërgojë trupa dhe kontingjentë për të shërbyer jashtë vendit në operacionet paqeruajtëse dhe humanitare. Sot forcat tona gjenden në Bosnje Hercegovinë, Afganistan, Irak, Gjeorgji si dhe me personel tjetër që vepron në shtabet e partneritetit të NATO-s dhe në shtabe të tjera shumëkombëshe, duke u bërë kontribuese reale për sigurinë dhe stabilitetin në rajon dhe në botë.

Si *konkluzion* mund të themi se Shqipëria pas Luftës së Ftohtë i është përshtatur sfidave të reja të sigurisë. Ajo ka qenë promotore e stabilitetit në rajon, duke forcuar bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh, sidomos në organizmat dhe iniciativat që çojnë direkt në anëtarësimin në strukturat Euro-Atlantike të sigurisë dhe mbrojtjes. Duke bashkëpunuar në këtë mënyrë Shqipëria ka qenë e aftë të kontribuojë realisht për paqen dhe stabilitetin në rajon dhe më gjerë, në të cilat ka fituar eksperiencat e nevojshme dhe besimin për të vazhduar në këtë rrugë të pakthyeshme.

Dr. Amadeo Watkins dhe Srdjan Gligorijevic

NATO DHE BALLKANI: SHEMBULLI PËR NJË INTEGRIM MË TË GJERË.

Evoluimi i NATO-s pas Luftës së Ftohtë është influencuar fuqishëm nga ngjarjet në Ballkan. Megjithëse pas çdo mbledhje të nivelit të lartë të NATO-s, Aleanca ka zgjeruar fushën e angazhimeve dhe interesave të veta strategjike, Ballkani ngelet një rajon tepër shqetësues për Organizatën. Por, këndvështrimi i vetë rajonit mbi NATO-n nuk është edhe aq pozitiv. Tani që paqja është siguruar gjerësisht, pyetja mbetet. Çfarë i duhet Aleancës të bëjë për të fituar mbi “mendjet dhe zemrat” e njerëzve të rajonit, dhe ç’është më e rëndësishme, çfarë duhet të ndodhë për të forcuar stabilitetin në këtë zonë?

Në prag të Rigës

Një përfundim pozitiv për Ballkanin Perëndimor nga Samiti Rigës (NATO Nëntor 2006) është që tani të gjitha vendet në rajon kanë institucionalizuar marrëdhëniet me NATO-n; ose nëpërmjet anëtarësimit të plotë, programi Partneriteti për Paqe (PfP) ose Këshilli i Bashkëpunimit Euro-Atlantik. Historikisht,

Dr. Amadeo Watkins është një ekspert në Reformat e Sektorit të Sigurimit në Ballkan në Akademinë e Mbrojtjes në Mbretërinë e Bashkuar. Srdjan Gligorijevic i specializuar në çështjet e sigurimit në NATO dhe në Bashkimin Europian (EU) të Qendra për Punë Ndërkombëtare dhe të Sigurimit (ISAC) në Beograd. Pikëpamjet e shprehura nga autorët janë të tyre dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e institucioneve të tyre respektive.

sa herë që vendet ballkanike kanë pasur diferenca të mprehta në lidhje me sigurimin, kanë ardhur probleme. Tani që të gjitha këto vende ndajnë qëllimin e përbashkët për integrimin Euro-Atlantik, dhe tani që të gjitha këto shtete janë të angazhuara në një forum të përbashkët nëpërmjet marrëdhënieve të tyre me Aleancën, pragu i ngarkuar me rreziqe deri në njëfarë mase është kapërcyer. Kjo do të thotë që, situata e sigurisë në Ballkanin Perëndimor është akoma larg ideale, pa asnjë garanci që “zgjidhja” e Kosovës do t’i japi një fund tensioneve në rajon. NATO është në dijeni të këtij fakti - Deklarata e Samitit të RIGA-s së Nato-s përmendi që “Integrimi Euro-Atlantik, i bazuar në solidaritetin dhe vlerat demokratike, ngelet i domosdoshëm për Ballkanin Perëndimor për një stabilitet afatgjatë”.

Ecuria e procesit

Aleanca ndan përgjegjësi, si një pjesëmarrëse aktive, për të përcaktuar sfondin pas-konfliktual, i cili gradualisht ka evoluar gjatë gjashtë viteve të shkuara, kur të gjitha shtetet ballkanike lëviznin në nivele të ndryshme në drejtim të praktikave demokratike. Angazhimi i mëparshëm i NATO-s mban datën pas qershorit 1992 në Mbledhjen Ministrore në Oslo, në fazat e para të Luftës së Bosnjës. Në këtë mbledhje, ministrat e jashtëm të NATO-s shprehën gatishmërinë e tyre për të mbështetur, rast pas rasti, disa detyra paqeruajtëse, nën përgjegjësinë e Konferencës mbi Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (paraardhëse e OSCE-së), duke kontribuar me materiale dhe ekspertizë. Gjatë pak viteve më pas, situata evoluese në Ballkan kërkonte që Aleanca të zgjeronte aktivitetet e saj politike dhe ushtarake. Më 28 shkurt 1994, Forcat Ajrore të Aleancës qëlluan katër aeroplanë luftarakë, që shkelën Zonën e NDALIM-FLUTURIMIT mbi Bosnjë dhe Hercegovinë.

Kjo ishte hera e parë që forcat e NATO-s ishin angazhuar në luftim. Pas përfundimit të Marrëveshjes së Paqes për Bosnjën dhe Hercegovinën në vjeshtë të 1995, NATO-s iu

vu si detyrë nga Rezoluta 1031 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të siguruar një forcë vepruese (IFOR) me një numër prej 60 000 trupash, duke marrë në këtë mënyrë përgjegjësinë për paqe dhe stabilitet në vend. IFOR ishte operacioni i parë paqeruajtës i ndërmarrë ndonjëherë nga NATO. Aksioni i NATO-s u ndërmor gjithashtu për të forcuar paqen në Kosovë në 1999 dhe përsëri për të çarmatosur grupet etnike shqiptare si dhe për të mbledhur armët e tyre në ish-republikën jugosllave të Maqedonisë në 2001. Sot, the Kosovo Implementation Force (KFOR) mbetet vendosja operationale e trupave më e madhe e NATO-s në rajonin Euro-Atlantik.

Në ndryshim kursi

Kështu pra, Aleanca mbetet edhe sot e pranishme në rajon. Përveç KFOR, NATO mban qendra lokale ne Sarajevë, Shkup dhe Tiranë. Që prej dhjetorit 2006, Aleanca ka ngritur një zyrë koordinimi në Beograd, që ka për detyrë lehtësimin e bashkëpunimit serb me NATO-n sipas programit të Partneritetit për Paqe. Kjo prezencë e NATO-s është një faktor pozitiv, jo vetëm në kuadër të rritjes së sigurisë, por edhe të ndihmës në afrimin e rajonit me komunitetin Euro-Atlantik.

Marrëdhëniet e NATO-s me Ballkanin perëndimor kanë evoluar gjatë dekadës së fundit. Sot Aleanca duket që po i sjell grupet më pranë njëra-tjetrës, duke qenë se vende të veçanta në rajon janë duke u përpjekur, në nivele të larta apo të ulëta, për t'iu afruar klubit Euro-Atlantik dhe për t'u larguar nga turbullimet e së shkuarës.

Ndërsa prezenca fizike e forcave të Aleancës mbetet e një rëndësie vendimtare në disa pjesë të rajonit, gjatë viteve të kaluara NATO ka qenë gjithnjë e më shumë e angazhuar në reformat e mbrojtjes. Aleanca është duke zhvilluar një fushë të re kompetencash, në përputhje me orientimin e saj strategjik.

NATO asiston dhe mbështet iniciativat për reforma nëpërmjet një shumëllojshmërie mekanizmash. Për shembull,

Shqipëria, Kroacia dhe ish-republika jugosllave e Maqedonisë morën pjesë në Planin e Veprimeve për Anëtarësim të NATO-s (MAP) si kandidatë rajonalë të “avancuar”. Para se të futeshin në PfP, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina përfituan Programe Bashkëpunimi të Pjesshme. Këto programe po rregullohen duke ndjekur Samitin e Rigës. Hapi tjetër për këto vende do të jetë zhvillimi i Programeve Individuale për Partneritet (IPPs).

Duke marrë në konsideratë atë çka u përmend me sipër, standardet e NATO-s duhet të shërbejnë si standarde përfundimtare për vlerësimin e mbrojtjes dhe reformave përkatëse në rajon. Megjithatë, ky qëllim në disa raste është minuar në nivel praktik, për shkak të ndërhyrjes së marrëdhënies bilaterale, të cilat jo domosdoshmërisht përputhen me ecurinë për arritjen e objektivave të vet strategjike nga një vend i veçantë. Sipas këndvështrimit tonë, mungesa e koordinimit dhe transparencës midis Aleatëve të NATO-s’ka qenë dhe vazhdon të jetë pengesa e vetme dhe më e rëndësishme drejt një angazhimi më efektiv dhe disa herë ka luajtur një rol negativ në rrugën e reformave të mbrojtjes në rajon.

Hezitimi dhe Mikromenaxhimi

A ka marrë fund hezitimi i komuniteti Euro-Atlantik për t’u marrë me Ballkanin, hezitim i cili ishte shume evident në hapat e parë të luftës në ish-Jugosllavi? Përgjigjja është jo. Edhe pse Aleanca është gati të angazhohet në terma të ofrimit të një udhëheqjeje dhe këshillave, akoma është e lëkundur në përdorimin e peshës së saj politike për përshpejtimin e reformave. Mënyra më e mirë për arritjen e atyre reformave që NATO do të donte të shikonte në Ballkan, si në terma të cilësisë ashtu dhe të afateve kohore, është shtimi i dialogut me aktorët rajonalë. Një dialog i tillë patjetër duhet t’i përshtatet situatave të veçanta të vendeve përkatëse, në përputhje me rregullin “regata” (që secili vend duhet të bëjë progres në përputhje me ritmin dhe aftësinë e vet për të marrë përsipër

përgjegjësi për një bashkëpunim më të ngushtë). Ky proces patjetër që do të jetë delikat, por jo i paarritshëm, në qoftë se praktikohet në mënyrë të drejtë. Problemi i një mikromenaxhimi gjithashtu gjen vend në këtë kontekst, veçanërisht në lidhje me aktivitetet e ardhshme të NATO-s, si dhe me përvojat tashmë të mësuara nga rajoni. Një mikromenaxhim tërësor nga Aleanca nuk është i dëshiruar, sepse ajo kufizon pronësinë vendore të objektivit. Për më tepër, brenda kuadrit aktual të NATO-s, nuk ka kapacitete për një përfshirje në nivel shumë të vogël. Megjithatë, Aleanca mund të përdorë një metodikë më të mirë dhe më imponuese. Një qasje dhe angazhim më i madh nga NATO, do të ndihmonte aktorët rajonalë për arritjen në mënyrë më të lehtë të një konsensusi politik, si dhe zbutjen e disa prej vështirësive të shkaktuara nga mungesa e burimeve. Iniciativa e Grupit të Reformave të Mbrojtjes së Aleancës në Serbi ishte pa dyshim një hap përpara dhe që duhet të përforcohet.

Sfidat në të ardhmen

Ngritja e besimit, gjë e cila është thelbësore për të pasur sukses, nuk ka qenë e lehtë, si vertikalisht ndërmjet NATO-s dhe kryeqyteteve rajonale, ashtu edhe horizontalisht ndërmjet vetë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Programi i Partneritetit për Paqe përdor një shumëllojshmëri mënyrash për të shtyrë më tej reformat dhe për të ndërtuar vetëbesimin. Ndërsa shumë nga këto mënyra janë të lidhura me mbrojtjen, ka gjithashtu një fushë më të gjerë iniciativash, që shtrihen përmes spektrit të aktiviteteve qeveritare dhe joqeveritare.

Ka akoma sfida në të ardhmen dhe shumë prej tyre burojnë ose nga mungesa e kapacitetit të përshtatshëm brenda për brenda rajonit, ose, ç'është më e rëndësishmja, nga mungesa e pjekurisë politike të frontit të brendshëm. Integrimi Euro-Atlantik është një objektiv i rëndësishëm për shumë aktorë në Ballkanin Perëndimor dhe ne besojmë se është një objektiv që mund të përdoret si mjet për t'u përballur me disa sfidat

më të vështira në rajon në lidhje me sigurinë dhe stabilitetin. Kështu që është e nevojshme të gjenden mekanizma për të siguruar vazhdimin aktiv të mbështetjes për institucionet akoma të dobëta të Ballkanit Perëndimor, veçanërisht në jug, - duhet që përherë e më tepër të rforcohet mesazhi me elitën politike të rajonit.

NATO është angazhuar në Ballkan për më tepër se një dekadë tashmë. Perceptimet e Aleancës nuk janë tepër pozitive në disa vende. Anëtarësia në NATO përbën akoma një prioritet të ulët për shumë njerëz në rrugë - dhe për elitën - në disa vende të rajonit. Arsyeja e vetme e madhe në lidhje me këtë është mungesa e informacionit të mjaftueshëm rreth Aleancës. Megjithëse kjo përpjekje duhet në fund të fundit të drejtohet nga përbrenda, NATO duhet të marrë përsipër të inkurajojë pozitivisht opinionin publik në rajon sa më shpejt të jetë e mundur.

Bashkëpunimi Rajonal

Nuk ka dyshim që NATO ka ndihmuar në drejtimin e bashkëpunimit rajonal. Dhe megjithëse të limituara si në cilësi ashtu edhe në sasi, disa rezultate pozitive janë shfaqur tashmë. Për shembull, Kroacia, duke ndjekur modelin slloven, ka filluar gradualisht të angazhohet në rajon, veçanërisht në shkëmbimin e eksperiencave me fqinjët e saj. Por, ka akoma shumë vend për përmirësim nëpër rajon dhe nevojiten më shumë masa konkrete, veçanërisht në rritjen e partneritetit lokal.

Duhet t'i bëhet e qartë të gjithë aktorëve në Ballkanin Perëndimor që bashkëpunimi rajonal është vital si për të gjithë rajonin si edhe për shtete individuale, veçanërisht në kontekstin e lehtësimit nga trashëgimia negative dhe përmirësimit të zhvillimit ekonomik. Për më tepër, buxhetet e limituara për reformat në mbrojtje, veçanërisht për aftësinë ndërvepruese shtojnë nevojën për modele të reja të bashkëpunimit rajonal në dobi të të gjithëve. Kjo duhet të shërbejë si etapa finale për vendet e interesuara.

Veç kësaj, Pfp e Aleancës duhet ta vendosë më shumë theksin në aspektin rajonal, veçanërisht në fushat “e buta” si arsimit dhe trajnimit. Kjo do të ishte një mënyrë e mirë për të përkrahur bashkëpunimin rajonal praktik, për të vendosur anët konfliktuale të punojnë së bashku dhe për të ndërtuar besimin. Deri tani, fokusimi në këto aspekte ka qenë paksa i kufizuar, dhe përqendrimi më i madh ka qenë në rritjen e ndërveprueshmërisë me forcat e NATO-s.

Organizatat ndërkombëtare

Një nga pikat kryesore të transformimit të NATO është bashkëpunimi i saj me organizatat ndërkombëtare. Kriza afatgjatë në Ballkan, në të cilën Aleanca u përfshi intensivisht, vendosi një precedent të ri për marrëdhëniet që erdhën më pas të NATO-s me organizatat ndërkombëtare kryesore si Kombet e Bashkuara (UN) dhe OSBE-në, një fakt që u theksua në *Drejtimin Politik Gjithëpërfshirës*, të nënshkruar në Samitin e Rigas.

Mbase bashkëpunimi më i suksesshëm, si një partneritet strategjik, është ai midis NATO-s dhe Bashkimit Europian (EU). Ky partneritet jo vetëm që u krijua në Ballkan, por rajoni paraqet një fushë testimi për një bashkëpunim të ardhshëm NATO-BE. Të dyja këto do të luajnë një rol të rëndësishëm në pozicionimin e mëtejshëm të Kosovës. Bashkëpunimi ndërmjet NATO-s dhe cilido misioni civil të BE-së në Kosovë do të jetë një test i rëndësishëm.

Periodha nga 2007 deri 2008 do të jetë vendimtare për Ballkanin Perëndimor, por edhe për NATO-n, kryesisht për shkak të çështjes së statusit të ardhshëm të Kosovës dhe ndërlikimeve rajonale përkatëse.

Aleanca ka arritur shumë në rajon, një rëndësi të madhe merr siguri i një mjedisi të qëndrueshëm dhe të sigurt për një zhvillim afatgjatë. Si element bazë të fillimit të saj, Aleanca ka iniciuar programe si fondi i krijimit të besimit për çmobilizimin dhe trajnimin rajonal. Megjithatë, siç u sugjerua edhe më sipër, puna e NATO-s nuk duhet të përfundojë me

kaq. Nga shume këndvështrime rajoni ende është një zonë post-konfliktuale në tranzicion dhe ka nevojë për asistencë të vazhdueshme, veçanërisht një kohe që Aleanca është e angazhuar për një zgjerim të mëtejshëm. Kalimi në pronësi vendore të reformave duhet të menaxhohet me kujdes, mundësisht në një linjë me Iniciativën e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal të Paktit të Stabilitetit (RCC).

Të kuptuarit e rolit të NATO-s në Ballkan kërkon pranimin e faktit që vendet e rajonit janë shumë të ndryshme. Njëkohësisht, ndërsa *rregulli "regata"* është padyshim e vetmja rrugë efektive për të ecur përpara, bashkëpunimi rajonal nuk duhet të shpërfilllet. Në nivel praktik mund të shfaqet kundërvënie midis këtyre dy parimeve - veçanërisht ndërmjet lojtarëve kryesore në rajon - por angazhimi aktiv i NATO-s mbetet një faktor i rëndësishëm balancues.

Geron Kamberi

BE DHE PËRPJEKJET E SAJ PËR NJË POLITIKË TË JASHTME *

MA në Politikat Europiane Sussex European Institute-UK

Shprehja e dikurshme e ish-Sekretarit Amerikan të Shtetit Henri Kissinger se: “Nuk di se cilit numër telefoni t’i bie në Bruksel për politikën e jashtme” nuk përmbante në vetvete thjesht ironinë, por ishte në të njëjtën kohë edhe dëshmi e situatës së paqartë të BE-së në lidhje me aspektin më të rëndësishëm të fuqisë politike. Në të vërtetë përpjekjet në këtë drejtim nuk kanë munguar përgjatë gjithë historisë së deritanishme të BE-së, çka tregon se ajo ka përbërë një shqetësim jo të vogël për të rritur peshën e saj si faktor me rëndësi në marrëdhëniet ndërkombëtare e vendimmarrjet e rëndësishme.

* Shënim: Opinioni publik kohët e fundit është duke ndjekur me interes negociatat për zgjidhjen e statusit të Kosovës, ku BE është një ndër aktorët dhe vendimmarrësit kryesorë. Për shkak të karakterit “sui generis” të këtij institucioni dhe dallimet me SHBA, veçanërisht në mënyrën se si e përcjell vendimmarrjen në fushën e politikës së jashtme, ky artikull përqipet të sqarojë e të bëjë të njohur përpjekjet jo të lehta të këtij institucioni për krijimin e identitetit të tij në këtë fushë. Në këtë mënyrë lexuesi mund ta ketë më të lehtë të kuptojë edhe qëndrimet e tij të deritanishme për çështjen e Kosovës, në raport me mekanizmat e tij institucionalë të politikës së jashtme.

I. Periudha e viteve 50-60: Dëshirat e dyshimet mes dy shpejtësive integruese

Përpjekjet për një bashkim politik, i cili do të përfshinte edhe politikën e jashtme, filluan të materializohen që në fillimet e projektit funksionalist të Zhan Monesë mbi BE. Ky projekt nisi me Komunitetin e Çelikut e Qymyrit më 23 prill 1951 për t'u pasuar nga Traktatin e Romës më 25 mars 1957, që shënoi lindjen e Komunitetit Ekonomik Europian e të Euroatomit. Kështu pas afro 1 viti, Robert Shumani, ish-ministri francez i punëve të jashtme, i cili i kishte dhënë jetë “Projektit Europian” me Deklaratën e 9 majit 1950, do të deklaronte sërish në shtator 1951 se Franca do të propozonte krijimin e një organizate politike evropian, që do të kishte një politikë të jashtme të përbashkët. Përpjekja për ta kaluar këtë ide pranë Këshillit të Europës, një institucion tashmë i krijuar sipas vizionit çurcillian më 5 maj 1949, hasi në kundërshtimin e britanikëve, të cilët do të transmetonin për një periudhë të gjatë kohe një “euroskeptizëm”, herë të fshehtë e herë të hapur, në lidhje me përpjekjet për një bashkim politik të BE-së ku përfshihej edhe politika e jashtme.

Pavarësisht dështimeve të përkohshme që do ta shoqëronin shpesh ndërtimin e një strukture europiane jo thjesht ekonomike, ministrat e punëve të jashtme të Komunitetit Europian të Qymyrit e Çelikut, i njohur shkurt si ECSC do të mbledheshin më 10 shtator 1952, për të risjellë në vëmendje propozimin e mëparshëm të Robert Shumanit për Komunitetin Politik Europian apo EPC (European Political Community). Megjithëse koncepti për këtë strukturë të re u përpunua e u miratua më 10 mars 1953 nga një Asamble ad-hoc, ku mbizotëronte një model konfederal, mbështetur mbi parimin e ndarjes së pushteteve, me një parlament dydhomësh e president të zgjedhur nga senati, ai nuk do të ngjallte entuziazmin që pritej. Ndërkohë Komuniteti Europian i Mbrojtjes (EDC European Defence Community) i miratuar më 27 maj 1952, në bazë të propozimit të kryeministrit francez Rene Pleven dëshmonte se njëkohësisht po ecej shumë shpejt edhe drejt një identiteti evropian në fushën e politikës së

mbrojtjes, duke tejkaluar jo vetëm shpejtësinë e lëvizjes drejt këtyre qëllimeve, por edhe vizionin për Europën e asaj kohe.

Ashtu siç do të ndodhte shpesh në vitet që do të pasonin, ndryshimet e elitave politike në vendet anëtare të BE-së do të bëheshin shkas për përshpejtimin apo ngadalësimin e çdo politike të përbashkët europiane. Veçanërisht politika e jashtme për liderët me prirje nacionaliste mbetej një “tabu” e paprekshme. Në këtë mënyrë qeveria e re franceze me orientim golist në gjysmën e dytë të viti 1954, e ndërpreu në mes projektin e mësipërm. Kësaj iniciative nuk i erdhi në ndihmë as përpjekja për kompromis në takimin e ministrave të punëve të jashtme nga 19-22 gushtit 1954, ku u synua të gjendej një hapësirë e mundshme për miratimin e strukturës së Komunitetit Politik European (EPC0 dhe ai i Mbrojtjes (EDC). Për ironi të fatit, Franca që kishte ndërmarrë të dy iniciativat, të cilat mund të çonin drejt një komuniteti politik europian me politikë të jashtme e mbrojtje të përbashkët, nëpërmjet votimit të 30 gushtit 1954 në Asamblenë Kombëtare dëshmoi se votat e bashkuara të socialistëve, komunistëve e golistëve ishin kundër një procesi të tillë politik.

Ndërkohë me ardhjen në pushtet të De Golit në Francë, në gjysmën e dytë të viteve '50 u përforcua më tej vizioni konfederalist për ndërtimin e Europës, por në të njëjtën kohë përfytyrimi i tij për një “Europë europiane” i dha shkas debatit mes “europianistëve” e “atlantistëve” në vendet europiane, për sa i përket raportit me SHBA-në në koordinimin e politikës së jashtme e veçanërisht të politikës së mbrojtjes. Dëshmia më e qartë e kundërshtive, në raport me ndërtimin e një komuniteti politik dhe politikë të jashtme europiane u bë vetë propozimi i tij më 5 shtator 1960 për “Platformën mbi Europën”, e cila hidhte bazat për një bashkim politik, ku do të përfshihej edhe politika e jashtme, por tashmë sipas një vizioni golist me tipare të theksuara konfederaliste. Megjithatë mosprania e atëhershme e Britanisë si anëtare e Komunitetit European nxori në pah dallimet mes 6 vendeve të KEE-së. Një komunitet politik me një politikë të jashtme pa Britaninë, do të kthente në skenë ngjyra të ndezura “franko-gjermane”, të cilën nuk ishin të gatshme ta pranonin vende të tilla si Holanda e Belgjika,

për të cilat marrëdhëniet ndëratlantike ishin mjaft të rëndësishme. Të dy samitet që pasuan ai shkurtit 1961 në Paris dhe ai i Bad Godesbergut në korrik 1961, si përpjekje për të sendërtuar vizionin golist për *Bashkimin Politik të Europës* iu lanë në dorë diplomatit francez Kristian Fushe' për të paraqitur propozimet e tij në emër të një komisioni të posaçëm. I ashtuquajturi "Plani Fushe' 1", i paraqitur më 19 tetor 1961 apo ndryshe "*Projekti i Bashkimit të Shteteve*", u përpoq të shënonte një ndryshim në raport me ndërtimin e një politike të jashtme të Komunitetit Europian, teksa parashikonte krijimin e një *Komisioni Politik*. Ky komision që do të përbëhej nga zyrtarë të lartë të ministrive të punëve të jashtme, do të përgatiste vendimet që do të zbatonte Këshilli i Ministrave i Komunitetit Europian, që ishte parashikuar të mblidhej 4 herë në vit për të marrë vendime së bashku me ministrat respektivë të punëve të jashtme. Cenimi i frymës së Traktatit të Romës e mospëlqimi i këtij plani nga vendet anëtare e shtyu De Golin t'i rikthehet vizionit të tij më 18 janar 1962 me Planin II Fushe', i cili ndolli sërish te një pjesë e shteteve, si Belgjika e Holanda, frikën e një politike të izoluar pa përmasën ndëratlantike, ku mosprania e një aktori të rëndësishëm në politikën globale si Britania e bënte të parakohshëm sipas tyre një ndërmarrje të tillë. Përpjekjet e De Golit për të tërhequr Italinë, negociatat, kompromisi në këtë projekt pas një takimi me 4 prill 1962 me kryeministrin italian të asaj periudhe, nuk e shuan shijen e hidhur të dështimit të këtij projekti disa ditë më vonë më 17 prill 1962. Pikërisht në këtë datë mosmiratimi nga ministrat e punëve të jashtme të vendeve anëtare e veçanërisht kundërshtia e Italisë, shënoi fundin e iniciativës së radhës për një Bashkimin Politik Europian.

II. Periudha e viteve '70-'80: EPC (Bashkëpunimi Politik European) Afrimi dhe largimi drejt një politike të jashtme europiane

Për gati 10 vjet me radhë, shtetet e atëhershme anëtare të BE-së e lanë mënjanë idenë për krijimin e një politike të jashtme e mbrojtje të përbashkët, duke u përqendruar më së shumti në forcimin e komunitetit ekonomik. Sfidat në politikën e jashtme e të mbrojtjes, në atmosferën herë të ndezur e herë të ulur të Luftës së Ftohtë, u përpoqën të përballeshin me instrumentet e NATO-s, politikës së neutralitetit apo me anë të mbizotërimit të peshës së SHBA-së apo diplomacisë tradicionale të kancelarive europiane. Në këtë mënyrë, për t'i dhënë sërish shtysë një procesi të ngecur për afro më shumë se një dekadë, u mbledh *Samiti i Hagës më 1-2 dhjetor 1969*, ku liderët e BE-së bënë thirrje që shtetet anëtare të bashkëpunonin për një politikë të jashtme në bazë të një procedure të njohur si *Bashkëpunimi Politik European/European Political Cooperation*. Ky proces po ndodhte në kohën e një zgjerimi të pritshëm (ndërkohë kishin filluar bisedimet e anëtarësimit me Anglinë, Irlandën, Danimarkën e Norvegjinë) ç'ka do të thoshte që një Komunitet European më i zgjeruar, do të ishte politikisht më i dobët, për shkak të përplasjes së interesave të ndryshme në fushën e politikës së jashtme të mbrojtjes. Veçanërisht, shpallja e OSTPOLITIKËS nga kancelari gjerman Villi Brandt (politika e Gjermanisë për lidhjet me vendet e ish-blokut sovjetik) ishte një nxitje më shumë për vendet anëtare që të shkëmbenin informacion mbi çështjet ndërkombëtare, duke u përpjekur të koordinonin politikat e tyre në drejtim të Europës Qendrore e Lindore.

Ndërkohë në krye të Presidencës Franceze kishte ardhur Zhorzh Pompidu, që u përpoq të sillte një frymë disi më gjithëpërfshirëse pas "trashëgimisë goliste" disi autoritare në marrëdhëniet me anëtarët e tjerë të komunitetit. Gjithsesi me propozimin e tij për t'u rikthyer në sistemin e mbledhjeve periodike të ministrave të punëve të jashtme, e cila kishte qenë një praktikë e zakonshme gjatë viteve 1959-1963, ai risolli në

vëmendje edhe një herë variantin e projektit francez për bashkim politik. Si rrjedhojë e Samitit të Hagës, më 20 korrik 1970 do të paraqitej në Parlamentin European Raporti Davinjon, i cili do të miratohej më pas në tetor 1970 në Luksemburg në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të KE-së. Ky raport që ishte hartuar nën kryesinë e diplomatit belg Etien Davinjon nga Komiteti i Drejtorëve Politikë të Ministrive të Punëve të Jashtme të 6 vendeve anëtare, në bazë të një propozimi të kancelarit gjerman Villy Brandt në Samitin e Hagës, përbënte një përpjekje fillestare drejt një bashkimi politik të Komunitetit European. Veçanërisht bashkëpunimi në politikën e jashtme konsiderohej si hapi i parë drejt këtij bashkimi, ç'ka përafrohej me vizionin e mësipërm francez të shprehur edhe nga Pompidu. Kjo do të arrihej përmes informimit dhe konsultimeve mes 6 vendeve për politikën e jashtme, por pa përfshirë çështjet e sigurisë. Mekanizmat e parashikuara për të realizuar këtë bashkëpunim ishin dy: a) *mbledhja e ministrave të punëve të jashtme jo më pak se 2 herë në vit (GFA-General & Foreign Affairs)* dhe b) *mbledhja 4 herë në vit e Komitetit Politik, i formuar nga drejtorët politikë të ministrive të punëve të jashtme*. Propozimi i kancelarit gjerman Villy Brandt, për të krijuar një strukturë të posaçme brenda sistemit komunitar, qoftë edhe në formën e **Sekretariatit Politik**, nuk gjeti përkrahjen e vendeve anëtare, duke dëshmuar parapëlqimin e dukshëm ndaj bashkëpunimit ndërqeveritar në këtë fushë. Informimi i Komisionit dhe Parlamentit European për çështje të caktuara të politikës së jashtme, nuk arrinte të kapërcente paragjykimin për politikën e jashtme më së shumti si “privilegj” i kancelarive të vendeve anëtare.

Ndërkohë vetëm 2 vjet më vonë, Deklarata e Samitit të Parisit 19-20 tetor 1972 përveçse deklaroi vullnetin e vendeve anëtare për të organizuar bashkëpunimin në fushën e politikës së jashtme, përmendte qartazi dëshirën për të ndërtuar një vizion të ri në *“një bashkim evropian”*. Ridalja në skenë e idesë për një bashkim politik european, ku natyrisht politika e jashtme e përbashkët do të ishte një element i qenësishëm, përbënte një sfidë jo të lehtë në sfondin e përplasjeve të Luftës së Ftohtë. Në këtë mënyrë çdo përpjekje e Komunitetit European, për të

krijuar një identitet në fushën e politikës së jashtme apo edhe të mbrojtjes, ishte e detyruar të përthyente rrezatimin transatlantik, ku qëndrimet me SHBA shpesh kishin dallime. Propozimi i Henri Kisingerit më 23 prill 1973 për të hartuar një “Kartë të re Atlantike”, me synimin për të “rigjallëruar partneritetin atlantik”, u prit me ndjenjë të përzier nga tashmë 9 vendet anëtare të Komunitetit Europian. Rëndësia që merrte politika e jashtme për Komunitetin, në kohën e konfliktit në Lindjen e Mesme apo Vietnam, u pasqyrua edhe në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të tij 31 korrik 1973, ku u pranua që për çështjet e politikës së jashtme çdo shtet angazhohej si rregull i përgjithshëm, të mos fiksonte përfundimisht qëndrimin e vet, pa u konsultuar me partnerët e tij. Ndërkohë në përgjigje të propozimit të Kisingerit, në dhjetor 1973 gjatë Samitit të Kopenhagenit, liderët e 9 vendeve anëtare të Komunitetit Europian miratuan një dokument të përbashkët mbi “*identitetin europian*”. Përveçse shprehte vullnetin europian për t’u bashkuar në mbrojtje të qytetërimit të përbashkët, ai dokument nënvizonte dëshirën e tyre për të qenë aktiv në çështjet botërore. Deklarata përpigjej të theksonte këtë vullnet me anë të përcaktimit të qëndrimeve të përbashkëta në fushën e politikës së jashtme.

Por mekanizmi që kishin në zotërim në atë periudhë, vendet e Komunitetit Europian, ishte vetëm Bashkëpunimi Politik Europian (EPC-Europen Political Cooperation). Procedurat për realizimin e tij ishin përcaktuar në Raportin e Luksemburgut të 1970 dhe Raportin e Kopenhagenit të 1973, të cilat identifikuan 4 nivele të kryerjes së procesit 1) *takimin e kryetarëve të shtetit dhe të qeverive* (i institucionalizuar më vonë si Këshilli Europian) që ofronte direktiva të përgjithshme 2) *takimin periodik të ministrave të punëve të jashtëm në EPC* (si e kundërta me të njëjtin takim të tyre në nivel të Këshillit të Ministrave, por që u konsiderua një ndarje artificiale dhe u hoq më vonë) i cili përgatiste samitet që merreshin me çështje të politikës së jashtme 3) *takimet e Komitetit Politik* (drejtorët politikë të MPJ), të cilët nga ana e tyre përgatishnin mbledhjet e ministrave të punëve të jashtëm 4) *takimet e Grupeve të Punës* (zyrtarë të nivelit të mesëm të ministrive të punëve të jashtme)

që shkëmbejnë pikëpamje e përgatisnin raporte për çështje të ndryshme mes të cilëve edhe *grupi i korrespondentëve Europianë* (zyrtarë të rinj të MJ) të cilët ishin në rolin e ndërlidhësit me ministritë e punëve të jashtme dhe përgatisnin takimet për Komitetin Politik.

Si një dëshmi tjetër e thellimit dhe bashkëpunimit në këtë fushë, ministritë e punëve të jashtme të vendeve anëtare të BE-së krijuan COREU, një sistem komunikimi i siguar, i hartuar posaçërisht për të realizuar procesin e Bashkëpunimit Politik Europian. Në vijim të kësaj strukture, Presidenca e Këshillit të BE-së vazhdoi të realizonte takimet e EPC në të gjitha nivelet. Në mungesë të votimit për çështjet e Bashkëpunimit Politik Europian (EPC) u zbatuan negociatat në kërkim të konsensusit, të cilat rrisnin në mënyrë të vazhdueshme presionin për ta arritur atë. Në këtë mënyrë konsensusi u bë një nga rregullat themelore të procedurës së Bashkëpunimit Politik Europian EPC, i cili pa dyshim e vështirësonte në mënyrë të dukshme aspektin vendimmarrës dhe efektivitetin e saj. Ashtu si edhe në fushat e tjera të politikave të BE-së, asnjë prej shteteve anëtare nuk dëshironte të mbetej i izoluar në rast të një mendimi të përbashkët, për të cilin ishin dakord shumica e vendeve pjesëmarrëse, ç'ka deri diku krijoi një tendencë për të ndjekur opinionin e shprehur nga shumica. Megjithatë ndërlidhja jozyrtare mes Bashkëpunimit Politik Europian /EPC e fushave të tjera të politikës së BE-së pati përjashtimet e saj, ashtu si në vitet '80 kur qeveria socialiste greke krijoi një sërë problemesh për arritjen e konsensusit për çështjet e politikës së jashtme të BE-së, në këmbim të përfitimit ndaj politikave të tjera komunitare.

Identiteti ndërkombëtar i vendeve të Komunitetit e nxitja e procesit të Bashkëpunimit Politik Europian mori një përmasë të dukshme gjatë Konferencës mbi Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (KSBE), e cila filloi në fillim të viteve '70 dhe arriti kulmin në 1 gusht 1975 në të ashtuquajturin *Akt Final të Helsinkit*. Shtetet anëtare të KE-së dëshmuuan që në fazën fillestare të tij se do të vepronin si një grup dhe do t'i bindeshin kolektivisht angazhimeve të KSBE-

së. Gjatë negociatave për “Shportën II” (bashkëpunimin ekonomik) dhe “Shportën III” (të drejtat e njeriut) që ishin përfshirë në axhendën e KSBE-së, ata dhanë një kontribut të ndjeshëm. Megjithëse nuk kishte një delegacion të KE-së në KSBE-në dhe vetë komuniteti nuk bëri propozime, zyrtarët e Komisionit që iu bashkëngjitën delegacionit kombëtar të Presidencës së atëhershme të Këshillit të KE-së, u përfshinë në mënyrë aktive në të gjitha negociatat.

Në vijim të propozimeve të Samitit të Parisit 1972 për Bashkimin European, në Samitin e Parisit të 9 dhjetorit 1974, vendet anëtare kishin marrë vendim për të ngritur një komision të kryesuar nga Kryeministri i Belgjikës Leo Tindermans, për të paraqitur propozimet e tij në lidhje me krijimin e një Bashkimi Politik, ku elementi i një politike të jashtme do të ishte pjesë shumë e rëndësishme e tij. Në bazë të rekomandimeve të përfshira në Raportin Tindermans, të paraqitur më 29 dhjetor 1975 në mbledhjen e radhës së Këshillit të Ministrave, u propozua që angazhimi politik që ekzistonte deri atëherë, për sa i përket konsultimit për marrjen e një vendimi në raport me interesat kombëtare në fushën e politikës së jashtme, të kthehej në detyrim juridik duke miratuar njëkohësisht *parimin e shumicës për vendimeve të përbashkëta*. Por këto sugjerime nuk u pranuan pasi shtetet e mëdha donin të ruanin lirinë e veprimit të tyre në politikën e jashtme. Pavarësisht kësaj shtete të “ngrirë” në krijimin e një politike të jashtme të përbashkët nga ana e Komunitetit European, rrjedha e ngjarjeve në gjysmën e parë të viteve ’70, ku spikat lufta në Lindjen e Mesme dhe dialogu Euro-Arab, ushtruan një ndikim jo të vogël mbi Bashkëpunimin Politik European-EPC. Si dëshmi e kësaj sjelljeje në fushën e politikës së jashtme të KE-së mund të përmendet Deklarata e Samitit të Venecias në qershor 1980, në të cilën shtetet anëtare publikisht njohën pozicionin e veçantë të Palestinës në konfliktin arabo-izraelit, duke treguar se sa ngushtësisht mund t’i koordinonin politikat e tyre në Lindjen e Mesme dhe se sa të ndryshme mund të ishin pozicionet e tyre edhe në raport me SHBA-në. Megjithatë ishte ende herët për të folur për një politikë të jashtme të komunitetit në këtë periudhë.

Veçanërisht në fillim të viteve '80 marrëdhëniet me jashtë të KE-së ishin problematike, ndërkohë që zhvillimet e brendshme dhe kufizimet procedurale të Bashkëpunimit Politik Europian, EPC u bënë të dukshme. Rishfaqja e tensionit lindje-perëndim në gjysmën e dytë të viteve '70 pas një periudhe qetësie, e cila u quajt edhe "Lufta II e Ftohtë", vuri në provë aftësinë e komunitetit për të vepruar në arenën ndërkombëtare si një faktor me peshë. Pushtimi sovjetik i Afganistanit në dhjetor 1979 tregoi ndërmjet të tjerave se Bashkëpunimi Politik Europian (EPC-European Political Cooperation) ishte një mekanizëm i papërshtatshëm në raport me qëndrimet e shpejta e të koordinuara në politikën e jashtme. Deri në mars 1982, BE nuk arriti të binte dakord për vendosjen e sanksioneve ndaj BS, pas pushtimit të Afganistanit, duke treguar se bashkëpunimi e koordinimi për çështje që prekin qëndrime të përbashkëta në fushën e politikës së jashtme, mbeteshin peng i paragjykimeve e interesave të shteteve anëtare të komunitetit. Rrjedha e ngjarjeve në Poloni me vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme në 1981, tregoi se shtetet anëtare u treguan më të gatshme për të koordinuar përgjigjet e tyre ndaj këtij zhvillimi të ri politik në Europën Lindore.

Ndërkaq në vitet '80, në dy prej vendeve kryesore të Europës siç ishin Franca e Gjermania, ardhja në pushtet e dy prej figurave kryesore politike si Fransua Miteran e Helmut Kohl, do të mundësonte një qasje të re e vizion më përshpejtues drejt një bashkimi politik, ku pa dyshim do të përfshihej edhe një politikë e jashtme europiane më e qenësishme. Fillimi i një zgjerimi tjetër, tashmë në jug të Europës, e bënte akoma më të rëndësishëm projektin për një Komunitet me identitet të lexueshëm edhe në politikën e jashtme. Propozimet e ish-kryeministrit të Luksemburgut Gaston Torn në qershor 1981, në rolin e Kryetarit të Komisionit Europian, evidentonin qartë dëshirën për t'iu rikthyer një projekti tjetër për Europën, të ngjashëm me periudhën kur u krijua Komuniteti Ekonomik. Keqësimi i marrëdhënieve lindje-perëndim dhe përgjigjja e ngadaltë e një numri shtetesh anëtare të KE-së në vitet'80 çuan në një numër iniciativash për të përmirësuar EPC si dhe

zgjeruan axhendën e sigurisë e mbrojtjes. Por reformat e vogla procedurale, që u paraqitën nga Raporti i Londrës, gjatë Samitit të KE-së të zhvilluar në kryeqytetin britanik në Londër në qershor 1981, nuk arritën të sillnin ndonjë ndryshim domethënës e diskutimet mbi çështjet e politikës së jashtme të sigurisë vazhduan të kufizohen brenda procesit të Bashkëpunimit Politik European (EPC). Në tetor 1981 u bë një përpjekje tjetër për të aktivizuar mekanizma të rregullta konsultuese, përpara se të ndërmerreshin nisma kombëtare për çështje të rëndësishme të politikës së jashtme, të cilat preknin të gjithë vendet anëtare. Pakti Gensher-Kolombo i nënshkruar mes ministrit të punëve të jashtme të Gjermanisë Hans Ditrh Gensher e ministrit të punëve të jashtme të Italisë Emilio Kolombo në nëntor 1981, dëshmoi mes të tjerave jo vetëm vullnetin për të nënshkruar një “Akt European”, por edhe dëshirën për të përsosur mekanizmat institucionalë në atë periudhë, të cilat mundësonin realizimin e një politike të jashtme të përbashkët mes 10 anëtareve të Komunitetit European. Ndërkohë kundërshtia britanike ndaj këtij propozimi përkonte edhe me ardhjen në pushtet të ish-Kryeministres Margaret Theçer, e cila do të përcillte në vitet në vazhdim “sindromën britanike” për të mos kapërcyer vullnetin kombëtar të shteteve për sa i përket çështjeve që lidheshin me politikën e jashtme. Në këtë mënyrë edhe Samiti i Shtutgartit i mbledhur më 19 qershor 1983, me Deklaratën e Shtutgartit apo (Deklarata Solemne mbi BE) pasqyroi më së miri përplasjet brenda anëtareve të Komunitetit e hartimin e një “deklarate kompromisi” që nuk thellonte më tej bashkimin politik të Komunitetit siç parashikonte Pakti Gensher-Kolombo. Në fushën e politikës së jashtme ajo parashikonte thjesht një thellim të konsultimeve me synimin për të bërë të mundur veprime të përbashkëta në lidhje me çështjet më të rëndësishme që paraqisnin një interes për të 10 vendet së bashku. Kundërshtitë ndaj kësaj deklarate edhe nga vende të tilla si Greqia apo Danimarka veçse thelluan më tej europesimizmin dhe dobësuan shpresat për një identitet sa më të qartë të Europës në fushën e politikës së jashtme.

Këtij vizioni për një politikë të jashtme nuk mundi t'i shpëtonte as edhe Projekt-Traktati për Bashkimin European, i paraqitur nga federalisti i njohur Altiero Spinali më 14 shkurt 1984 në Parlamentin European. Megjithëse ky projekt-traktat parashikonte unifikimin e 3 komuniteteve të deriatëhershme (ECSC, EEC dhe Euroatomi) në një të vetëm, për sa i përket politikës së jashtme të mbrojtjes ai nuk ofronte më shumë sesa bashkëpunim, por jo veprim të përbashkët të paktën për një fazë fillestare.

Në këtë periudhë së gjysmës parë të viteve '80, konceptet e Miteranit për një "Europë me shumë shpejtësi apo memorandum i Margaret Theçer në 1984 mbi të "Ardhmen e Europës", ishin më së shumti pririje për të dalë nga ngërçi i mungesës së një politike të jashtme europiane, por mënyrat se si kjo do të realizohej e rikthente debatin te frikat e hershme të "humbjes së sovranitetit mbi interesat kombëtare". Për sa kohë vetëm një pjesë e integritimit ekonomik ishte kthyer në gështje me interes komunitar, politika e jashtme vazhdonte të ishte e "ngrirë në frigoriferin e bashkëpunimit ndërqeveritar", ku përplaseshin herë pas herë rrymat e ftohta të interesave kombëtare të vendeve anëtare.

Gjatë presidencës franceze në 6-mujorin e parë të vitit 1984, përpjekja për të risjellë në tavolinë një reformë që do të prekte edhe bashkëpunimin politik e politikën e jashtme, u rishfaq sërish me ngritjen e Komisionit Dag në Samitin e Fonteblosë në Qershor 1984. Ish-ministri i punëve të jashtme të Irlandës Xhejms Dag shpresonte që në krye të këtij komisioni, i cili të kujtonte Komisionin Spaak, që solli Traktatin e Romës më 1955, të përcillte një platformë të qartë për ta shtyrë më tej procesin e ngecur të bashkimit politik mes vendeve të KE-së. Paraqitja e këtij raporti në Samitin European të Luksemburgut në dhjetor të 1984 mes të tjerave parashikonte edhe kërkimin e një identiteti european përmes një politike të jashtme të përbashkët. Logjika funksionaliste e këtij raporti përkundër asaj federaliste të Spinalit nuk e pengoi megjithatë reagimin kundër të Britanisë, Greqisë e Danimarkës.

Ndërkohë botimi i "Librit të Bardhë" më 1 janar 1985 nga Zhak Delor e Lordi Cokfield për krijimin e Tregut të

Përbashkët European deri më 1992, i dha shtysë propozimit franko-gjerman në Bon për “Krijimin e Bashkimit European”. Me këtë rast Miteran e Kohl paraqitën “Projekt-Traktatin për Bashkimin European” që do të diskutohej në Samitin e Milanos nën presidencën italiane. Meqenëse ata ishin të bindur se reforma e mekanizmit institucional të Komunitetit të atëhershëm do të ngjallte sërish debate, ata propozuan forcimin e bashkëpunimit politik përmes krijimit të *Sekretariatit të Përgjithshëm*.

Samiti i Milanos që u mbaj në 28-29 qershor 1985 nuk shënoi ndonjë hap të rëndësishëm e nuk arriti të pajtonte vizionet e kundërta franko-gjermane e britanike për thellimin e bashkëpunimit politik e të një politike të jashtme të përbashkët. Vendimi për të organizuar një Konferencë Ndërkombëtare Qeveritare (IGC) me mandat që të përgatiste një Projekt-Traktat “Për një politikë të jashtme dhe për një politikë sigurimi të përbashkët mbi bazën e projekteve franko-gjermane e britanike” hasi sërish në kundërshtimin e Britanisë, Greqisë e Danimarkës.

Konferenca ndërqeveritare në Luksemburg më 9 shtator 1985 dhe Samiti European i Luksemburgut më 2-3 dhjetor 1985, vërtetuan sërish paaftësinë për të arritur në një projekt bashkimi politik. Akti i vetëm european (SEA) i miratuar në Samitin e Luksemburgut dhe i nënshkruar më 17 shkurt e 28 shkurt 1986 nga vendet anëtare ishte një tjetër “kompromis i vështirë” ku më së shumti u sendërtua vizioni i Zhak Delorit për bashkimin ekonomik. Në rolin e Kryetarit të Komisionit European, Zhak Delori zgjidhi një përqsasje jo Spineliane, por Moneane (metoda komunitare e integritetit sektorial), hap pas hapi, që ndërthurej me bashkëpunimin ndërqeveritar. Ajo ishte funksionaliste e kushtëzonte reformat institucionale me përcaktimin e objektivave të reja të komunitetit. Ndër 3 fushat e veprimit që ai përfshinte ishte edhe koordinimi në politikën e jashtme.

Veçanërisht pjesa e dytë e Aktit të Vetëm European (SEA-Single European Act) i kushtoj bashkëpunimit në sferën e politikës së jashtme. Objektivi i përcaktuar në traktat ishte *“formulimi dhe vënja në jetë së bashku e një politike të jashtme*

europiane”. Për t’ia arritur këtij qëllimi shtetet anëtare angazhoheshin të informonin e të konsultoheshin për të gjitha çështjet e politikës së jashtme, që kishin karakter të përgjithshëm. Në këtë mënyrë ato mund të arrinin të ushtronin së bashku në mënyrë efikase, të gjithë ndikimin e tyre në realizimin e veprimeve të përbashkëta. Por traktati nuk i detyronte shtetet anëtare të arrinin një qëllim të përbashkët, pasi çdo shtet mbetej sovran në përcaktimin e pozicioneve të tij në nivel kombëtar. Megjithatë ishte vendosur një klauzolë, në bazë të së cilës, çdo shtet anëtar duhej të merrte plotësisht në konsideratë pozicionet e partnerëve të tjerë dhe interesin që përfaqësonte miratimi e vënia në jetë e qëndrimeve të përbashkëta europiane. Si rregull marrja e vendimeve për politikën e jashtme bëhej përsëri me unanimitet, ndonëse në SEA përmendej angazhimi i shteteve për të abstenuar, në një masë të mundshme, për të mos penguar arritjen e një konsensusi dhe realizimin e veprimit të përbashkët. Por ai ishte më së shumti një angazhim moral e pa detyrime juridike. Ndërkohë Akti i Vetëm European (SEA) nuk krijoi një strukturë të posaçme të bashkëpunimit në politikën e jashtme të Komunitetit European. Çështjet e politikës së jashtme do të vazhdon të trajtoheshin në mbledhjet e niveleve të ndryshme të përfaqësuesve politikë e administrativë të shteteve anëtare siç ishin: a) *Këshilli European (Samiti European)*, b) *Këshilli i Ministrave të Punëve të Jashtme (GFA)*, c) *Komiteti Politik i Drejtorëve Politik të Ministrive të Punëve të Jashtme*, etj. Për të pasur një koherencë mes të gjitha institucioneve të Komunitetit u përcaktuan edhe dy praktika të tjera siç ishte: a) bashkëngjitja e Komisionit në të gjitha nivelet e bashkëpunimit politik dhe b) dhënia e kompetencave vendit anëtar, që drejtonte presidencën 6-mujore të Këshillit, për të koordinuar e përfaqësuar shtetet anëtare, në raport me vendet e treta, në të gjitha aktivitetet më të rëndësishme të Bashkëpunimit Politik European (EPC). Nga pikëpamja strukturore, e vetmja gjë e re që solli Akti i Vetëm European, ishte krijimi i një Sekretariati të vogël prej 5 vetësh në Bruksel, që do t’i vinte në ndihmë presidencës së Këshillit në planin administrativ, ç’ka përbënte një zgjidhje me karakter minimalit, në raport me kërkesën e

hershme për krijimin e një sekretariati me funksione të gjera koordinuese.

Gjithsesi, pavarësisht ndryshimeve të mësipërme, procesi i Bashkëpunimit Politik Europian (EPC) mbeti një fushë ndërqeveritare - në fakt një shtyllë e ndarë nga Komuniteti - duke mos qenë në këtë mënyrë as subjekt gjykimi juridik nga Gjykata Europiane e Drejtësisë. Pra politika e jashtme brenda Komunitetit Europian vazhdoi të mbesë një fushë ku nuk zbatoheshin procedurat komunitare të vendimmarrjes, por unanimiteti dhe arritja e konsensusit.

III. Periudha pas viteve '90:

CFSP (Politika e Jashtme e Përbashkët dhe e Sigurisë) mes dilemave të ndryshimit

Në gjysmën e dytë të viteve '80, vendet anëtare të Komunitetit Europian filluan të përballen me ndryshimin më të rëndësishëm politik në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, siç ishte procesi i përmbysjes së regjimeve komuniste në Europën Qendrore e Lindore. Ato u pasuan nga një seri ngjarjesh, që vunë në provë brishtësinë dhe joefektivitetin e Bashkëpunimit Politik Europian (EPC) si instrument i realizimit të politikës së jashtme të Komunitetit. Rënia e Murit të Berlinit më 9 nëntor 1989 përshtjelloi së tepërmi të gjithë këto vende dhe i vuri përpara sfidës për të përcaktuar rolin dhe peshën e tyre në rendin e ri ndërkombëtar që po krijohej. Plani për Ribashkimin e Dy Gjermanive, i shpallur nga Kancelari Kohl më 28 nëntor 1989 risolli në skenë “Çështjen gjermane”, duke ringjallur dyshime e frikë për këtë ekuilibër të ri forcash brenda komunitetit. Njëkohësisht lidershipi i Komisionit Europian me anë të ndihmës ndërkombëtare në rajon, ndihmoi të ngushtoheshin dyshimet ndërmjet politikës së jashtme e marrëdhënieve ekonomike me jashtë të BE-së. Në qershor 1989 Presidenca e Këshillit, Komisioni dhe Sekretarit për Punët e Jashtme të Këshillit Europian përgatitën një Dokument të Përbashkët mbi Europën Lindore e Qendrore, duke vendosur një precedent të

rëndësishëm në politikëbërjen e përbashkët EC-EPC. Pas kësaj terminologjia *“Komuniteti dhe shtetet e tij anëtare”* u bënë përdorim standard në dokumentet e EPC. Vendimi i Samitit G7 në korrik 1989 që Komisioni Europian të koordinonte ndihmën për Poloninë e Hungarinë nëpërmjet programit PHARE, ishte një tregues për një rol të ri që po përpiqej të merrte përsipër Komuniteti në zhvillimet ndërkombëtare.

Në këto kushte, ideja për të përshpejtuar procesin e Bashkimit Politik të Komunitetit dhe përcaktimi i një identiteti të qartë në politikën e jashtme, u shndërruan në një prioritet të rëndësishëm. Më 20 mars 1990, qeveria belge ndërmoi një iniciativë me projekt-propozime konkrete, drejt një bashkimi ekonomik e monetar, ku përfshiheshin edhe reformimi i institucioneve për sa i përket zhvillimit e bashkëpunimit në fushën e politikës së jashtme. Përpara Samitit të Dublinit, i cili u zhvillua më 28 prill 1990, mesazhi i përbashkët Kohl-Miteran forcoi më tej nevojën për një bashkim të tillë, teksa propozonin një IGC (Konferencë Ndër-Qeveritare) për Bashkimin Politik me disa objektiva ku veçohej edhe *“përcaktimi e vënia në jetë e një politike të jashtme e sigurie të përbashkët”*. Në prag të ribashkimit të dy Gjermanive, rikthimi i boshtit franko-gjerman si përshpejtues i bashkimit politik, kishte domethënie tepër të rëndësishme. Samiti i Dublinit përveçse nxiti një proces më të afërt përafrimi me ish-vendet e Europës Qendrore e Lindore nëpërmjet Marrëveshjeve Europiane (Marrëveshje Asociimi), në lidhje me propozimin franko-gjerman për bashkimin politik, u ndesh me kundërshtimin britanik të shprehur nga ish-Kryeministrja Theçer. Frika e hershme britanike ndaj kufizimeve të vendeve anëtare për të vendosur mbi politikën e jashtme e dobësimi i përmasës transatlantike të NATO-s, me përcaktimin e *“konceptit europian të sigurisë”*, gjeti jehonë edhe në vendet e tjera anëtare. Trajtimi i bashkimit të Gjermanive si “rast i veçantë” nga Deklarata e Samitit, (në bazë të një propozimi të Zhak Delorit) shprehte njëherazi pasigurinë e Komunitetit ndaj sfidave të tilla, të cilat nuk do të vonin të vinin sërish në provë aftësinë e tij për qëndrime e vendime të përbashkëta në fushën e politikës së jashtme. Në mungesë të konsensusit të

përgjithshëm mbi propozimet belge e franko-gjermane, Samiti vendosi që ngarkojë ministrat e punëve të jashtme të vendeve anëtare të përpunonin më tej këto qëndrime, e t'i paraqitnin në mbledhjen e radhës së Këshillit Europian.

Me gjithë kundërshtimin sërish të ish-Kryeministres Theçer mbi këto propozime, Samiti Europian i Dublinit, i mbledhur në qershor 1990, vendosi të thërriste një IGC më 14 dhjetor 1990, e cila do të hidhte bazat për një Bashkim Politik të Komunitetit. Ndërkohë përpjekjet për të garantuar një barazvlefshmëri mes saj dhe përpjekjeve për Bashkimin Ekonomik e Monetar, do të ishin pjesë e negociatave të vazhdueshme mes shteteve anëtare. Gjatë kësaj periudhe çështja e bashkimit gjerman iu rikthye formulave tradicionale të diplomacisë. Formula e Konferencës 2+4 e miratuar në 14 korrik 1990 mes Gorbaçovit e Kohlit nxori në pah konceptin tradicional të “fuqive të mëdha” në vendimmarrjet e rëndësishme, por në të cilën komuniteti europian ishte i përfaqësuar si aktor, por përmes shteteve të veçanta (Francë, Angli). Traktati për Bashkimin e Dy Gjermanive i cili erdhi si rezultat i dy Sesioneve të Moskës e Otavës më 17 korrik e 12 shtator 1990 të Konferencës 2+4, dëshmoi se roli i komunitetit evropian, në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare ishte më së shumti vëzhgues e miratues i vendimeve që pasqyronin forcën e peshën e shteteve të veçanta.

Samiti jo-zyrtar i Romës i cili mbledh më 28-29 tetor 1990, pak ditë pasi ishte ratifikuar Traktati për Ribashkimin e Dy Gjermanive më 3 Tetor 1990, nuk arriti të sillte ndonjë ndryshim domethënës, për sa i përket projekt-propozimeve të IGC-së për një Bashkim Politik të KE-së, ku politika e jashtme e përbashkët dhe e sigurisë merrte një peshë të veçantë. Në vijim të kundërshtimeve të saj të hershme ndaj këtyre propozimeve me karakter të theksuar “federalist” e “mbikombëtar”, kryeministrja britanike Theçer vazhdoi të qëndronte e palëkundur në qëndrimet e saj.

Gjatë muajit nëntor 1990 pasuan dy aktivitete të tjera të rëndësishme që nxorën në pah më tej rëndësinë dhe përsheptimin e përpjekjeve për krijimin e një profili të qartë të komunitetit në çështjet e politikës së jashtme, veçanërisht

në kushtet e pas-Luftës së Ftohtë. Miratimi i Kartës për një Europë të Re (Karta e Parisit) nga takimi i kryetarëve të shteteve e qeverive të KSBE-së (Këshillit për Siguri e Bashkëpunim European), përcaktoi bazat mbi të cilat do të ndërtoheshin këtej e tutje marrëdhëniet mes vendeve europiane. Identifikimi i vlerave të përbashkëta si liria, demokracia, mospërdorimi i forcës dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në rrugë paqësore, përcaktonin më së mirë identitetin e vlerave europiane si kusht për përparimin ekonomik. Ndërkohë Samiti i NATO-s në Romë në të njëjtën periudhë, ridimensionoi konceptin e saj strategjik të veprimit, pas shpërbërjes së ish-bllokut komunist si dhe vullnetit të vendeve të Europës Qendrore për t'u përfshirë në këtë organizatë të sigurisë dhe mbrojtjes kolektive.

Jehona e këtyre ngjarjeve dhe rifitimi i zgjedhjeve në Gjermani më 2 dhjetor 1990 nga kancelari Kohl me sloganin *“Gjermania është atdheu ynë, e Europa e ardhmja jonë”*, e riktheu sërish në qendër të vëmendjes idenë e Bashkimit Politik European ku propozimi i përbashkët Miteran-Kohl më 6 dhjetor 1990 përforcoi idenë për një politikë të jashtme të përbashkët e të sigurisë si dhe mekanizmat institucionalë për ta vënë atë në lëvizje.

Në Samitin European të Romës më 14-15 dhjetor 1990, propozimi Miteran-Kohl, përveç disa kundërshtive, u përkrah nga vendet anëtare, të cilat vendosën që të dy IGC-të (për Bashkimin Politik e të Ekonomik e Monetar) të vazhdonin punën paralelisht dhe traktatet e ratifikimi i tyre të bëhej para vitit 1992.

Gjatë presidencës holandeze në vitin 1991 u bënë sërish përpjekje për përafrimin e qëndrimeve. Gjatë Samitit European të 9-10 dhjetorit 1991 në Mاستriht, liderët e vendeve anëtare, pasi ranë dakord që të gjitha të përmblihdeshin në një Traktat të vetëm, vendosën që ai të nënshkruhet prej ministrave të punëve të jashtme të 12 vendeve anëtare më 7 shkurt 1992 në Mاستriht. Traktati i Mاستrihtit (apo Traktati i Bashkimit European-BE) përcaktoi një strukturë 3-kolonëshe, ku mes të tjerave ishte përfshirë edhe Politika e Jashtme e Përbashkët dhe e Sigurisë apo siç do njihej më pas në terminologjinë

europiane CFSP (Common Foreign Security Policy). Kjo lloj strukture pasqyronte sërish prirjen mbizotëruese të koncepteve me natyrë konfederale e ndërqeveritare në strukturën e ardhshme institucionale të BE-së.

Traktati i Mاستrihtit i 7 Shkurtit 1992, i cili përkoj edhe me një sërë ndryshimesh politike në Europë, ku spikaste ngjizja e krizës jugosllave, mes të tjerave u përpoq të evidentonte edhe domosdoshmërinë e nevojën e shteteve anëtare për të reformuar procesin e Bashkëpunimit Politik European (EPC). Nëpërmjet shndërrimit të EPC në një CFSP (Politikë e Jashtme e Përbashkët dhe e Sigurisë), shtetet anëtare e Komisioni shpresonin të forconin sigurinë e BE si dhe të rritnin rolin dhe peshën e BE-së si aktor në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ndërkohë me anë të këtij instrumenti të ri, ata synonin një lidhje të ndërvarur mes politikës së jashtme ekonomike të BE-së dhe vetë politikës së jashtme si mekanizëm ndikimi e kushtëzimi. Në këtë mënyrë nga vendet anëtare i kërkohej komisionit dhe këshillit, të gjenin një lidhje të qëndrueshme mes kolonës së EC-së (Komunitetit Ekonomik), pjesë e politikës komunitare, e CFSP që përbënte ende një element ndërqeveritar nga pikëpamja e hartimit dhe realizimit në praktik. Ndërkohë dispozitat e Traktatit të Mاستrihtit, në lidhje me Politikën e Jashtme të Përbashkët e të Sigurisë (CFSP), përfshinë edhe një seri nenesh të reja, ku më së pari përcaktoheshin objektivat e kësaj politike si: a) *ruajtja e vlerave të përbashkëta, interesat themelore e pavarësia e BE*, b) *forcimi i sigurisë së BE-së dhe anëtarëve të saj në të gjitha mënyrat* c) *ruajtja e paqes e forcimi i sigurisë kombëtare në përputhje me parimet e Kartës së OKB-së e KSBE-së*, d) *nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar*, e) *zhvillimi e konsolidimi i demokracisë, sundimi i ligjit e respekti për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore*.

Për këtë arsye Traktati i Mاستrihtit futi edhe instrumente të rinj për zbatimin e CFSP-së që ishin: a) pozicioni i përbashkët (common position), i cili ndihmonte në krijimin e bashkëpunimit sistematik mes vendeve anëtare në politikën e jashtme në bazë të shkëmbimit të përditshëm të informacionit dhe b) veprimin e përbashkët (joint action), i cili do të lejonte

shtetet anëtare të vepronin së bashku në mënyrë konkrete, të mbështetur në vendimet e Këshillit Europian.

Për cilindo ishte mëse e qartë se suksesi i CFSP-së do të varej kryesisht nga mënyra se si do të miratoheshin këto instrumente. Disa prej shteteve anëtare mbronin idenë e përdorimit të Votimit me Shumicë të Cilësuar (QMV), ndërsa të tjerët përkrahnin parimin e unanimitetit në vendimmarrjet që lidheshin me zbatimin e Politikës së Jashtme të Përbashkët e të Sigurisë. Përballë këtyre kundërshtive Traktati arriti një kompromis që e vështirësonte sërish efektivitetin në të ardhmen për sa i përket zbatimit të kësaj politike. Në këtë mënyrë, në rastin e miratimit të *veprimeve të përbashkëta (joint actions)*, këshilli do të zbatonte parimin e unanimitetit në vendimmarrje ndërsa do të ndiqte parimin e shumicës së cilësuar kur të vendoste për zbatimin e këtyre veprimeve në fushën e politikës së jashtme e të sigurisë. Ndërkohë Traktati i Matrihtit vendosi të ruajë bashkëpunimin me Komisionin Europian në këtë drejtim, megjithëse ky i fundit ai nuk kishte të drejta të posaçme për të bërë propozime për çështje të caktuara. Për sa i përket Parlamentit Europian ai vazhdon të kishte një rol të dobët në këtë fushë të politikës e meqenëse CSFP konsiderohej një aspekt i bashkëpunimit ndërqeveritar, nga ku përjashtohej Gjykata e Drejtësisë, atëherë nuk kishte ndonjë mekanizëm detyrues nga shtetet anëtare me dispozitat e CFSP-së.

CFSP pati një fillim të dobët, ç'ka ishte edhe përshtypja e negociatorëve, të cilët vërejtën se dispozitat e CFSP-së në Traktatin e Matrihtit ishin të mangëta. Një pjesë e përkrahësve optimistë të këtij procesi shprehnin bindjen se CFSP do të merrte një karakter mbikombëtar në vitet në vazhdim. Vetë fillimi i zbatimit të CFSP-së u shty për shkak të krizës së ratifikimit të Traktatit të Matrihtit e në këtë mënyrë shtetet anëtare humbën disi nga koha e vlefshme për të vënë në praktikë instrumentet e kësaj politike të përbashkët. Ashtu siç përcaktohej edhe në dispozitat e Traktatit pranë Sekretariatit të Këshillit të Ministrave të BE-së do të ngrihej CFSP Unit (Njësia për Politikë të Jashtme të Përbashkët e Sigurisë). Për shkak të natyrës së Presidencës së Këshillit të Ministrave të

BE-së nga një vend anëtar dhe tendencës së këtyre shteteve për të vepruar vetëm për çështje me interes kombëtar, kjo strukturë do të ndeshte vështirësi jo të pakta. Në radhë të parë problemi themelor nuk ishte i karakterit administrativ, por kulturor. Për sa kohë zyrtarët e dërguar në këtë njësi, nga ministrinë e punëve të jashtme të shteteve anëtare, prireshin më shumë drejt qasjeve të ngushta kombëtar, përkundër zyrtarëve të përhershëm të Sekretariatit të Këshillit të Ministrave që kishin një pikëvështrim më gjithëpërfshirës komunitar për çështjet e politikës së jashtme. Në këtë mënyrë nevojiteshin të paktën 2 vjet që të krijohesh një CFSP Unit e re në sekretariatit të Këshillit, ku grupet e përziera të zyrtarëve të punonin në harmoni së bashku.

Në të njëjtën kohë paraqiten një sërë problemesh edhe për sa i përket presidencës së radhës së BE-së, e cila është e ngarkuar të koordinojë e të përfaqësojë institucionin, në të gjitha aktivitetet që i përkasin politikës së jashtme e të sigurisë. Për shkak të prioriteteve e interesave të ndryshme në nivel kombëtar, disa presidenca janë shfaqur më aktive e disa më të ngadalta në raport me CFSP-në. P. sh. presidenca greke në 1994 u dallua më së shumti për ndjekjen e ngushtë të qëllimeve të saj të politikës së jashtme sesa ato të BE-së (p. sh. refuzoi të njihte Republikën e Maqedonisë dhe i vendosi sanksione kësaj të fundit për të cilën u padit edhe nga Komisioni Europian në Gjykatën Europiane të Drejtësisë). Për shkak të afatit të shkurtër kohor të presidencave (6 muaj për secilin vend), kjo mungesë vazhdimësie në kohë, përbën një tjetër faktor, i cili ka ndikuar në një përfaqësim të dobët të BE-së në politikën e jashtme.

Një nga krizat me të afërta me të cilat u përball CFSP-ja ishte kriza jugosllave, e cila nxori në pah problemet procedurale të CFSP-së. Pas shpalljes së pavarësisë së Sllovenisë e Kroacisë, ata u sulmuan nga ish-ushtria jugosllave në qershor 1991 ndërsa në prill 1992, filluan luftimet mes grupeve etnike në Bosnjë. Më 11 qershor 1991 u zhvillua Samiti i Luksemburgut i BE-së dhe fjala e ish-ministrit të jashtëm luksemburgas Zhak Puse, “kjo është ora e Europës”, ngjallën shpresat për një rol të ri aktiv të BE-së si aktor në fushën e politikës së jashtme

dhe zgjidhjes së konflikteve. Por misioni i pamundur i trojkës së BE-së në Beograd, për të arritur një marrëveshje paqeje menjëherë porsa filloi konflikti, dëshmoi për pafuqinë e këtij institucioni në këtë fushë kaq të rëndësishme të ndikimit politik. Instrumentet e vlefshëm të BE në fillimet e saj në këtë fushë përmblihdeshin tek *arbitrimi, inspektimi, njohja apo mosnjohja diplomatike e palëve, sanksionet ekonomike dhe nxitja për pajtim*. BE nuk mund të vinte në veprim kërcënimin për zbatim force apo të ndërmerre veprime ushtarake, megjithëse shtete të veçanta anëtare të Bashkimit Europian Perëndimor (WEU) mund ta bënin këtë gjë. Por ndarja mes tyre ishte mjaft e thellë dhe sjellja e Greqisë me Maqedoninë, për të mos e njohur pavarësinë e saj vetëm për shkak të emrit, pasqyronte më së mirë mungesën e unitetit të qëndrueshëm mes BE-së për çështje të politikës së jashtme.

Ndërkohë lidhjet e veçanta me karakter historik të shteteve anëtare me ish-Republikat e Jugosllavisë (p. sh. ndikimi që pati njohja e njëanshme e pavarësisë së Kroacisë nga Gjermania) e shtynë BE-në të përcaktonte pas 10 orësh diskutimi, në dhjetor 1991, në Mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme, kriteret për njohjen e shteteve të reja në Jugosllavi e ish-BS, duke rënë dakord ta njohin Kroacinë në fillim të 1992. I ashtuquajtur i Komisioni i Arbitrazhit Badinter i krijuar me këtë rast, u zhvleftësua sërish nga ngutja e Gjermanisë për të njohur pavarësinë e Kroacisë në mënyrë të njëanshme në 1992. Në të njëjtën kohë përpjekjet për ndërmjetësim nga ana e BE-së, u zhvleftësuan nga serbët në terren, duke dëshmuar sërish pafuqinë e mekanizmave të zbatimit të Politikës së Jashtme të Përbashkët e të Sigurisë. Për këtë arsye konferenca e përbashkët mes OKB-së dhe BE-së në Londër në gusht 1992 dhe negociatat në Gjenevë, që prodhuan një plan paqeje për Bosnjën në 1993, përbënin pikën më të lartë të negociimit nga ana e BE-së. Mirëpo kundërshtimi i boshnjakëve ndaj këtij plani që shpërblente agresorët serbë e kundërshtimi kroat, tregoi më së miri dobësinë e ndjeshme europiane si një faktor me ndikimin në politikën ndërkombëtare. Në këtë mënyrë CFSP e BE u shndërrua vetëm në ndihmë humanitare si dhe në

dërgimin e trupave të disa vendeve anëtare në kuadër të OKB-së, për të mbrojtur të ashtuquajturat “zona të sigurta” në Bosnje.

Një tjetër argument që provonte dështimin e CFSP-së ishte edhe krijimi i Grupit të Kontaktit në prill 1994 si një mjet për të “administruar situatën në ish-Jugosllavi”. Në këtë grup ku merrnin pjesë Britania, Franca, Gjermania, SHBA e Rusi, e më vonë iu bashkëngjit edhe Italia, prania e vendeve kryesore të BE-së nuk tregonte për një sukses të CFSP, por për një rikthim të koncepti i “fuqive të mëdha”. Kjo shkaktoi zemërim të një sërë vendesh të tjera e veçanërisht Holanda që kishte trupa më shumë në terren në kuadër të OKB-së. Reagimi me anë të forcës ushtarake të NATO-s dhe SHBA në këtë krizë gjatë gusht 1995, u pasua me nënshkrimin e Marrëveshjes e Dajtonit në Paris në tetor 1995. Roli përcaktues i SHBA-së në zgjidhjen e kësaj krize e riktheu sërish në qendër të vëmendjes, efektivitetin e mekanizmave institucionalë për zbatimin e një Politike të Jashtme të Përbashkët të Sigurisë nga ana e BE-së.

Konflikti në Ballkan i mësoi BE-së kufizimet në politikën e saj të jashtme, të cilat e pengonin që të përfshihej në mënyrë aktive në zgjidhjen e konflikteve pas Luftës së Ftohtë. Angazhimi në mënyrë individuale i Gjermanisë, Francës e Anglisë kishte në themel arsye të ndryshme që nuk lidheshin drejtpërdrejt me zbatimin e një politike të përbashkët në këtë drejtim. Deklarata e Takimit të Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të BE-së në Luksemburg gjatë muajit korrik 1991 se “kjo është ora e Europës e jo e Amerikanëve”, përveçse ngjalli reagime në kongresin e SHBA-së, nuk arriti të vërtetonte dëshirën e BE-së për të ndarë sovranitetin kombëtar nga çështjet e politikës së jashtme e të sigurisë.

Gjatë kësaj periudhe, Këshilli European në Samitin e Lisbonës, që u zhvillua në qershor 1992, hartoi politikën e BE-së ndaj vendeve, grupvendeve apo zonave që shtriheshin brenda aspektit të sigurisë e që do të ishin subjekt i *veprimi të përbashkët (joint action)* në kuadër të CFSP. Mes të tjerave në të përfshihej procesi i OSBE-së mbi çarmatimin dhe kontrollin e armëve, së bashku me ndërtimin e masave të mirëbesimit, çështjet e mospërhapjes së armëve bërthamore, aspektet

ekonomike të sigurisë e në veçanti kontrolli e transferimi i teknologjisë ushtarake në vendet e treta si dhe kontrolli i eksportit të armëve. Ndërkohë kur vinte rasti për të miratuar mes tre instrumenteve të CFSP-së, që ishin *pozicioni apo veprimi i përbashkët (joint actions or common positions)* mes shteteve anëtare, Sekretariati i Këshillit të Ministrave e Komisionit Europian kishte paqartësi e mungesë vendosmërie për të zgjedhur njërin instrument apo tjetrin në një situatë të caktuar. Për sa i përket *pozicioneve të përbashkëta (common positions)* në politikën e jashtme, këshilli vendoste në bazë të rënies dakord paraprakisht mbi një çështje të caktuar, ndërsa *veprimet e përbashkëta (joint actions)* nënkuptonin angazhime konkrete apo ndërmarrjen e një iniciative të veçantë. Edhe të ashtuquajturat detyrat e Petersbergut, të miratuara në 1992 në Bon të Gjermanisë nga Këshilli i Bashkimit Europian Perëndimor (WEU) e që përcaktonin në planin e sigurisë natyrën e ndërhyrjes humanitare, paqeruajtëse e të administrimit të krizave nga BE, paraqitnin një politikë të jashtme “venusiane” siç ironizonte Robert Kagan.

Një ndër *veprimet e para të përbashkëta (joint actions)* të BE-së, si pjesë e instrumenteve të CFSP-së, ishte Pakti i Stabilitetit, i propozuar në 1993 nga kryeministri francez Eduard Balladur si mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes vendeve të Europës Qendrore e Lindore. Ndërkohë një tjetër *veprim i përbashkët (joint action)* u konsiderua në 1995 përfshirja e BE për rindërtimin dhe pajtimin e Mostarit, një qytet boshnjak i ndarë mes myslimanëve e kroatëve. Në vijim të detyrave të Petersbergut, në këtë rast për herë të parë iu bë thirrje Bashkimit Europian Perëndimor (WEU) të zbatonte një vendim të CFSP-së, megjithëse ishte i natyrës civile, duke ofruar një forcë të vogël policore. Pavarësisht këtyre veprimeve të përbashkëta të suksesshme (Mostari ishte i suksesshëm vetëm në aspektin e zbatimit të mekanizmave të CFSP-së, ndërsa vetë përfshirja e BE-së ishte një dështim) veprimet dhe pozicionet e tjera të përbashkëta të BE-së, për sa i përket kësaj fushe të politikës, nuk ishin aq mbresëlënëse. Problemi më së shumti ishte i karakterit politik e procedural. Megjithëse ekzistonte mundësia për të përdorur parimin e shumicës së

cilësuar (QMV) nga vendet anëtare, për të zbatuar *veprimet e përbashkëta (joint actions)*, të marrja e vendimeve të përbashkëta (*common decision*) vendet anëtare ngecnin përballë unanimitetit. Në këtë mënyrë, parimi i konsensusit që ekzistonte të mekanizmi i mëparshëm i Bashkëpunimit Politik Europian (EPC) vazhdon të mbisundojë edhe tek CFSP, duke e dëmtuar shumë vendimmarrjen në këtë drejtim e duke i trajtuar në mënyrë të vakët çështjet e politikës së jashtme në axhendën e BE-së.

Në Traktatin e Mاستrihit të 7 shkurtit 1992 ishte parashikuar që mbas 5 vjetësh CFSP (Politika e Jashtme e Përbashkët dhe e Sigurisë) e BE-së duhej të rishikohej përmes organizimit të një Konference Ndërqeveritare (IGC). Kjo konferencë, e planifikuar për vitet 1996-1997, në lidhje edhe me reformën e Traktatit të BE-së, dëshmoi mes të tjerave domosdoshmërinë për të kryer ndryshime të aspektit institucional të zbatimit të CFSP-së. Megjithëse kriza jugosllave kishte nxjerrë një sërë mësimesh të vlefshme për pafuqinë e kësaj politike të përbashkët që forconte identitetin e BE-së, sërish kishte kundërshtime mes vendeve anëtare për të ecur drejt përmirësimeve që preknin thelbin e saj. Megjithatë shtetet anëtare ranë dakord, që gjatë negociatave lidhur me CFSP, të trajtoheshin aspekte që lidheshin me *vendimmarrjen, përfaqësimin, planifikimin dhe analizën, buxhetin dhe marrëdhëniet mes BE-së e Bashkimit Europian Perëndimor (WEU)* i cili konsiderohej si një krah i armatosur krahas NATO-s. Ndonëse reformat e propozuara me këtë rast ishin larg së qenit ideale, për një ndryshim rrënjësor të aspektit të politikës së jashtme të BE, ato sërish ishin të vlefshme për të hedhur një hap më tej.

Me qëllim që të përmirësoheshin e të qartësoheshin me tej mjetet e duhura, të cilat realizonin me sukses zbatimin e CFSP, Traktati i Amsterdimit i nënshkruar më 2 tetor 1997 identifikoi 4 instrumente të tillë: a) *Parimet dhe udhëzimet (Principles and guidelines)* (të miratuara nga Këshilli Europian), të cilat japin drejtimin e përgjithshëm politik, b) *Strategjitë e përbashkëta (common strategies)* (të miratuara nga Këshilli Europian) që ofronin një mbulesë nën të cilën Këshilli mund të miratonte

veprimet dhe pozicionet e përbashkëta (joint actions and common positions) përmes votimit me shumicë të cilësuar, përveçse në rastet kur në të përfshiheshin aspekte ushtarake apo të mbrojtjes. Strategjitë e përbashkëta duhet të vendosin “objektivat, kohëzgjatjen, dhe mjetet e duhura nga Bashkimi dhe Shtetet Anëtare” në fushat me interes të dyanshëm c) *Veprimet e përbashkëta (joint actions)* (të miratuara nga këshilli) përkufizoheshin si mjete për t’iu përgjigjur situatave të veçanta, të cilat kërkonin “veprim operacional”. Aty ishte përfshirë edhe një listë e rishikuar se çfarë përmbanin këto veprime si dhe faktin që Këshilli mund t’i kërkonte komisionit propozime që garantonin zbatimin e këtyre veprimeve, d) *Pozicionet e përbashkëta (common positions)* (të miratuar nga Këshilli) me anë të të cilave kërkohej “përkufizimi i qëndrimit të Bashkimit ndaj një çështjeje me karakter gjeografik apo tematik”.

Në fakt, veprimet dhe pozicionet e përbashkëta në këtë rast shndërroheshin në mjete për të zbatuar *strategjitë e përbashkëta* (common strategies), të cilat arkitektët e CFSP-së i këndvështruan si çelësin kyç të një Politike të Jashtme të Përbashkët e të Sigurisë.

Por ashtu si edhe në të shkuarën këto instrumente do të vareshin nga cilësia dhe kapaciteti i procesit vendimmarrës të BE-së. Siç ishte vërejtur edhe në rastet e mëparshme, pak prej shteteve anëtare ishin gati të hiqnin dorë nga unanimiteti në të gjitha fushat që përcaktonte CFSP-në. Megjithatë gjatë zhvillimit të IGC-së u rrit vetëdija mes shteteve anëtare që të përcaktonin më qartë se çfarë ofronte votimi me Shumicë të Cilësuar (QMV). Në këtë mënyrë ai mund të lejonte një grup të vendeve anëtare që të vepronin më vete për çështje të ndjeshme në fushën e politikës së jashtme, edhe nëse një pjesë e tyre nuk dëshironte. Për t’ia arritur kësaj Traktati i Amsterdimit futi edhe 2 formula të tjera vendimmarrje: a) *abstenimi konstruktiv*, sipas të cilës nëse një pjesë e shteteve anëtare nuk përbëjnë më shumë se 1/e peshës së votave në Këshill, ato mund të abstenojnë ndaj një vendimi që është marrë në mënyrë unanime nga shtetet e tjera anëtare dhe b) *bllokimi në rast nevoje* sipas të cilit nëse vendimet mund të merren nga votimi me shumicë të cilësuar (QMV), si p. sh.

miratimi i *veprimeve të përbashkëta (joint actions)*, një shtet anëtar mund të deklarojë kundërshtimin e tij për të votuar ndaj marrjes së këtij vendimi “për arsye të rëndësishme e të deklaruara të politikës kombëtare”. Në këtë rast Këshilli i Ministrave të BE me Votim të Shumicës së Cilësuar (QMV), ia dërgon çështjen për miratim Këshillit European (Samitit të liderëve e kryetarëve të shteteve të BE-së) i cili në këmbim duhet ta votojë atë në mënyrë unanime. Nëse kjo ndodh, atëherë edhe Këshilli European do ta ketë të vështirë të marrë një vendim unanim, pasi kundërshtimi ka ardhur nga një vend anëtar që është gjithashtu pjesë e këtij organi vendimmarrës.

Në këtë mënyrë reforma e procedurës së vendimmarrjes në lidhje me zbatimin e politikës së jashtme të BE-së, u bë më e ndërlikuar dhe nuk u përmirësua në mënyrë të qenësishme. Veçanërisht formula e bllokimit në rast nevojë (*emergency brake*), dukej si një rikthim të *Kompromisi i Luksemburgut*, gjatë krizës së karriges bosh të Francës në vitet '60. Zyrtarizimi i abstenimit si formë vendimmarrje dhe përcaktimet e ndryshme në këtë rast, më shumë e zvogëlonin se sa e nxisnin efektivitetin e një politike të jashtme të përbashkët. Kjo tregonte qasjen e dukshme drejt prirjeve të interesit kombëtar të vendeve anëtare të BE-së në raport me forcimin e identitetit european të politikës së jashtme.

Ndërkohë për shkak të presidencës me rotacion, e kalimit të saj çdo 6 muaj të vendeve të ndryshme anëtare, shtruhej çështja e përfaqësimit në fushën e politikës së jashtme. Për këtë arsye shtetet anëtare ranë dakord të krijonin Përfaqësuesin e Lartë për CFSP-së, i cili do të ishte në të njëjtën kohë edhe në rolin e drejtuesit të Sekretariatit të Këshillit të Ministrave të BE-së. Sipas Traktatit të Amsterdimit ai duhej të kontribuonte në formulimin e zbatimin e politikës së jashtme të përbashkët (CFSP) si dhe të ndihmonte punën e Këshillit, duke vepruar sipas udhëzimeve të këtij të fundit. Mënyra e përcaktimit të funksioneve e rolit të Përfaqësuesit të Lartë për CFSP-në, tregonte në të njëjtën kohë edhe dobësinë e tij përballë forcës së presidencës së radhës së BE-së, e cila do të vazhdonte të kishte rol qendror për sa i përket politikës së jashtme të përbashkët e sigurisë. Tashmë edhe Trojka e BE do

të ndryshonte përbërje. Së bashku me presidentin e radhës të Këshillit të Ministrave të BE-së, Presidentin e Komisionit European, Përfaqësuesi i Lartë për CFSP do të përbënte trojkën e re, me të cilat BE-ja do të përfaqësohej në marrëdhëniet me jashtë, në raport me shtetet joanëtare.

Në vijim të ndryshimeve ndaj mekanizmave të funksionimit të CFSP, u ndërmorën edhe hapa për të përmirësuar mungesën e planifikimit dhe analizës, e cila ishte konsideruar si një nga dobësitë e saj. Sipas një deklaratë që iu bashkëngjit Traktatit të Amsterdami, për këtë qëllim, u krijua pranë Sekretariatit të Këshillit të Ministrave të BE-së dhe nën autoritetin e Përfaqësuesit të Lartë për CFSP, *Njësia e Planifikimit Politik dhe Paralajmërimeve të Hershme/Policy Planning and Early Warning Unit*. Suksesi i kësaj strukture, e cila më vonë do të quhej *Njësia e Politikës/Policy Unit*, do të varej nga aftësia dhe niveli i specialistëve që do të emëroheshin aty nga Komisioni, WEU, si dhe vetë Sekretariati i Këshillit të Ministrave. Shtetet anëtare duhet t'i ofronin asaj informacionin e nevojshëm, duke përfshirë edhe atë me natyrë konfidenciale dhe presidenca e radhës e BE-së mund të autorizonte këtë strukturë, të paraqiste pranë Këshillit të Ministrave *dokumente politike (policy paper)*, që e ndihmonin dhe e orientonin atë në marrjen e vendimeve. Por ashtu si në rastin e efektivitetit të CFSP-së, edhe mirëfunksionimi dhe aktiviteti i saj do të varej pjesërisht nga interesat e orientimet e presidencës së radhës të BE.

Ndërkohë një nga problemet që qëndronte përballë kësaj politike të përbashkët të BE-së e ndikonte në efektivitetin e saj, ishte i lidhur me buxhetin që mundësonte zbatimin në terren. Sipas Traktatit të Matrihtit, ishte përcaktuar që shtetet anëtare mund t'i vinin në ngarkim shpenzimet për CFSP-në qoftë në buxhetin e tyre apo edhe në atë të BE-së. Shumë prej vendeve anëtare parapëlqenin t'i mbulonin këto shpenzime nga buxhetet e tyre kombëtare, pasi në këtë mënyrë parapëlqenin të mos paguanin çmimin politik të kontrollit nga Parlamenti European. Ky institucion ishte i përfshirë në CFSP, për shkak të përcaktimit të kësaj të fundit si një kolonë e veprimit ndërqeveritar e jekomunitar. Por në Traktatin e Amsterdami ata ranë dakord që shumica e shpenzimeve

operacionale të CFSP-së t'i ngarkoheshin buxhetit të BE-së (shpenzimet kryesore ishin ato që përfshinin ato me karakter ushtarak të misioneve paqeruajtëse), duke njohur në këtë rast edhe rolin e parlamentit. Ky traktat realizoi edhe një marrëveshje ndërinstitucionale mbi financimin e CFSP-së e cila do të negociohej mes këshillit, komisionit dhe parlamentit.

Në qershor të vitit 1999 kur sapo kishte hyrë në fuqi Traktati i Amsterdimit, në Samitin e Këlnit, liderët e BE-së zgjodhën Javier Solanën si Përfaqësuesin e Lartë të BE-së për Politikën e Jashtme e të Sigurisë (CFSP). Këtë detyrë Solana e mori zyrtarisht në tetor 1999 dhe vazhdon ta mbajë edhe në ditët e sotme. Në këtë pozicion ai vinte nga posti i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, duke gëzuar në këtë mënyrë njohjen dhe besimin e nevojshëm në qarqet diplomatike e ushtarake veçanërisht të SHBA-së që ishin aktori kryesor në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në këtë detyrë këtej e tutje ai do të rivalizonte e madje do të linte disi në hije institucionin e Komisionarit të BE-së me Marrëdhëniet me Jashtë, i cili mbahej nga Kris Patten (1999-2004) dhe Bentta Ferrero Valddner (2004-2009).

Në lidhje me zbatimin e instrumenteve të CFSP-së të përcaktuar nga Traktati i Amsterdimit, BE miratoi dy *Strategjitë të Përbashkëta*, të cilat ishin edhe të parat në këtë drejtim, ku njëra përfshinte Rusinë dhe tjetra Ukrainën. Që nga hyrja në fuqi e këtij traktati e në vazhdim BE ka miratuar *12 veprime të përbashkëta (joint actions)*, nga të cilat 9 për Ballkanin Perëndimor) dhe *22 pozicione të përbashkëta* (nga të cilat 5 për Ballkanin Perëndimor). Megjithëse BE ka miratuar shumë pak *Strategji të Përbashkëta*, që do të përbënin në fakt më pas bazën për vendime e veprime të përbashkëta, edhe ato të deritanishmet nuk janë shndërruar kurrë në një instrument të rëndësishëm të CFSP-së. Gjatë deklarimeve të tyre edhe Javier Solana e Kriss Patten kanë shprehur pakënaqësitë e tyre, pasi i konsideronin shumë të përgjithshme për të qenë efektive. Vetë BE miraton çdo rreth *15 veprime apo 22 pozicione të përbashkëta (joint actions and common positions)* mbi çështje rajonale apo karakter të veçantë si dhe harton një sërë deklaratash. Shembujt e aktivitetit të Politikës së Jashtme të

Përbashkët e të Sigurisë përfshijnë monitorimin e zgjedhjeve në të gjithë botën, vizita nga trojka, ndërmjetësim nga Solana në të ashtuquajturën “Europën e gjerë” siç ishte p. sh. rasti në Maqedoni (2003) e Ukrainë (2004).

Emërimi i Përfaqësuesve Specialë të BE-së në rajone apo zona konflikti si në procesin e paqes së Lindjes së Mesme apo në Afrikë, është dëshmi e përpjekjeve të saj për të rritur identitetin e profilit në fushën e veprimit diplomatik. Njëpërmjet vendosjes së sanksioneve, kufizimeve tregtare, mosdhënie të vizave për personalitete apo zyrtarë autoritaristë të vendeve të ndryshme, BE është përpjekur të përdorë elementë tradicionalë të shtrëngimit diplomatik për të forcuar identitetin e saj në këtë fushë. Ndërkohë përpjekjet e saj nga fundi i viteve '90, për të hartuar një politikë europiane të mbrojtjes e për të rritur kapacitetin ushtarak, janë konsideruar si zhvillime të tepërta në këtë drejtim.

Ashtu siç është e bërë e njohur për gjithsecilin, sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 ndaj SHBA, përveçse tronditën thelbin e politikës së jashtme të përbashkët, i dhanë një shtysë akoma më të madhe përpjekjeve për të ndryshuar qëndrimin e deriatëhershëm. Liderët e vendeve anëtare të BE-së, vunë re se sulmet e 11 shtatorit ishin një sfidë e sigurisë globale ndaj së cilës edhe ata nuk ishin të paprekshëm. Gjatë Samiti i Jashtëzakonshëm i BE 21 shtator 2001, kuadër të CFSP-së, u hartua një deklaratë ku u dënuan këto sulme ashtu si edhe Trojka e BE ndërmori një sërë takimesh në Lindjen e Mesme e Azinë Qendrore. Në të njëjtën kohë marrëveshja e mbështetur nga OKB mbi tranzicionin politik në Afganistan, e nënshkruar në Bon në dhjetor 2001 nuk do të kishte qenë e mundur në formën e saj përfundimtare pa përpjekjet e BE në kuadër të politikës së jashtme të përbashkët...

Megjithatë përgjatë këtyre sukseseve, ndiheshin sërish frikat mes shteteve më të vegjël, anëtarë të BE-së, për një mbizotërim e anashkalim të tyre në vendimmarrjet e rëndësishme nga të ashtuquajturit “3 të mëdhenjtë” (Francë, Angli, Gjermani). Kjo lloj mënyre cenonte drejtpërdrejt dhe e bënte të paefektshme përmbajtjen e CFSP-së duke paralajmëruar për kriza të reja. Ndërkaq, takimet e veçanta mes Blerit, Shirakut

e Shrëderit gjatë Samitit të Brukselit në tetor 2001, për të diskutuar mbi Afganistanin, veçse vërtetuan më tej këtë “ndarje” që ekzistonte brenda fushave të veprimit të kësaj politike të përbashkët. Reagimi i vendeve të “shpërfillura” nuk do të mungonte të shfaqej në trajtën e një “incidenti”, kur disa ditë më vonë liderët e Belgjikës, Holandës, Italisë e Spanjës (edhe Solana) ata nuk iu përgjigjën ftesës së kryeministrit britanik për një darkë në rezidencën e tij në Londër.

Përballë këtyre zhvillimeve, Traktati i Nicës i 26 shkurtit 2001 u përpoq të ndreqte diçka, nëpërmjet futjes së instrumentit të *bashkëpunimit të intensifikuar (enhanced cooperation)*, për sa u përket çështjeve në CFSP që lidheshin me zbatimin e veprimit apo pozicionit të përbashkët (*joint action or common position*). Në të vërtetë kjo përfaqësonte një nga zhvillimet kryesore të këtij traktati në këtë fushë. Ashtu siç e përcaktonin edhe dispozitat e traktatit në një rast të tillë, shtetet anëtare që kërkonin të realizonin një bashkëpunim të intensifikuar, në fushat e mësipërme, duhet t’ia drejtonin këtë kërkesë Këshillit të Ministrave të BE-së. Miratimi nga Këshilli i Ministrave të BE-së për një veprim të tillë realizohej pas votimit me shumicë të cilësuar (QMV) si dhe pasi Komisioni Europian të kishte paraqitur opinionin e tij si dhe Parlamenti Europian të të kishte dhënë pëlqimin. Por ndërkohë, rastin e këtij mekanizmi një shteti anëtar i lejohej që të kërkonte dërgimin e këtij vendimi në Këshillin Europian për një vendim unanim. Në këtë mënyrë shtetet anëtare vazhdonin të ruanin sërish të drejtën e vetos, për sa i përket veprimeve në fushën e politikës së jashtme, duke e vështirësuar së tepërmi edhe çdo iniciativë nga një grup shtetesh anëtare.

Ndërkohë shtetet anëtare të BE-së kishin filluan përgatitjet për të hartuar një projekt-kushtetutë të BE-së, e cila kishte për qëllim të thellonte më tej karakterin federal të BE-së, e si pasojë do të rriste dukshëm identitetin e saj në fushën e politikës së jashtme. Në shkurt 2002 u hap Konventa për të Ardhmen e Europës/Convention on the Future of Europe, ku ndër pikat kryesore të axhendës së BE-së ishte edhe Politika e Jashtme e Përbashkët dhe e Sigurisë (CFSP), së cilës i ishte bashkëngjitur edhe Politika Europiane e Mbrojtjes (EDC). Në

këtë rast Konventa dhe Konferenca Ndërqeveritare u paraqitën si një mundësi e mirë për të arritur përparim në këto fusha, që do të kushtëzonin peshën dhe rolin e BE-së në zhvillimet e ardhshme ndërkombëtare. Propozimi francez e gjerman në këtë konventë, për të shkrirë pozicionet e Përfaqësuesit të Lartë për CFSP-në dhe Komisionarit për Marrëdhëniet me Jashtë të BE-së në postin e Ministrit të Punëve të Jashtme të BE-së, përbënte zhvillimin me shpresëdhënës drejt një politike të jashtme europiane të vërtetë. Në këtë mënyrë pasi konferenca e pranoi këtë dhe e përfshiu në projekt-traktatin e kushtetutës së BE-së, vendet anëtare ranë dakord që ministri i punëve të jashtme të BE-së do të drejtonte Këshillin për Marrëdhënie me Jashtë, duke qenë njëkohësisht zv/president i Komisionit dhe përgjegjës për marrëdhëniet me jashtë. Ky hap u konsiderua si një ndër zhvillimet më të rëndësishme dhe përmirësimi e kapërcimi më cilësor që kishte ndodhur në raport me Politikën e Jashtme të Përbashkët e të Sigurisë (CFSP), e cila që nga 1992 që përballej me sfidën e ecjes së ngadaltë e plot zigzage.

Ndërkohë këto zhvillime pozitive në lidhje me përmirësimin e CFSP dhe projekt-traktatin kushtetues të BE-së, përkuan me një tjetër ngjarje të rëndësishme në politikën ndërkombëtare. Situata në Irak dhe këmbëngulja e SHBA-së për të ndërhyrë ushtarakisht në këtë vend, krijoi një të çarë jo të vogël mes një pjese të vendeve kryesore të BE-së e vetë lidhshimit amerikan. Përpjekja e SHBA-së për të krijuar një “koalicion vullneti” me aleatë të veçantë edhe mes vendeve europiane, vuri sërish në provë brishtësinë e mekanizmave të CFSP-së. Mbështetja pa rezerva e kryeministrit Bler ndaj kësaj ndërhyrje e kundërshtimi i Shirak dhe Shredër, u duk sikur e zbehu sërish bashkëpunimin e arritur në bisedimet për kushtetutën edhe për çështjet e politikës së jashtme të përbashkët.

Letra e nënshkruar në janar 2003 nga liderët e Danimarkës, Britanisë, Italisë, Spanjës e 3 shteteve kandidate (Ceki, Hungari, Poloni) në mbështetje të ndërhyrjes amerikane në Irak, e zemëroi shumë ish-presidentin francez Shirakun dhe ish-kancelarin gjerman Shredër. Ndërkohë Solana u ndie

tërësisht i anashkaluar ndaj këtij zhvillimi, teksa e mësoi këtë ngjarje nga mediat, duke përjetuar pafuqinë si Përfaqësues i Lartë për Politikën e Jashtme të Përbashkët e të Sigurisë. Kësaj deklarate mbështetje iu përgjigjën në fillim të shkurtit 2003 edhe 10 vende kandidatë të Europës Qendrore e Lindore për në BE, mes të cilave u përfshinë edhe Shqipëria, Kroacia e Maqedonia. Kjo e pësjtjelloi më tej situatën që u pasqyrua në reagimet e ashpra të disa liderëve evropianë e veçanërisht të Shirakut, pavarësisht mbështetjes që i dhanë atij Belgjika e Luksemburgu. Ndarja mes liderëve evropianë ndaj kësaj çështje u pasqyrua edhe në opinionin publik, i cili veçanërisht gjatë protestave në Madrid e Londër e kundërshtoi hapur e me forcë këtë zhvillim të ri në politikën e jashtme e qëndrimin respektiv të qeverive të tyre.

Duke qenë se presidencën e radhës së BE-së gjatë 6-mujorit të parë të 2003 e kishte një vend i vogël si Greqia, u shfaq dukshëm kriza e përfaqësimit, në raport me politikën e jashtme të përbashkët të BE-së. Ndonëse në raste të tilla krizash brenda BE-së, drejtimi i presidencës nga një vend i vogël e lehtësonte komunikimin, përkundër qëndrimit tepër të prerë që do të mbante një vend i madh i BE-së, sërish mungesa e harmonizuar e qëndrimeve e dëmtoi imazhin e BE-së në fushën e politikës së jashtme. Me këtë rast, Greqia e dënoi luftën, por bëri përpjekje të ruante unitetin e BE mbi këtë çështje. Për t'iu përgjigjur kësaj situatë Greqia organizoi një Samit European Special më 15 shkurt 2003, ku vendet anëtare aprovuan një deklaratë që në thelb nuk e miratonte ndërhyrjen ushtarake në Irak. Pas këtij takimi ish-presidenti francez Shirak sulmoi e ironizoi vendet që kishin dalë pro luftës, sidomos vendet kandidatë të Europës Qendrore e Lindore, të cilat nuk ishin konsultuar me BE-në, përpara se të deklaronin qëndrimin e tyre ndaj këtij zhvillimi. Me anë të kësaj sjellje Shiraku shprehte shqetësimin e tij për pasojat e ndikimit të ardhshëm të zgjerimit, veçanërisht në fushën e politikës së jashtme të përbashkët e të sigurisë. Përdorimi i termave “Europë e Re” dhe “Europë e Vjetër”, përveçse pasqyronte një realitet të qëndrimeve të vendeve anëtare të BE-së, dëshmonte për vështirësitë që do të vazhdonte të vuante procesi

i koordinimit të një politike të jashtme me identitet mirëfilli komunitar. Megjithëse liderët e vendeve të Europës Qendrore në takimin e 16 shkurtit 2003 me Trojkën e BE-së, ranë dakord me pozicionin e Këshillit European mbi Irakun, deklaratat e Solanës se “*BE nuk ka një politike të jashtme, por disa*” ishin dëshmi e një shqetësimi të dukshëm e të pranuar haptazi. Deklaratat e Romano Prodit, në rolin e kryetarit të Komisionit European për unitet european (*Europa ka një zë e ajo duhet të dëgjohet*), nuk mund të mbulonin prirjet ende të qarta të një pjese të vendeve anëtare, për të zhvilluar një politikë të jashtme sipas interesave të tyre kombëtare, por jo komunitare.

Historia e përpjekjeve të BE-së, për të krijuar identitetin e saj të qëndrueshëm në politikën e jashtme, tashmë ka ngecur në mes krizës së miratimit të kushtetutës, procesit aktual të vendimmarrjes si dhe shpejtësisë me të cilën zhvillohen marrëdhëniet ndërkombëtare. Mekanizmat aktualë të BE-së në fushën e politikës së jashtme, nuk mund t’i japin asaj më shumë peshë sesa është duke ushtruar realisht, veçanërisht për vendimmarrje të rëndësishme e për çështje me rëndësi. Tre krizat aktuale në politikën ndërkombëtare, ajo e Irakut, kriza bërthamore e Iranit e zgjidhja veçanërisht e statusit të Kosovës janë dëshmi e mënyrës se si është realizuar përmes vështirësish të shumta në vite, mekanizmi për një politikë të jashtme të përbashkët nga ana e BE-së. Nëse referendumi nuk do të kishte dështuar në Francë e Holandë struktura institucionale e BE-së do të ishte krejt ndryshe e ndoshta ministri i jashtëm i BE-së do ta kishte shumë të lehtë për të thënë po apo jo. Ndërkohë Samiti Jozyrtar European i Lisbonës më 18-19 tetor 2007 ringjalli shpresat për një ndryshim shpresëdhënës në këtë drejtim. Megjithëse fjala kushtetutë nuk përmendet në deklaratën finale, Traktati i Lisbonës që pritet të firmoset më 13 dhjetor 2007 e të hyjë në fuqi më 2009, parashikon krijimin e pozicionit të Shefit të Politikës së Jashtme të BE-së. Megjithëse ky proces do të ketë rrjedhën e vet, është mëse e qartë se BE po bëhet e vetëdijshme për pasojën që i ka shkaktuar në arenën ndërkombëtare mungesa e një identiteti të qartë e mekanizmat institucionalë për të zbatuar një politikë të jashtme europiane. Në këtë rast i vetmi justifikim për këtë

vonesë, mund të ishin fjalët e një prej baballarëve themelues të BE-së, Zhan Mone, i cili pohonte se “Të mendosh se Europa do të bëjë progres pa vështirësi është një gabim themelor”.

Bibliografia:

Cederman, Lars – Erik, *Constructing Europe’s Identity: The External Dimension*, Lynne Reinner, 2001.

Eeckhout, Piet *External Relations of the European Union: Legal and Constitutional Foundations*, OUP, 2004.

Eliassen Kjell. A (ed) *Foreign ad Security Policy in the European Union*, Sage, 1998.

Hill, Christopher & Smith, Karen (eds), *European Foreign Policy: Key Documents*, Routledge.

Holland, Martin, *European Union Common Foreign Policy*, Routledge, 1996.

Peterson, J & Sjursen, H (eds) *A Common Foreign Policy for Europe?: Competing Visions of the CFSP*, Routledge, 1998.

Regelsberger, Elfriede, de Schoutheete de Tervarent, Philippe & Wessels, Wolfgang (eds), *Foreign Policy of the European Union: From EPC to CFSP and Beyond*, Lynne Reinner, 1997.

Smith, Karen, E., *Making of EU Foreign Policy: The Case of Eastern Europe*, MacMillan, 1999.

Smith, Karen, *An European Union Foreign Policy in a Changing World*, Policy 2003.

Tonra, Ben&Christiansen, Thomas(eds) *Rethinking European Union Foreign Policy*, MUP, 2004.

Zielonka, Jan (ed), *Paradoxes of European Foreign Policy*, Kluwer Law International, 1998.

Zeielonka, Jan, *Explaining Euro-paralysis: Why Europe is Unable to Act In International Politics*, MacMillan, 1998.

Whitman, Richard, *From Civilian Power to Superpower?: The International Identity of the European Union*, MacMillan, 1998.

Opinion nga MANJANA MILKOREIT*

DUKE E VLERËSUAR SERIOZISHT DIMENSIONIN CIVIL TË SIGURISË:

NATO si një organizatë rindërtimi pas konfliktit

Duke treguar të ardhmen: afganët kanë mundur të votojnë vetëm pas ndërhyrjes së NATO-s në këtë vend - një shembull i qartë i përpjekjeve rindërtuese.

Banka Botërore përcakton Rindërtimin Post-Konflikt (PCR) si “mbështetje për tranzicionin nga konflikti në paqe duke rindërtuar kuadrin social ekonomik të një vendi”. Deri ku mund të shkojë NATO në këtë rol të PCR-së? Pikërisht për këtë çështje, Manjana Milkoreit jep opinionin e saj që NATO mund të jetë nga organizatat më mirë të pajisura për të luajtur rolin e PCR (rindërtuesit pas-konfliktit).

Është gjithmonë interesante të shohësh çështje të rëndësishme të sigurisë ndërkombëtare dhe të bësh pyetjen “Çfarë do të ndodhte nëse...”. Çfarë do të ndodhte nëse, për shembull, SHBA do t’i krijohesh mundësia për të pushtuar edhe një herë Irakun? Çfarë do të ndodhte nëse NATO-s do t’i duhej të ripërcaktonte edhe një herë misionin e saj në Afganistan? Çfarë do të ndodhte nëse Europa do të niste edhe një herë procesin e stabilizimit të Ballkanit? Çfarë do të bënin ata ndryshe? Duket shumë e mundshme që të gjithë sa më sipër, në një rifillim të ri do të përqendroheshin më shumë dhe më fort në rindërtimin postkonfliktual (PCR).

* Manjana Milkoreit është drejtore e Qendrës për Çështje Strategjike dhe Globale në Berlin.

Para viteve '90, shumë pak vetë kishin parashikuar se PCR mund të bëhej një nga sfidat më serioze dhe më të gjata për menaxhimet ushtarake pas Luftës së Ftohtë. Ka pasur shumë pak planifikim, trajnim apo qoftë edhe njohuri për t'u specializuar në këtë fushë. Kjo mospërgatitje ka çuar në përpjekje të dështuara për ngritjen e shtetit si nga shtetet e ndryshme ashtu edhe nga organizatat ndërkombëtare, për të mos thënë që në disa raste përpjekjet e tyre e kanë përkeqësuar situatën e krizës.

Shpesh shtrohen shumë pyetje për mjediset pas konfliktuale, si për shembull kush do të jetë përgjegjës financiarisht, ligjërisht dhe moralisht. Por shumë pak veta vënë në dyshim një çështje: bota duhet të jetë më mirë e përgatitur për të angazhuar në rindërtimin pas konfliktit (PCR).

Konfliktet ndërkombëtare qysh nga fillimet e 1990-s kanë treguar se operacionet ushtarake janë vetëm një aspekt i stabilizimit dhe rindërtimit pas konfliktit. PCR inkorporon detyra ushtarake dhe civile në pesë fusha të ndryshme:

- Ofrimin e *sigurisë* (ku përfshihen funksione ushtarake dhe policore);
- Dhënien e *shërbimeve bazë* (d. m. th. ujë, energji elektrike, shërbime shëndetësore);
- Ndërtimi i *strukturave politike* (d. m. th. hartimi i kushtetutës, sistemit elektoral);
- Krijimi i një *infrastrukturate ekonomike*;
- Dhe lehtësimin e *pajtimit* midis ish-grupeve ndërluftuese.

Konfliktet në Irak dhe Afganistan jo vetëm kanë nxjerrë në pah nevojën për një qasje përfshirëse civilo-ushtarake të PCR-së, por kanë tërhequr një vëmendje të paparë politike të kjo çështje. Kjo hap dritaren e mundësisë për një ndryshim institucional substancial.

Hap përpara për NATO-n

NATO mund të jetë çelësi për zgjidhjen e kësaj sfide mjaft të ndërlikuar. Pse? Sepse ajo tashmë ka ekspertizë unike për çështje ushtarake. Dhe kjo po shkon edhe te sfera politiko-

ushtarake, terren i panjohur mbi të cilin po ecet. NATO duhet të bëhet eksperte në çështje të rindërtimit civil po aq sa është në ato të stabilizimit ushtarak.

Pavarësisht pozicionit të NATO-s për këtë çështje, një përpjekje ndërkombëtare për të ndërtuar kapacitete të PCR duhet të fokusohet në shndërrimin e NATO-s në një organizatë ndërkombëtare rindërtimi: duke e bërë NATO-n aktorin qendror në një rrjet të PCR-së të partneriteteve globale me shtetet jo-anëtare, dhe organizatat rajonale dhe ndërkombëtare. Ky ndryshim institucional do të ofronte një moment të rëndësishëm për çështje të PCR - duke rigrupuar resurset e tanishme të shpërndara.

Pse NATO?

PCR kërkon një ekspertizë të kombinuar ushtarake dhe civile. Asnjë organizatë nuk i ka të dyja këto kapacitete nën siglën e saj. Krijimi i një bashkëpunimi efektiv midis personelit ushtarak dhe civil kërkon përballjen me sfida të rëndësishme kulturore dhe koordinative. NATO është organizata më e përshtatshme për të arritur këto objektiva për katër arsye:

1. Së pari, NATO është më e specializuar në komponentin ushtarak të PCR: duke dhënë siguri dhe stabilitet në rajonet e krizave pas konflikteve të dhunshme.

2. Së dyti, NATO është tashmë duke testuar një qasje civilo-ushtarake përmes Ekipeve të Rindërtimit të Provincave (PRT) në Afganistan. PRT-të dhe një NATO ushtarako-civile kanë në themel të njëjtën detyrë: një veprim domethënës për rindërtim, mbështetur në aftësitë dhe ekspertizën ushtarake dhe civile. Zhvillimi i mëtejshëm i NATO-s si organizata kryesore botërore për rindërtim mbështetet dhe zgjeron bashkëpunimin civilo-ushtarak. Deri tani, komuniteti ndërkombëtar ka dështuar në zbatimin e saktë të mësimëve të nxjerra nga rindërtimet pas konfliktuale të viteve '90 dhe fillimit të shekullit të 21-të.

3. E treta, roli i NATO-s si një Aleancë rajonale mbrojtjeje varet nga një bashkëpunim, komunikim dhe planifikimi

afatgjatë ndërmjet shumë enteve ushtarake. Kjo eksperiencë është vitale për koordinimin dhe menaxhimin e rrjeteve nga më të ndryshme të PCR-së. Dhe fokusi aktual i NATO-s në ndërtimin e partneriteteve me shtete dhe organizata trupëzohet mirë në krijimin e rrjeteve të PCR-së, jo vetëm për çështje ushtarake, por edhe në komponentë civile të PCR-së.

4. E katërta, NATO është duke ripërcaktuar qëllimin dhe misionin e saj. NATO duhet të demonstrojë aftësi për t'iu përshtatur në mënyrë të vazhdueshme sfidave të reja të angazhimeve ushtarake në shekullin e 21-të. Riformatimi i misionit, ambicieve dhe shtrirjes gjeografike në një bazë më shumë globale sesa rajonale do t'i forconte fuqitë e NATO-s. Aleanca është në mënyrë unike e pozicionuar për të shtuar vlerat e kësaj sipërmarrje, krahasuar në mënyrë relative me organizatat e tjera kombëtare, rajonale apo ndërkombëtare.

Nga ide në realitet – çfarë do të thotë kjo për NATO-n?

Së pari, kjo do të nënkuptonte ndryshimin e misionit. Aktualisht NATO është një lojtar kryesor në çështjet e PCR-së, por vetë bërja e PCR një prioritet njëkohësisht me çështje të tjera si siguria, mbrojtja, shmangja e konflikteve, apo partneritetet do të kërkonte një ndryshim të karakterit organizativ dhe një zgjerim substancial të misionit të NATO-s.

Tranzicioni i NATO's nga një Aleancë gjeografike në një Aleancë funksionale i jep asaj një rol global, duke theksuar rëndësinë e partneriteteve të saj globale. Gjuha e Traktatit të Aleancës së Veriut është gjithashtu fleksibël për të lejuar ndryshime të mëtejshme pa ndeshur vështirësinë politike të përshtatjes së tekstit të Traktatit.

Së dyti, futja e kapaciteteve rindërtuese në NATO nxjerr në pah sfida organizative dhe kulturore. Zhvendosja nga një identitet kryesisht ushtarak në një tjetër të kombinuar civilo-ushtarak do të thotë krijimi i strukturës më të madhe të integruar civilo-ushtarake në të gjithë botën.

Ndërkohë që strukturat ekzistuese ushtarake të NATO-s do të qëndrojnë të pandryshueshme, strukturat civile do të zgjerohen për të përfshirë një degë të rindërtimit që në vetvete përfshin të gjitha aktivitetet jo-ushtarake të rindërtimit pas konfliktual (PCR). Integrimi i këtyre dy degëve do të kërkonte koordinim të ngushtë, komunikim të lehtë, udhëheqje të aftë dhe menaxhim të kujdesshëm.

Përpyekjet rindërtuese duhet të pajtojnë shumë ndarje, civilët me ushtarakët, të vjetrat me të rejat, apo në mënyrë të veçantë ndarjet midis konfliktit dhe paqes.

Një integrim efektiv civilo-ushtarak do të mundësojë një trajnim të përbashkët dhe familjaritet operacional të kapaciteteve ushtarake dhe atyre civile përpara operacioneve të krizave. Kjo gjë do të mundësojë planifikim më të mirë të PCR-së, si dhe të një plani zbatues të përmirësuar që në fillim të krizës.

Kjo situatë do të kërkonte ngritjen e departamenteve të mëposhtme brenda strukturës civile të organizatës.

Një forcë policore civile: duke marrë në konsideratë integrimin e Forcës së Xhandarmërisë Europiane (EGF) ekzistuese, NATO do të ngrinte njësi policore lehtësisht të dislokueshme të trajnuar dhe koordinuar në qendra trajnimi të përbashkëta si Shtabi i EGF në Vicenza, Itali.

Një departament ligjor e politik do të angazhohej me shumë detyra për të ndihmuar rindërtimin: me ekspertizën dhe kapacitetet për të hartuar kushtetutën specifike të atij vendi, sistemin elektoral, strukturat juridike dhe administrative, do të ndihmojë duke mbështetur strukturat shtetërore pas konfliktit. Detyrat e këtij departamenti mund të përfshijnë edhe ngritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile.

Departamenti inxhinierik dhe i infrastrukturës është një shembull kryesor për potencialet e bashkëpunimit civilo-ushtarak brenda NATO-s. Sigurimi i shërbimeve jetësore (energji elektrike, ujë, etj.) pas konfliktit është thelbësore për ta kufizuar krizën humanitare - trupat inxhinierike ushtarake i kanë tashmë demonstruar këto kapacitete. Por, PCR kërkon gjithashtu kapacitete dhe aftësi civile për plane afatgjata të infrastrukturës urbane apo rurale. Ndërthurja midis

ekspertizës ushtarake dhe inxhinierisë civile në terren para dislokimit të trupave mundëson rindërtimin e infrastrukturës civile të qëndrueshme menjëherë pas përfundimit të dhunës.

Një departament për zhvillimin ekonomik do të punonte në bashkëpunim të ngushtë me departamentin e inxhinierisë si dhe me Bankën Botërore, Programe të UNDP-së, me OJQ dhe ekspertë të vendeve të ndryshme.

Ndërsa një departament i specializuar për gësjtje të pajtimit do të kishte detyrën e vështirë për të nxitur bashkimin e njerëzve dhe popujve të një vendi të gërryer nga konflikti. Specialistë të pajtimit, negociator dhe psikologë do të bashkëpunonin me ekspertë lokalë.

PCR kërkon një kombinim të ekspertizës ushtarake me atë civile. Asnjë organizatë e vetme nuk i ka këto kapacitete brenda vetes. Një departament të “vëzhgimit të krizës”, i cili do të monitoronte zonat në konflikt do të siguronte një nivel të caktuar alarmi dhe gatishmërie, si dhe do të grumbullonte informacion për vendet në të cilat dislokimi i NATO-s mund të ishte i nevojshëm.

Njësia për “mësimet e nxjerra” do të mblidhte, klasifikonte dhe analizonte informacionin mbi eksperiencat e rindërtimit të NATO-s, duke furnizuar organizatën me informacion për të përmirësuar performancën.

Së treti, NATO duhet të jetë në epiqendër të përpjekjeve për të ndërtuar partneritete globale rindërtimi civilo-ushtarak.

Dega rindërtuese e NATO-s duhet të ngrejë ekspertizën si dhe konceptin e vet për rindërtimin. Më shumë sesa të kopjojë apo publikojë eksperiencat ekzistuese, NATO duhet të ngrejë këto burime, duke e shndërruar veten në një koordinator dhe menaxhues të ekspertizës përmes partneriteteve globale.

Hapi i parë në rrugën për ndryshim

Deri me tani, komuniteti ndërkombëtar ka dështuar për të zbatuar saktësisht mësimet e nxjerra nga rindërtimi pas konfliktual i viteve '90 të konfliktet e para të shekullit të 21-të.

Nevoja dhe mundësia për ndryshim ka ardhur. Përpjekjet e para të dukshme për të ndërtuar kapacitete të PCR duhet të konsolidohen, zgjerohen dhe koordinohen nën siglën e një organizate të vetme dhe të aftë për këtë mision: NATO-s.

Në mënyrë të paevitueshme reforma e propozuar do të rriste nevojat për fonde të NATO-s. Megjithatë, kostoja afatshkurtër për ngritjen e kësaj strukture duhet të peshohet përkundrejt kursimeve afatgjata, në mënyrë të veçantë, në cilësinë e jetës dhe termave ekonomike. Këto përfitime do të ishin më të qarta nëse kapacitetet rindërtuese pas konfliktuale do të funksiononin kur rajoni i radhës në konflikt do të kërkonte ndihmën e komunitetit ndërkombëtar.

Aleanca do të duhej të inicioje kërkime ndërkombëtare për të investiguar mundësinë e reformës së NATO-s në një organizatë ndërkombëtare rindërtimi. Konferenca dedikuar kësaj çështje dhe realizimi i studimeve për integrimin e ekspertëve civilë e ushtarakë në PCR, riformatimi organizativ për bashkëpunimin civilo-ushtarak dhe programe të ndryshme vlerësimi, do të çonin në rekomandime të vlefshme se si mund të strukturohej dhe financohej kjo reformë.

Nëse NATO e merr apo jo këtë mision mbi vete, mbetet e rëndësishme që vendet anëtare të NATO-s të vlerësojnë sfidat dhe koston e angazhimit për rindërtimin pas konfliktit dhe (mungesën) aktuale të kapaciteteve. Ato duhet të zhvillojnë një strategji koherente për të zënë vrmat në sistemin aktual qoftë në nivele kombëtare, qoftë në ato ndërkombëtare.

IGLI TASHI***SOLANGE GHERNAOUTI – HÉLIE****

VENDI I SIGURISË SË INFORMACIONIT NË STRATEGJINË E SIGURISË KOMBËTARE

Në njërin krah siguria kombëtare si koncept, konsiderohet si garante e ushtrimit të të drejtave të njeriut, dhe si e tillë është një nga detyrat më të rëndësishme të një shteti. Kjo garanci, sipas nenit 12 të deklaratës së të drejtave të njeriut, duhet të përmbushet nga një forcë publike, e cila të mbrojë në mënyrë të barabartë interesat e gjera të gjithë popullsisë dhe jo vetëm të atyre të cilëve ajo iu është besuar.

Në krahun tjetër, në këtë fillim të shekullit XXI, informacioni, i trajtuar në të gjitha format e mundshme, elektronike apo tradicionale, përbën një pasuri të vërtetë si për individët ashtu dhe për organizmat privatë apo shtetërorë dhe konsiderohet si një burim strategjik, rreth të cilit zhvillohet ajo që sot quhet shoqëria e informacionit. Nuk është hera e parë që teknologjia dhe inovacionet e lidhura me të, janë në bazën e ndryshimeve të thella për shoqërinë: dje, me

*Ekonomist / Master në juridik, për çështjet ligjore dhe të sigurisë në kibernetikë.

Kërkim pasuniversitar dhe asistent-lektor.

Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë, Universiteti i Luizanës Zvicër.

** Profesor

Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë Universiteti i Luizanës.

Ekspert ndërkombëtar për krimet kibernetike dhe çështjet kibernetike të sigurisë.

Anëtar i grupit të ekspertëve të nivelit të lartë - Unioni i Telekomunikacionit Ndërkombëtar.

inovacionet në fushat e energjisë dhe sot, me mënyrat e larmishme të komunikimit të njohurive dhe informacioneve nëpërmjet teknologjive të reja të telekomunikacionit. Ky koncept i shoqërisë së informacionit, si një vazhdimësi e shoqërisë industriale të disa viteve më parë, vë në qendër të saj informacionin dhe njohuritë, si dhe mënyrën e përcjelljes së tyre pa limite gjeografikë dhe kohorë. Teknologjitë e telekomunikacionit (dhe ndërmjet tyre më e përdorura është interneti) duke qenë të përdorura gjerësisht, janë një vektor shumë i rëndësishëm dhe i pashmangshëm për shumicën e aktiviteteve. Ky realitet ilustron me vendin gjithnjë e më të rëndësishëm që po zë në jetën tonë të përditshme ajo që quhet hapësira virtuale (*cyberspace*), e cila po ndryshon gjithnjë e më shumë kufijtë tradicionalë kohorë dhe gjeografikë dhe mënyrën e të jetuarit e të menduarit në ditët e sotme.

Në këtë prizëm, informacioni si një motor ekonomik i zhvillimit, është një e mirë jomateriale që kërkon një mbrojtje në lartësinë e vlerave dhe rëndësisë së tij, nga ana e individëve, organizmave dhe mbi të gjitha, të Shtetit.

Krimet që synojnë manipulimin, fshirjen, modifikimin, survejimin, spiunazhin e informacioneve që qarkullojnë në rrjetet e komunikimit mund të prekin direkt interesat e një individi, të një organizmi, apo dhe të një Shteti. Kështu, siguria e informacionit është e lidhur direkt me sovranitetin e një shteti, e cila kalon nga mbrojtja e infrastrukturave kritike, e sistemeve dhe e rrjeteve, e pasurive kulturore të kombit, e të mirave materiale dhe jomateriale, e përmbledhur në një fjalë të vetme: mbrojtja e vlerave.

Në rrethet e specialistëve të sigurisë, marrja në konsideratë e problematikës së sigurisë së informacionit, shpeshherë trajtohet si problem i lidhur tërësisht me një dimension teknik e shpeshherë si një demagogji apo problematikë virtuale. Fatkeqësisht, faktet i kanë dhënë të drejtë vetëm pjesërisht kësaj mënyre të menduari. Në të vërtetë, këto sulme virtuale kanë pasur rezultate më se realë, me një bilanc shumë negativ për organizmat publike apo privatë. Sa për të ilustrim, le të marrim shembullin e Estonisë, një shtet sovran dhe anëtar i organizmave euro-atlantike, siç përmbledhen sot rëndom në

gjuhën e politikës që konsumojmë përditë, organizmat e Komunitetit Evropian dhe të NATO-s. Pas heqjes së statujës së ushtarit sovjetik nga një park i kryeqytetit të Estonisë, një sulm masiv mbi infrastrukturën e informacionit të Estonisë, bëri që këto infrastruktura të ndalonin së funksionuari duke krijuar kështu një kaos total në ekonominë e vendit. Ky sulm përdori një teknikë jo shumë të komplikuar “përmblyjeje” (*flooding*) nëpërmjet kompjuterëve fantazmë (*bootnets*) mbi infrastrukturën estone, gjë e cila mbingarkoi rrjetin në një mënyrë të atillë, sa që ky i fundit nuk mundi ta përballonte ngarkesën dhe pushoi së funksionuari. Ministri i mbrojtjes së Estonisë Jaal Aavisko do të deklaronte për gazetën “The New York Times”¹: Kemi të bëjmë me një situatë që prek sigurinë kombëtare, të krahasueshme me një situatë ku portet tuaja bombardohen nga deti. Në këtë prizëm rezultatet e një sulmi virtual janë efektivisht më shumë se realë. Dhe me të vërtetë dezinformacioni po përdoret gjithnjë e më shumë si një pjesë integrale e politikave strategjike të organizmave dhe shteteve.

Interneti nga specifika e tij, është një terren ideal për të përhapur e pëshpëritur dezinformim si dhe për të manipuluar masa të mëdha njerëzish, me qëllimin për të mbjellë pasiguri. Në 2006, rrjeti i Ministrisë së Mbrojtjes së një shteti sovran, u bë objekt i një sulmi nga ana e disa *hacker*-ve, të cilët arritën të fusnin në këtë rrjet disa komunikime zyrtare për shtyp me informacione të pavërteta në lidhje me një skandal korrupsioni të pavërtetë, që gjoja kishte përfshirë ministrinë në fjalë. Specialistët arritën ta zbulonin këtë fakt, por fatkeqësisht shumë vonë, vetëm pasi e panë të botuar lajmin nëpër shumë gazeta kombëtare dhe ndërkombëtare. Dëmi? Jomaterial (i ngjashëm me sulmin) dhe shumë i vështirë për t’u llogaritur, por me rezultate të prekshme mbi imazhin e kësaj ministrie brenda dhe jashtë vendit.

Domosdoshmëria për të përndjekur, mbikëqyrur dhe dënua krimin kibernetik vjen si rrjedhojë e postulatit “Çfarë është ilegale jashtë rrjetit, mbetet ilegale dhe brenda tij”. Lufta kundër

¹ <http://www.nytimes.com/2007/05/29/technology/29estonia.html>

kriminalitetit të çfarëdo natyre qoftë ai, i përket organizmave të sigurisë, të financuara më së shumti nga taksapaguesit e vendit. Si një krim i njëjtë me atë “tradicional”, krimi kibernetik duhet marrë parasysh e trajtuar me të njëjtin seriozitet. Krimi kibernetik duhet konsideruar si një adaptim i mënyrës së të vepruarit të kriminelëve ndaj realitetit të sotëm, të cilin e përshkruam më sipër. Si rrjedhim dhe lufta kundër tij duhet të jetë në përputhje me realitetin. A nuk do të ishte një çështje e sigurisë së brendshme mbrojtja e infrastrukturave dhe kredibilitetit të institucioneve financiare të vendit apo mbrojtja e integritetit të fëmijëve ndaj fenomenit të pedofilisë? Jo pa qëllim zgjodhëm këto dy fenomene, të cilat në botën e interkonjektuar kanë marrë një hov të jashtëzakonshëm. Po cilat janë karakteristikat që e bëjnë internetin dhe botën e ndërlidhur në të cilën jetojmë, një terren fertil për farën e kimit?

Natyra dhe specifikat e kimit

Nga natyra, teknologjitë e reja janë në evolucion të vazhdueshëm dhe për rrjedhojë dhe rreziqet e lidhura me këtë teknologji evoluojnë në të njëjtën mënyrë. Scott Peck, një psikiatër i njohur amerikan dhe autor i suksesshëm librash shkruan: “E vetmja mënyrë për të pasur siguri në jetë është të njohësh pasigurinë”. Në fakt, krimi kibernetik duhet distancuar pak nga një nocion i përgjithshëm i asaj që quhet krimi informatik. Ky i fundit lidhet me një aktivitet kriminal që ka si objekt apo si mënyrë të kryerjes së kimit, kompjuterin. Krimi kibernetik, pra, është në këtë prizëm një nënkategori e kimit informatik dhe ka të bëjë me veprimtarinë kriminale të zhvilluar në rrjet (*network*). Interneti është një nga rrjetet më globale dhe më të përdorur sot. Pas këtij saktësimi, mundemi të eidentojmë që qenia në rrjet na ekspozon ndaj rrezikut të një sulmi të mundshëm. Do të ishte joprofesionale këshilla e një shkëputjeje nga rrjeti, sepse në strukturën ekonomike të sotshme gjithnjë e më shumë globale, shkëputja do të shndërronte organizmin në një njësi jokonkurrente.

Një aspekt tjetër që duhet trajtuar për të kuptuar fenomenin e krimit kibernetik, është dhe teknologjia e përdorur e cila mbetet pak a shumë jotransparente për përdoruesin.

Nga një këndvështrim teknologjik mund të përmendim faktin që Interneti është një teknologji publike e hapur për të tërë. Historikisht, rrjeti komunikues u zhvillua si një mjet i fushës ushtarake për t'u përdorur më pas nga universitarët për të lehtësuar komunikimin ndërmjet tyre. Ky vizion mbi përdorimin bëri që në fillimet e saj, teknologjia e internetit të mos përfshinte aspektin e sigurisë, përderisa komunikimi (si në rastin ushtarak, ashtu dhe në atë universitar) bëhej ndërmjet njerëzve që njiheshin dhe që kishin besim te njëri-tjetri. Teknologjia e internetit është një teknologji *"best effort"*. Kjo do të thotë që në konceptimin e saj "bëmë atë çfarë mundëm" për të arritur në rezultatin e dëshiruar, pa imagjinuar se çfarë devijimi mund t'i bëhej përdorimit të tij.

Nga një këndvështrim i rrjetit dhe i sistemit, në rastin e internetit kemi të bëjmë me një liri të madhe për sa i përket konfigurimit, mënyrës së trajtimit segmentar të sigurisë dhe ç'është më e rëndësishme në rastin tonë, mungesës totale të kontrollit. Jo më kot interneti identifikohet si "rrjeti i rrjeteve" dhe shpesh struktura e tij krahasohet me rrjetën e merimangës.

Nga një këndvështrim legal, Interneti është i konceptuar dhe funksionon në një mënyrë të tillë, që për të, nocioni i kufijve nuk ekziston. Në fushën juridike një krim në radhë të parë sanksionohet nga një ligj. Ky ligj i përket një shteti të caktuar dhe zbatohet nga një gjykatë kompetente e një shteti të caktuar. Nocioni i shtetit është i lidhur ngushtë me nocionin e territorit, pra me kufijtë shtetërorë. Kjo ndikon shumë në fazën e përndjekjes së krimit.

Me të tilla karakteristika, rrjeti nuk mund të mos jetë një terren pjellor për krimin. Së pari, krimineli do të shkojë atje ku gjenden vlerat më të çmueshme. Të mbështetur mbi këtë logjikë besoj se të gjithë biem dakord mbi faktin që vlera më e çmuar, si për organizmat privatë, ashtu dhe për ata shtetërorë, gjendet tek informacionet e përcjella gjithnjë e më shumë nga teknologjitë e informacionit. Së dyti, organizmat kriminalë duke vepruar në një mënyrë racionale do të veprojnë në

terrenin më të favorshëm, me një raport përfitimi më të madh dhe më pak të rrezikshëm, duke goditur shënjestrën më të lehtë. Kush më shumë se një terren opak dhe anonim, si ai i internetit mund të ofrojë të tilla mundësi? Pyetje shumë normale e të lidhura shumë ngushtë me luftën kundër krimit janë shumë të vështira për të gjetur përgjigje në botën virtuale. Si të tillë mund të përmendim problematikën e shenjave dhe provave në botën numerike. Cila do të ishte vlera e një prove numerike në një sistem gjyqësor të caktuar, në raport me provat materiale “tradicionale”?

Çështje teknike apo çështje sigurie?

Krimi tradicional mund të cenojë sigurinë e brendshme të një vendi, po ashtu edhe krimi kibernetik mund të këtë pasoja të rënda në këtë aspekt. Përmendëm më sipër një fenomen shumë shqetësues dhe objekt të rëndësishëm të sigurisë së brendshme, si pedofilia, e cila është amplifikuar me përdorimin në masë të teknologjive të reja. Po sa të përgatitur janë fëmijët tanë në lidhje me këtë fenomen? Çfarë mjetesh apo strategjish u ofrojmë ne atyre për të mos rënë prë e këtij akti katastrofik për jetën dhe integritetin e tyre? E pra, është fakt që më shumë se 70% e kontakteve të para ndërmjet kriminelit dhe fëmijës, bëhen nëpërmjet teknologjive të *chat*-it dhe të *forum*-eve. Sa internet kafe' ekzistojnë në territorin tonë dhe cila është pjesa më e madhe e klientelës? Cila është përgjegjësia e këtyre bizneseve në këtë kontekst? A janë të ndërgjegjshëm këta biznese për rrezikun që mund të vijë nga aktiviteti i tyre? A kanë këta të fundit një obligim monitorimi mbi aktivitetin që zhvillohet në kompjuterët e tyre? Këto pyetje të shumta mund të gjejnë apo jo një përgjigje nga ana e të interesuarve. Por një gjë është e sigurt, shteti ka për detyrë të mbrojë fëmijët dhe për këtë duhet të vërë në lëvizje gjithë mekanizmat e tij që të ketë sa më pak krime të kësaj natyre.

Po krimi ekonomik nuk përbën një fushë që do të cenonte rëndë sigurinë kombëtare të një shteti sovran? Çfarë vendi zë fenomeni i korrupsionit dhe lufta kundër tij në strategjinë e

sigurisë së brendshme? Një gjë është e sigurt dhe për këtë shifrat na japin të drejtë - krimi ekonomik po e zhvendos gjithnjë e më shume fushën e tij të veprimit në aktivitete *online*, si mënyra më e lehtë dhe më fitimprurëse. Le të përmendim këtu rastin e Bankës së Sicilisë në vitin 2000, ku një grup prej 20 personash, natyrisht me njohuri specifike në fushën e informatikës dhe të lidhur me disa familje mafioze, arritën të krijonin një klon të servisit “e-banking” të bankës. Kështu, arritën në këtë mënyrë të përvetësonin shumën prej 400 milionë\$, të vëna në dispozicion nga Komuniteti European për zhvillimin rajonal. Le të mos shkojmë më larg se 2 javë më përpara, ku 420 shtetas shqiptarë u mashtruan me një skemë vjedhjeje, tashmë të njohur si ajo e lotarisë, dhe falën kursimet e tyre kush e di se ku e kujt? Kush janë përgjegjësitë në këtë ngjarje?

Para disa ditësh nga ana e qeverisë u komunikua lajmi i mirë që tani aplikimet për tenderë do të bëhen nëpërmjet internetit. Kjo natyrisht do të thotë shërbim më cilësor e më i shpejtë. Po cilat janë rreziqet që një ndërmarrje e këtillë të bjerë prë e sulmeve të personave të interesuar për destabilizim e përfitim? Sa jemi të përgatitur për të përballuar këto sulme dhe mbi të gjitha n.q.s. sulmi fatkeqësisht del me sukses, çfarë jemi gati të humbim dhe çfarë ka vlerë më të madhe? Pa u përgjigjur këtyre pyetjeve, nuk mund të imagjinojmë masat teknike që duhen marrë.

Le t'i kthehemi pak çështjeve më tradicionale të sigurisë kombëtare si p. sh. mbrojtja e kufirit, parandalimi i kriminalitetit transfrontalier, apo dhe mbrojtja e infrastrukturave kritike (siç janë burimet e energjisë, të ujit të pijshëm, kontrollit të mallrave ushqimorë apo mjekësorë etj.). Pavarësisht që këto që përmendëm mund të jenë shumë të ndryshme në natyrën e tyre, një gjë i bashkon në epokën ku jetojmë - menaxhimi nëpërmjet teknologjive kompjuterike. Dëmi do të ishte i njëjtë si ai i një eksplozivi në një nga infrastrukturat, ashtu dhe dhënia e një komande të gabuar në sistemin e drejtimit. Dëmi do të ishte i njëjtë si kalimi natën i një kriminelit dhe futja e tij në territorin tonë, ashtu dhe fshirja e të dhënave të tij komprometuese në kompjuterët apo serverët

e policisë. Dëmi do të ishte po i njëjtë si futja e mallrave të skaduar apo të rrezikshme në territorin tonë, ashtu dhe falsifikimi i të dhënave në lidhje me këto mallra.

Një nocion shumë i përfolur këto kohët e fundit është dhe ai terrorizmit kibernetik (*cyberterrorism*). Dhe këtu spekulimet janë të shumta: disa e quajnë demagogji, disa e quajnë realitet. Në fakt është e vërtetë, me internetin nuk mundesh të vrasësh njerëz direkt. Po indirekt? A nuk ekzistojnë vallë me miliona website të financuara kush e di nga kush që bëjnë një propagandë aktive në favor të kësaj apo asaj organizate? Më keq akoma a nuk ekzistojnë me qindra website që të mësojnë se si të fabrikosh bomba artizanale? Kundër kujt do të përdoren? Komenti mbi këtë realitet do të ishte tepri, ajo çfarë nevojitet është kundërpërgjigja e organeve të specializuara.

Po interneti a mund të konsiderohet si infrastrukturë kritike e denjë pra për t'ua mbrojtur? Ndoshta një përgjigje më realiste mund t'ua japë qeveria e Estonisë apo ministri i tyre i brendshëm, apo i mbrojtjes.

Integrimi i strategjisë së sigurisë së informacionit

Shpeshherë siguria trajtohet në një mënyrë segmentare, duke implementuar zgjidhje të veçanta për probleme të shkëputura. Specialistët e sigurisë bien të gjithë dakord mbi faktin që, elementi siguri, qoftë ky në kuptimin tradicional të fjalës apo në atë kibernetik ose virtual, duhet vendosur e ideuar në themelin e strukturës të cilën duam të mbrojmë. Për të realizuar sa më mirë këtë objektiv, një strategji gjithëpërfshirëse nevojitet. Pa këtë strategji nuk do të mundemi të implementojmë zgjidhjet më efikase dhe të kemi rezultat. Nga mungesa e një strategjie, turizmi ynë përfaqësohet nga një natyrë e mrekullueshme, të cilën dalëngadalë po e betonojmë e po e prishim me ndërtime vend e pa vend e mbi të gjitha, pa harmoni. Le të mos bëjmë të njëjtin gabim.

Reflektimi i një strategjie të sigurisë kombëtare që të përmbledhë brenda saj dhe një strategji mbi sigurinë e informacionit është e domosdoshme. Kjo strategji do na

detyrojë të reflektojmë mbi natyrën e vlerave që ne dëshirojmë dhe gjykojmë që duhen mbrojtur.

Në kuadrin e një strategjie gjithëpërfshirëse mund të përcaktojmë se cilat janë rreziqet që na kanosen, cili është realiteti që ne duhet të përballojmë, cili është probabiliteti që këto rreziqe të realizohen dhe cili do të jetë impakti i tyre mbi vlerat apo asetet që duam të mbrojmë. Vetëm në këtë mënyre do të mundemi të vëmë në vend, mjetet më efikase për parandalimin e rreziqeve. Vetëm ndërtimi i një strategjie koherente do të na mundësojë të kuptojmë në cilin segment gjendet ajo hallka e dobët që rrezikon gjithë sistemin. Dhe e gjitha kjo nuk mund të zgjidhet vetëm me një implementim të masave teknike, por duke kuptuar dhe integruar funksionimin e teknologjisë, proceseve dhe faktorit human.

Të luash me frikën e njerëzve është një metodë jo pak e përdorur nga organet e sigurisë të prirura shpeshherë nga një rritje e buxhetit apo përfitime të natyrave të ndryshme. Megjithatë logjika e këtij refleksioni u motivua nga diçka diametralisht e kundërt. Thonë që po të mos e dish e të mos veprosh është gabim, por po të dish e të vazhdosh të mos veprosh, është faj.

GAQO TANKU, Doktor i Shkencave Ekonomike

MENAXHIMI I DIJES

Përpara se të trajtojmë këtë çështje, dëshiroj të theksoj se MD do të përdoret si shkurtesë për menaxhimin e dijeve.

Në vijim ky shkrim do të ndahet në katër pjesë. Pjesa e parë do të përpiqet të japë përkufizimin e MD. Pjesa e dytë do të diskutojë MD dhe në vijim duke e trajtuar si mjet efikas për rritjen e efektivitetit në organizatë, do të ilustruhet edhe me shembuj nga eksperiencia në FA. Kjo do të përbëjë edhe pjesën e tretë.

Ndikimet dhe kompleksiteti i trajtimit të kësaj çështje nga strukturat përkatëse të MBNJ dhe përfundimet do të përbëjnë mbylljen e shkrimit.

Shumë autorë e kanë përcaktuar MD në këndvështrime të ndryshme. Kjo ndoshta është edhe si rrjedhojë e perceptimeve, kuptimeve dhe eksperiencave që ata kanë. Harrison (2000) argumenton që MD është një koncept kompleks i cili është përcaktuar si çdo proces ose praktikë tjetër krijuese, e cila kërkon, përfshin, ndan dhe përdor dijet, kudo që janë dhe përdoren. Qëllimi: rritja e të mësuarit dhe performancës së organizatës. Willard (1999) argumenton nga ana tjetër se përcaktimi i MD si mjet lehtësues dhe zhvillues për të punuar në ekip, njeh dhe pranon natyrën bashkëpunuese të njeriut, proceset dhe informacionin, në organizatat që tashmë kanë karakter global apo rajonal. Këto përcaktime sikundër shihet janë edhe për FA-në, të cilat tashmë duke vepruar në kuadrin e operacioneve paqeruajtëse dhe në bashkëpunim edhe me forcat e vendeve të tjera, veprojnë në ambiente me natyrë globale. Në mbështetje të këtij përkufizimi, MD është kërkesë dhe gjen përdorim brenda organizatës dhe jashtë saj. Në kontekstin e FA-së, merr rëndësi si brenda territorit të vendit

dhe jashtë tij, me synim përfaqësimit sa më dinjitoz dhe të barabartë me vendet e tjera pjesëmarrëse. Kjo nënkupton faktin e thjeshtë dhe mjaft domethënës që MD është burim i pashtershëm që ndikon në rritjen e performancës së organizatës. Davenport dhe Prusak (1998) argumentojnë që në organizatë, dijet bëhen pjesë e saj jo vetëm nëpërmjet dokumenteve dhe mbajtjes së tyre nëpër arkiva, por edhe në aktivitetin e përditshëm, në proceset, praktikat dhe normat që zbatohen. Si shembull përmendim, programet dhe kurset e ndryshme që zhvillohen në Komandën e Doktrinae dhe Stërvitjes, të cilat janë pasqyrë e dijeve dhe njohurive që ofrohen. Po kështu edhe puna e Qendrës së Gjuhëve të Huaja, që tregon për ndihmesën e jashtëzakonshme që jepet për rritjen e aftësive gjuhësorë në FA.

Megjithatë, Nonaka dhe Takeuchi, (1995) i ndajnë dijet në dy drejtime, explicit dhe tacit. Dije Explicite (e drejtpërdrejtë) është ajo pjesë e dijes, e cila shprehet shumë lehtë apo që shkruhet me një gjuhë të thjeshtë. Për shembull, manualet, raportet për projekte të ndryshme, harta e një qendre qyteti etj. Nga ana tjetër dija TACIT (të nënkuptuara), është ajo dije e cila është bërë pjesë e njeriut, që mishërohen tek ai e të arritura përmes eksperiencës njerëzore. Kjo nuk mund të artikulohet, pasi është njohuri e gjallë, që nuk mund të mbijetojë jashtë sistemit njerëzor, nëpërmjet të cilit dinamika e saj qëndron. Për shembull, një ushtarak i vjetër dhe me eksperiencë, është në gjendje të kuptojë menjëherë gjendjen e trupave, apo një mjek me përvojë në mënyrë intuitive është në gjendje të kuptojë nëse një pacient mund të shërohet apo të vdesë nga sëmundje si malaria, tensioni i lartë apo të zemrës.

Dimensionet e Menaxhimit të Dijes

MD përfshin katër fusha kryesore. Këto janë: krijimi, trupëzimi (bërja e tyre si pjesë e pandarë e njeriut), përhapja dhe përdorimi (McAdam dhe Reid 2000). Krijimi i dijes përfshin dy fusha: shoqërore dhe ekzakte.

Ndërtimi i dijes shkencore është dije tashmë e vërtetuar dhe që ka marrë natyrën e ligjit. Të tilla përmendim ligjin e gravitetit, përmes të cilit është vërtetuar së çdo gjë që ka peshë dhe hidhet lartë do të bjerë poshtë. Kjo i dedikohet shkencëtarit të madh anglez Isak Njuton.

Nga ana tjetër, dija me karakter shoqëror është ajo dije, e cila është formësuar nga praktika e gjatë e një komuniteti (Baumard 1992) si shkencëtarët, inxhinierët, konsulentët e ndryshëm dhe studiuesit. Për shembull, dijet e krijuara në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore nga Teilor, Elton Mayo në fushën e kapitalit njerëzor etj.

Dije e trupëzuar (embodiment) është dija e krijuar si rezultat i ndërveprimit dhe këmbimit shoqëror brenda organizatës (McAdam dhe Reid, 2000). Kjo ka ardhur si rezultat i aktiviteteve menaxheriale të dijes, shpërndarja te njerëzit, takime jozyrtare, dialog, diskutime, shkëmbim mendimesh dhe pikëpamjesh, vëzhgime të ndryshme, konferenca dhe përdorim i teknologjisë informative si e-mail dhe internet. Për shembull, akademistët dhe studentët në TRADOK, mund të shkëmbejnë ide të ndryshme për çështje që ata trajtojnë me qëllim rritjen e performancës së tyre. Qëllimi i tyre është të kalojnë provimet duke arritur rezultate të larta.

Shpërndarja e dijes është transferimi i saj nga një person te tjetri, nga njëri grup te tjetri dhe në varësi të natyrës dhe qëllimit që ka organizata. Për shembull, Ministria e Mbrojtjes, me qëllim që ushtarakët të jenë në korrent të eksperiencave më të fundit boton rregullore dhe manuale të ndryshme, organizon seminare etj. Ndër eksperiencat do të theksonim atë të “Lessons Learned” (Përvoja e fituar), ku trupat që kanë qenë në misione paqeruajtëse, transmetojnë eksperiencën e fituar te trupat që do të shkojnë në mision në forma dhe metoda të ndryshme. Baumard (1999) argumenton se fakultetet në vetvete janë organizata ku krijohen dije. Për shembull, Akademia e Mbrojtjes, Universiteti Ushtarak “Skënderbej” dhe Akademia e N/Oficerëve “Tomson”, bëjnë të mundur shpërndarjen e dijeve te studentët dhe akademistët përmes leksioneve dhe diskutimeve në grup. Si rezultat, krijohen mundësi për studentët të ndajnë njohuritë e tyre me kolegët për çështje të ndryshme gjatë

diskutimeve në grupin mësimor. Për më tepër, njohuritë e organizatës (FA), shikohen në produktin e tyre si shkalla e përgatitjes së trupave, kryerja me sukses e misioneve të ngarkuara, plane, projekte etj. Për shembull, shërbimi që ofrohet në spitalin ushtarak, matet me rezultatet që arrihen në kurimin sa më të shpejtë e cilësor të sëmurëve.

Përdorimi i dijeve për qëllime ekonomike është një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm (McAdam dhe Reid 2000). Megjithatë, kjo do të varet nga qëllimi dhe misioni i organizatës. Dijet mund të përdoren për zhvillimin e produktit, shpërndarjen e shërbimit, rritjen e eficiencës së organizatës, uljen e kostos dhe zhvillimin e komunitetit. Nëse do t'i referohemi Universitetit Ushtarak "Skënderbej", studentët dijet e tyre do t'i përdorin për rritjen cilësore të performancës individuale dhe kur të jenë jashtë auditorit të universitetit, në njësitë dhe repartet e FA-së.

Qëllimi i Menaxhimit të Dijes

Qëllimi i MD është identifikimi dhe përfshirja e asetëve e njohurive të organizatës. Në këtë mënyrë dija do të trajtohet si burim, si aset, si një levë dhe vlerë e kapitalit njerëzor (Scarborough dhe Swan 1999). Walton (1999) shpjegon se MD është një argument më shumë se të mësuarit për aktivitetet kyçe të organizatës (FA) që gjendet në eksperiencën e individëve. Kjo eksperiencë humbet kur shumica e njerëzve largohen. Për shembull, në rast se studentët ushtarakë, të cilët ndjekin studimet e tyre jashtë shtetit nuk kthehen pas studimeve apo mospërdorimi i tyre në vendin e duhur, bën që të mos merret eksperiencia perëndimore dhe të zbatohet ajo në praktikë.

Fokusi i Menaxhimit të Dijes

Menaxhimi i dijes fokusohet në shpërndarjen e saj në grup. Qëllimi është të sigurohemi nëse ajo është transferuar nga

individit të grupit ose është kthyer në dije për shoqërinë. Në këtë mënyrë ajo ndihmon vazhdimin e novacionit dhe zgjidhjen e problemit (Harrison 2000) në organizatë. Për shembull, hedhja e një produkti të ri në treg si një mënyrë e vazhdimit të suksesit. Në kontekstin ushtarak, marrja e eksperiencës së trupave që kthehen nga operacionet paqeruajtëse, e bën më të lehtë kryerjen e misionit për ata që shkojnë për herë të parë.

Praktika e Menaxhimit të Dijes

Janë dy aspekte të MD, personalizimi dhe kodifikimi (Hansen dhe Tierney 1999). Personalizimi ka të bëjë me kontaktet person-person për shpërndarjen e dijës përmes dialogut dhe zhvillimit të ideve. Teknologjia informative (e-mail dhe internet) dhe telefoni janë përdorur dhe përdoren gjerësisht për zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Për shembull në BrRSH dhe Regjimentin “Komando”, me qëllim që eksperiencia e fituar gjatë misioneve paqeruajtëse të mund të merret sa më shpejt nga efektivat që ende nuk kanë marrë pjesë në këto lloj operacionesh, shikohet si më e përshtatshme përdorimi i strategjisë së personalizimit. Kjo strategji gjen përdorim shumë të madh midis shkencëtarëve në kërkimet e ndryshme që ata bëjnë. Kështu, nëpërmjet e-mail-it shkëmbehen me qindra mesazhe për të pasur informacionin e kohës. Anë e dobët është koha e madhe që kërkon, e në ndonjë rast nuk ka finalizim midis pjesëtarëve që janë përfshirë.

Nga ana tjetër, kodifikimi është procesi i MD i cili mbështetet në lidhjen midis njeriut dhe dokumentit (Hansen, Noriah dhe Tierney 1999). Kjo dije thelbësore ka ardhur si rezultat i punës së bërë dhe që është ruajtur në kompjuter ose në mjete të tjera. Për shembull në CD-ROM dhe Internet ndodhen shumë dije për çështje të ndryshme, të cilat njerëzit mund t'i përdorin.

Qendra mjekësore në SHBA thekson: Ne nuk po përdorim një mënyrë të re për të kuruar sëmundjen. Ne jemi duke marrë dijet më të vlefshme dhe shpikim një proces për t'i përdorur

ato sa më mirë.” (Hansen 1999). Anë e dobët është se nuk jep mundësi për përfshirjen e dijeve të reja. Për shembull, një pacient që vuan nga ulcera mund të mbahet më mirë me ilaçe sesa ta mësosh atë se si të rrisë aftësitë për menaxhimin e stresit nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme për çlodhje.

Përfundimisht, sipas Hall (1996) disa dije të kodifikuara eksplicite janë të një vlere të tillë që organizatat duhet ta menaxhojnë atë si një ligj që duhet zbatuar plotësisht. Duke e shpjeguar sa më sipër fokusin e MD dhe shpërndarjen e saj brenda grupit për zhvillimin e organizatës dhe qëndrueshmërinë e saj, në vijim do ta shikojmë atë si mënyrë menaxheriale.

Menaxhimi i dijës si mjet menaxherial

Prurjet e MD kanë shkaktuar një reaksion kompleks. Sipas Scarbrough dhe Swan (1991): “Nuk ka asnjë dyshim që ne i kemi futur njohuritë ekonomike. Ajo që organizatat dinë është se dija është bërë më e rëndësishme sesa burimet tradicionale të fuqisë ekonomike të kapitalit si toka, fabrika dhe puna”. Megjithatë, Ruggles (1998) argumenton se përkundër rritjes, MD është më shumë se një treg shitje, që shton vlera nëpërmjet aktivizimit të levave si: të dish, eksperiencës dhe gjykimeve jashtë dhe brenda organizatës. Davenport dhe Prusak (1998) argumentuan se krijimi i postit të shefit të zyrës së MD ishte përgjigjja më e mirë.

Gjetjet nga kërkimet

McAdam dhe Reid (2000) kryen një studim krahasues në lidhje me perceptimin e sektorit publik dhe privat për MD. Ata studiuuan 97 informacioneve dhe 8 workshop. Gjetjet nga ky kërkim treguan se MD ishte pranuar në sektorin publik si e kundërta e sektorit privat. Megjithatë, MD ende nuk ka zënë vendin e duhur dhe që të menaxhohet në mënyrë sistematike. Në përfundim, ata theksuan se MD është emergjencë për

organizatat. Drejtuesit e ekipeve dhe punëdhënësit duket sikur kanë një rol më të vogël. Gjetjet e McAdam dhe Reid janë konfirmuar edhe nga zyrat përkatëse shtetërore. Kjo tregon që MD, është një koncept i ri dhe shumë i domosdoshëm në aspektin menaxherial.

Si shembull përmendim kompanitë japoneze, të cilat kanë bërë të mundur shtrirjen e këtij koncepti në tërë linjën e menaxhimit. Në to, nuk ka ndonjë grup të veçantë apo ekspert përgjegjës për MD. Këto janë shtrirë në tërë linjën e menaxherëve, nga niveli i ulët deri në atë strategjik. Menaxherët e nivelit strategjik krijojnë vizionin e dijes që i duhet organizatës dhe kjo ndihmon në përfshirjen më të mirë nga menaxherët e nivelit të mesëm në nivelet më të ulëta, duke shkuar deri te punonjësi më i fundit. Kjo nënkupton që MD si një model menaxherial është plotësisht i integrueshëm me sistemin e menaxhimit në këto kompani. Për analogji, ky parim dhe zbatimi i tij në praktikë, vlen që të merret në konsideratë edhe për FA-në.

Predikimet Menaxheriale

Ngritja dhe ulja e modelit menaxherial-Te mësuarit në organizatë (Scarborough dhe Swan 1993), menaxhimi shkencor dhe menaxhimi i marrëdhënieve njerëzore, tregojnë që modelet shpesh ndryshojnë dhe vlera e tyre përcaktohet nga koha.

Scarborough dhe Swan argumentojnë se dhënia e popullaritetit të këtij “stili” në literaturën menaxheriale, është pothuajse e ngjashme në shumë vende. Ndërkohë interesi në MD aktualisht po ecën më shpejtësi të paparë. Buchanan dhe Huczynski (1997) argumentojnë se MD është një manifestim i modelit të organizatës, i cili lëviz nga mënyrat e vjetra në një të re, me interes të veçantë të njerëzimit, si një forcë potenciale për produktivitetin ekonomik ose shërbimin. Kjo nënkupton që, ndryshimet në ambientin ekonomik-social bëjnë që shkencëtarët të vazhdojnë të përsosin modelin e ri si një mekanizëm të domosdoshëm.

Në bazë të argumenteve të përmendura më sipër, dhe të ndryshimeve të modelit menaxherial, MD do të shërbejë për sa më poshtë.

Menaxhimi i dijes si pikë reference për operacione efektive në organizatë

Tashmë MD dhe shpërndarja e saj, është bërë shumë e prekshme dhe evidente. Ajo siguron pika të forta dukë i ndihmuar njerëzit që të operojnë me efektivitet në organizatë. Sipas Rosenzweig (1998), një fuqi punëtore përfshin njerëz me pikëpamje dhe eksperiencë të ndryshme. Kjo krijon mundësinë që idetë të diskutohen dhe të shpërndahen më lehtë. Në këtë mënyrë lehtësohet zgjidhja e problemeve. Më mirë i përshtatet fjala e urtë se një mendje është hiç mendje ndërsa dy janë një mendje e vetme. Disa nga shembujt që lidhen me përhapjen e ideve janë si më poshtë: Në BrRSH me qëllim që të rriten më shpejtë dijet në përdorimin e gjuhës angleze, u vendos që për çdo javë raportimi të bëhet në atë gjuhë. Kështu, për një kohë të shkurtër përhapja dhe përqaftimi i kësaj ideje bëri të mundur çlirimin e energjive pozitive. Rezultatet u dukën shumë shpejt.

Duke iu referuar teorisë së të mësuarit dallojmë dy drejtime: të mësuarit formal dhe joformal. Arsimimi formal është ai që mësohet në shkollë, kolegje, universitete dhe institucione të ndryshme të trajnimit. Metoda kryesore e të mësuarit është mësimdhënia dhe leksionet. Nga ana tjetër, mësimi joformal bëhet i mundur nëpërmjet krijimit të klimës shoqërore brenda grupit.

Gjatë diskutimit me një grup trajnimi rreth zhvillimit të burimeve njerëzore, u dhanë këto përkufizime:

Zhvillimi i burimeve njerëzore është një proces që investon në aftësitë e njerëzve, kështu që shërbimi ndaj publikut është kryer dhe nevojat aktuale e të perspektivës për organizatën janë arritur.

Zhvillimi i burimeve njerëzore është procesi i zhvillimit të tyre nëpërmjet rritjes së aftësive, njohurive dhe mbajtja e qëndrimeve të nevojshme për zhvillimin.

Zhvillimi i burimeve njerëzore ka dy pjesë: individuale dhe në grup. Për individin, është parë si zhvillim i aftësive, ecje në karrierë, ndërsa për grupin si mundësi e mirë për rritjen e kapacitetit dhe sigurimin e lidershit të nevojshëm, rritjen e aftësive për vendimmarrje.

Kjo do të thotë që të ndihmojë grupin për përmbushjen e programeve dhe rritjen e aktiviteteve me synim zhvillimin e njerëzve. Në këtë kontekst, stërvitjet e ndryshme të trupave, do të varen edhe nga aftësitë e veçanta të individëve të ndryshëm dhe aftësitë e tyre për të mësuar. Gjatë një stërvitje me efektivat e zbulimit procesi i të mësuarit kaloi nëpërmjet fazave të mëposhtme:

- Mbështetje tek aftësitë e njëri-tjetrit për të realizuar detyrën.

- Kalimi i pengesave ujore u diktua nga transferimi i dijes nga ata individë, të cilët kishin eksperiencë, pasi kishin marrë pjesë më parë në stërvitje të tilla dhe kalimi i tyre tek ata me më pak eksperiencë. Në vijim zhvillimi i ideve nëpërmjet diskutimit në grup.

- Stërvitje malore-shpërndaja e informacionit dhe instruktimi me njëri-tjetrin.

- Ndërtimi i fuçive për lundrim-zhvillimi i ideve nëpërmjet diskutimit në grup.

- Suksesi i organizimit të mësimit në grup varet në planifikimin sa më mirë të strategjisë, harmonisë dhe lidhjeve reciproke brenda tij, rritja në maksimum e dijeve, aftësive dhe eksperiencës së pjesëtarëve të grupit. Menaxhimi i dijes kërkon një vizion të qartë për drejtimin e organizatës.

- Web (1998) argumenton se praktika e MD në organizatë kërkon deklaram të qartë nga instancat më të larta tek ato më të ulëtat, mekanizmat e domosdoshme të komunikimit për shpërndarjen e saj, mirëkuptimin dhe përfshirjen për qëllimin e caktuar, planifikimin e kujdesshëm dhe programet e trajnimit, sistemet dhe procedurat e përshtatshme si dhe monitorimin e vazhdueshëm për të qenë të sigurt se gjithçka është në vendin e duhur. Kjo do të thotë se në mungesë të një vizioni të qartë në organizatë, MD do të jetë i pamundur. Për shembull, Lester (1998) argumenton se mungesa e një

politike të qartë, e njohurive individuale dhe sistemit të vlerësimit, ndikojnë negativisht në shpërndarjen e saj në organizatë.

Më sipër trajtuam përdorimin e MD në organizatë nëpërmjet ilustrimeve të ndryshme. Në vijim do të shikojmë implikimet e MD.

Implikimet e menaxhimit të dijes për strukturat përgjegjëse për zhvillimin e burimeve njerëzore.

Nisur nga problemi kryesor se zhvillimi i burimeve njerëzore do të varet nga procesi i të mësuarit, nga aftësitë e duhura, dalja e MD në organizatë ka nxjerrë në plan të parë rolin e strukturave përkatëse. Disa nga këto detyra janë si më poshtë:

Protagonistë të menaxhimit të dijes

Menaxhimi i dijes i ka vendosur këto struktura si kyç në këtë proces. Walton (1999) argumenton se është detyrë dhe përgjegjësi e strukturave përkatëse, pasi ato janë përgjegjëse për ta lehtësuar sa më shumë këtë proces, bile duke u përfshirë vetë në trajnimin e njerëzve të organizatës dhe në zhvillimin e procesit.

Lehtësojnë procesin e krijimit të dijeve

Strukturat përkatëse kanë për detyrë të lehtësojnë sa më shumë që të jetë e mundur krijimin e dijeve brenda organizatës. Kjo kërkon përqendrim në ato dije që i duhen asaj për të përmbushur misionin e së ardhmes. Nonaka dhe Takeuchi (1995) argumentojnë se menaxherët e nivelit të mesëm luajnë rol kryesor në lehtësimin e procesit të krijimit të dijeve në organizatë. Ata shërbejnë si një nyje lidhëse strategjike, e cila lidh menaxherët e nivelit më të lartë me menaxherët e nivelit

të parë. Ata janë një urë lidhëse midis vizionarëve idealë në nivelet më të larta dhe realiteteve që shfaqen në aktivitetin e përditshëm me njerëzit.

Rol këshillues për menaxherët e burimeve njerëzore

Specialistët për zhvillimin e burimeve njerëzore kanë për detyrë të këshillojnë rreth personelit më qëllim që të shmangen largimet e panevojshme nga puna. Lester (1998) argumenton që një specialist i zhvillimit të burimeve njerëzore duhet që të përfshihet në procesin e përzgjedhjes, motivimit dhe largimit të njerëzve dhe të këshilloj organizatën për nevojat në fushën e dijeve që i duhen në të ardhmen. Kjo patjetër që duhet të reflektohet në planet strategjike për rekrutimin, trajnimin dhe ecjen në gradë dhe karrierë. Nga ana tjetër tregon domosdoshmërinë e përfshirjes të specialistëve përkatës në planifikimin e burimeve njerëzore dhe administrimin e tyre. P. sh. në rastet kur pakësohet numri për shkak të reformave është e domosdoshme që specialistët e burimeve njerëzore të jenë këshilltarë të mirë. Roli të konsistojë në ndihmesën për të përcaktuar individët që janë potencial në të ardhmen.

Ndërtues të infrastrukturës

Për më tepër, roli i specialistëve të zhvillimit të burimeve njerëzore është të sigurojnë dhe ndërtojnë infrastrukturën e nevojshme për MD në organizatë. Sipas Cannell (1999) sikundër përmendet nga Harrison (2000) specialistët e BNJ nuk kanë asnjë zgjidhje tjetër përveçse të integrojnë të mësuarit on line në kurrikulumin e punonjësve. Është e nevojshme që të kuptohen anët e forta dhe të dobëta të teknologjisë së re dhe të jenë në gjendje të identifikojnë kur dhe ku ata mund të ofrojnë një zgjidhje me kosto të ulët. Sipas Lank (1997) janë katër fusha kryesore:

- Përcaktimi i dijeve tacit (të nënkuptuara) dhe explicite (të drejtpërdrejta) aktuale dhe të nevojshme për organizatën.

- Zhvillimi i mekanizmave të nevojshme për grumbullimin e dijeve, shpërndarjen e tyre dhe të proceseve për njohuritë bazë.

- Përcaktimin e boshllëqeve në fushën e dijes dhe mekanizmat e nevojshme për plotësimin e tyre përmes trajnimit.

- Menaxhimi i procesit të investimeve, teknologjisë informative dhe roli për më shumë dije dhe ekspertizë në organizatë si dhe vendosja e masave të duhura në mënyrë që këto investime të kthehen në produkt.

Iniciues të shpërndarjes së dijes

Së fundi, specialistët e zhvillimit të burimeve njerëzore janë iniciues të dijes (Davenport dhe Prusak, 1998) në organizatë. Ata shpresohet që të iniciojnë shpërndarjen e dijes dhe përfitimet që ka organizata si dhe çdo punonjës. Davenport (1998) argumenton që drejtuesit e BNJ, nën ndikimin e specialistëve përkatës kanë tre role për të luajtur. Këto janë: ngritja e kulturës së dijes në organizatë, menaxhimi i marrëdhënieve me siguruesit e informacionit jashtë organizatës si akademikët, kompanitë që kanë bankën e të dhënave etj. dhe të sigurohemi se ky investim do të kthehet nëpërmjet rritjes së treguesve ekonomikë e të shërbimeve për organizatën. Për shembull, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nëpërmjet specialistëve të saj bën të mundur sigurimin e lidhjeve me vendet e NATO-s, me synim sigurimin e kurseve të niveleve të ndryshme me qëllim që të plotësohen kriteret nga ana e personelit për futjen në NATO.

Edhe sukcesi i specialisteve të menaxhimit e arsimimit që shtrihen në tërë piramidën janë ndër kryesorët në menaxhimin e dijes, por sukcesi i tyre do të varet nga shumë faktor. Davenport (1998) argumenton që menaxhimi i dijes kërkon përfshirjen e politikave nga nivelet më të larta. Ajo kërkon mbështetjen e top menaxherëve dhe vullnetin e të tjerëve për

të dhënë atë që ata dinë. Konkretisht, menaxherët e nivelit më të lartë krijojnë vizionin, menaxherët e nivelit të mesëm zhvillojnë konceptet konkrete që punonjësit t'i kuptojnë dhe zbatojnë. Për sa më sipër, është e kuptueshme që nëse mungon vullneti i menaxherëve të nivelit më të lartë, dhe vendosmëria e niveleve të tjera për të shpërndarë dijet e tyre dhe ato të përvetësohen nga strukturat përkatëse, specialistët e zhvillimit të burimeve njerëzore nuk mund të realizojnë detyrat dhe të luajnë rolin e tyre në organizatë.

Përfundime

Menaxhimi i dijes është një proces zhvillimi, kërkese, përfshirje dhe përdorimi të njohurive të punonjësve për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e organizatës. Ajo përfshin katër dimensione: krijimin e dijes, bërjen pjesë të individit, shpërndarjen e saj dhe përdorimin, Qëllimi i MD është përhapja e saj nëpërmjet personalizimit dhe kodifikimit. Personalizimi është procesi i përhapjes së dijes që mbështetet në faktorët humanë të një ekipi. Ndërkaq, kodifikimi qëndron në ekstraktet dhe vendosjen e dijeve explicite në dokumente si CD-ROM, kompjuterë, manuale dhe vende të tjera për t'u ruajtur. Në këtë mënyrë organizata ka mundësitë praktike për t'i përdorur ato, nëpërmjet manualeve të ndryshme etj.

MD është akoma një koncept i ri dhe studimet tregojnë se ende nuk ka gjetur shtrirjen e duhur si në sektorin privat dhe atë shtetëror.

Për strukturat përkatëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, menaxhimi i dijes bën të mundur që ata të luajnë rolin e protagonistit të shpërndarjes së dijeve si dhe krijimin, këshillimin e menaxherëve të niveleve të ndryshme për menaxhimin e punonjësve të tyre. Ata do të jenë ndërtues të infrastrukturës së nevojshme për të mësuar me qëllim që punonjësit të mësojnë dhe fitojnë aftësitë e duhura. Megjithatë, efikasiteti i këtyre strukturave do të varet në mbështetjen e menaxherëve të nivelit të lartë. Kjo sepse menaxhimi i dijes kërkon mbështetje politike, e cila kërkon vizion të qartë në organizatë.

Literatura

Baumard, P. (1999). *Tacit Knowledge in Organisation*. London: Sage Publication

Buchanan and Huczynski (1977). *Organisational Behaviour: An Introductory Text*, 3rd edn. Gosport: Ashford Colour Press Limited

Davenport, and Laurence Prusak (1998). *Working Knowledge: How Organisation Manage, What they know*. Boston: Harvard Business School Press.

Harrison, R. (2000). *Employee Development*, 2nd edn. Wiltshire: The Cromwell Press.

Hansen, Nohria, and Tierney (1999), "What is your strategy for Managing, Knowledge." *Harvard Business Review*, March-April

Lester, T. (1998) *Knowledge Management*.

Megginson and Jenifer (1999). *Human Resource Development* 2nd edn. London: Kogan Page Limited

McAdam and Reid (2000). "A Comparison of Public and Private Sector Perception and use of Knowledge Management. *Journal of European Industrial Training*, Vol. 24.

Nonaka and Takeuchi (1995). *The Knowledge Creating Company: How Japanese Companies Create the Dynamics of Innovation*. New York: Oxford University Press.

Scarbrough and Jasky Swan (1999), *Issues in People Management: Case Studies in Knowledge*, Wiltshire: The Cromwell Press.

Webb, S. (1998), Knowledge Management: Linchpin of Change, London: Aslib Staple Hall.

Walton, J. (1999), Strategic Human Resource Development. Troëbridge: Redwood Books Limited.

Willard, N. (1999), "Knowledge Management: Foundation for a Secure Structure, Journal of Managing Information, Vol. 16 No. 5.

BRIEF ENGLISH SUMMARY OF THE ARTICLES IN THIS ISSUE

NATO and the European Union: Cooperation and security

Professor Adrian Pop is Professor at the National School for Political Studies and Public Administration in Bucharest, Romania. In this article, he examines the evolving relationship between the European Union and the Atlantic Alliance.

Today's security challenges include a plethora of complex and evolving dangers, including international terrorism, the proliferation of weapons of mass destruction (WMDs), failed states, stalemated but unremitting conflicts, organized crime, cyber-threats, energy shortages, environmental degradation and its associated security risks, natural and man-made disasters, pandemics and many others. Facing these threats effectively will require wide-ranging partnership and strong synergy between NATO and the European Union (EU).

The two organizations should take a holistic approach to security issues and work together in the defense domain. Although neither a geographic nor a functional division of labor is a feasible option, it is now accepted in many circles that some forms of outreach, for example peacekeeping in Africa and the Balkans, should be EU-budged, while others, such as current operations in Afghanistan against the Taliban should fall under NATO.

NATO and Russia: Sobering thoughts and practical suggestions

Dmitri Trenin takes a hard look at the NATO-Russia relationship on the fifth anniversary of the NATO-Russia Council and the tenth of the Paris Founding Act on Mutual Relations.

For nearly a decade after the emergence of the Russian Federation, NATO-related issues were a key focus of Moscow's foreign policy. The Alliance was both a symbol of the Cold War and the premier Western club. Russia vacillated between half-hearted attempts to join the Alliance on special terms, and futile efforts to prevent the country's neighbors from seeking membership as a security guarantee against Russia itself.

According to the author three main developments shaped the relationship during the 1990s:

- Bosnia and Herzegovina, where the NATO/US use of force in 1995 led to the signing of the Dayton Peace Agreement;
- NATO's enlargement invitation in 1997 to the Czech Republic, Hungary and Poland, and their accession in 1999, a bitter pill barely sweetened for Moscow by the creation of the Permanent Joint Council (PJC), a consultative mechanism between Russia and the Alliance; and
- the 1999 Kosovo crisis, which culminated in NATO's 78-day air campaign against the Federal Republic of Yugoslavia, despite Russia's most vehement protests.

"A Global NATO towards Bucharest Summit"

Gary D. Robbins, Director for European Security and Political Affairs, Bureau of European and Eurasian Affairs at US Department of State held this speech at Palermo Atlantic Forum on October 5, 2007, an international conference organized Italian Atlantic Committee. In the address, he analysis current global challenges and the evident need to foster NATO's partnerships with other organization such as EU and other likeminded countries. NATO - Russia relations are also

treated. Mr. Robbins explains the importance and the need for success of NATO-s engagements in Afghanistan. He also voices US expectations form the coming Bucharest Summit.

Adapting to challenges and threatens of national security and the steps towards the country's integration at Euro-Atlantic institutions

By Col. Edison Zarka

The article is an effort to give a summary description on the efforts that Albania has made to adapt with the new geopolitical context after the Cold War. A series of documents on national security and defense policy approved by the post-communist governments have shaped country's identity as stability factor at fragile and turmoil region as the Balkans appears. The strong commitment of the country to be active actor in all regional initiatives like Stability Pact, CEI, SEEI or SEDM has contributed to identify better its security challenges in the forthcoming future. The perspective of the integration in Euro-Atlantic institution like NATO and EU still remain a real challenge that need to be associated with more pro-active attitudes towards reforms and participation. The transforming of Albania from "security importer" to "security exporter" is considered as a significant change that may help again the stability in the region at the framework of international efforts to resolve the Kosovo status.

NATO and the Balkans: The case for greater integration

Dr Amadeo Watkins and Srdjan Gligorijevic

Dr. Amadeo Watkins is an expert on the Balkans and Security Sector Reform at the Defense Academy of the United Kingdom. Srdjan Gligorijevic specializes in NATO and EU security matters at the International and Security Affairs Centre (ISAC) in Belgrade.

The views expressed by the authors are their own and do not necessarily represent the views of their respective institutions

This article deals with NATO's post-Cold war evolution which according to the authors has been strongly influenced by events in the Balkans. And although at each consecutive NATO summit meeting, the Alliance expands its areas of strategic interest and engagement, the Balkans remains a region of special concern to the Organization. But the view of NATO from the region itself is not so positive. Now that peace has largely been secured, questions remain. What will it take for the Alliance to win over the 'hearts and minds' of the people of the region – and more importantly, what needs to happen to increase stability in the area?

EU and its efforts for Common Foreign Policy

Geron Kamberi, MA in European Policies at Sussex European Institute-UK attempts to offer to the Albanian readers a thorough description of efforts for an European Common Foreign Policy.

The article aims to give a broad introduction to the ideas and issues related to the EU's role in international politics as well as present its evolution across the years to build an identity on the global affairs. It commences with the early but not successful efforts of the Union to emerge as an international actor and provide a brief survey on the reasons in that period that caused the failures towards a common foreign policy within the EU. Through the analysis of the political context of the aspects of EU enlargement and treaties adaptation is given the transformation of institutional aspects of European Political Cooperation (EPC) to a Common Foreign Policy (CFSP). The role of EU in international development, humanitarian action and conflict prevention is considered as the main tools of its own foreign policy. Not a commune approach to such policy continues to remain the biggest challenge regarding its efficiency compared to other international actors.

Taking the civil dimension of security seriously: NATO as the post-conflict reconstruction organization

Manjana Milkoreit, director of the Center for Strategic and Global Affairs at the Public Policy Group – a new think tank in Berlin is writing her opinion on NATO transformation into biggest international organization for reconstruction.

Pointing to the future: Afghanis have been able to vote following NATO's intervention in the country - a prime example of reconstruction efforts helping people to help themselves. The World Bank defines post conflict reconstruction (PCR) as 'supporting the transition from conflict to peace through rebuilding a country's socioeconomic framework'. How far can NATO go in this PCR role?

Here, Manjana Milkoreit gives her personal view that NATO could be the best equipped organization for PCR.

It's always interesting to look at international security issues and ask 'what if?' What if the United States had a chance to restart its invasion in Iraq? What if NATO could redesign its Afghanistan mission from the beginning? What if Europe got another shot at stabilizing the Balkans? What would they do differently? It's fair to assume all of them would look longer and harder at post conflict reconstruction (PCR).

The role of the information's security at the national security strategy

Igli Tashi and **Solange Ghernaoutii-Helie** try to bring to sensitivity to Albanian actors and decision-makers on current cyber threats to security.

In this article the security of the information is seen as essential part of any National Security Strategy. A series of arguments are presented and supported by evidences to identify all the risks which threaten the security of information at the digitalization and internet era and the vulnerability of the

institutions and society regarding this issue. The so-called cyber crime may affect all kinds of the important information saved electronically like as military, banking, or police one.

Against this framework only a comprehensive National Security Strategy where is included a clear approach on the importance of information's security may help states and institution to be protected and understand the weak points in this interactions chain. In this way, the recent developments in the area call for a new security concept which needs to be extended and adapted with what is happening within our information and technology society.

Managemet of Knowledge

Doctor of economic sciences **Gaqo Tanku** in his article attempts to enhance understanding of leadership in general and those in armed forces in particular to better use techniques of management of knowledge. The article divided in four parts explains to define knowledge management, the current concepts on it, on the third part effective knowledge management is presented as instrument to improve efficiency of the organization. Later the author describes its implication in human resources management and different conclusions.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
ÇËSHTJE TË SIGURISË - 5

Formati: 15.5x24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: (4) 240116
Tiranë, 2007